

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	5
KAPITULLI I - KONCEPTIMI I PAKETËS DIDAKTIKE	6
KAPITULLI II - KURRIKULA E RE E KLASËS PËRGATITORE	10
Gjuhë shqipe.....	12
Edukatë figurative.....	15
Edukatë muzikore	18
Matematikë	20
Njeriu dhe natyra	21
Shoqëria dhe mjedisi.....	22
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti.....	23
Shkathësi për jetën	25
KAPITULLI III - PLANIFIKIMI I KURRIKULËS SË RE	26
Specifikat e punës në muajin shtator.....	32
Rezultatet e të nxënët sipas lëndëve për muajin shtator	35
Projekti i muajit	39
Planifikimi i temave për muajin shtator “Shkolla po më pret”	40
Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin shtator.....	44
Specifika të punës në muajin tetor	51

Rezultatet e të nxenit sipas lëndëve	52
Projekti i muajit.....	57
Planifikimi i temave për muajin totor “Mirë se erdhe vjeshtë e artë!”	58
Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin totor	61
Specifikat e punës në muajin nëntor.....	71
Rezultatet e të nxenit sipas lëndëve për muajin nëntor	73
Projekti i muajit.....	78
Planifikimi i temave për muajin nëntor “Shtëpi, e ëmbla shtëpi”	79
Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin nëntor	83
Specifikat e punës në muajin dhjetor	89
Rezultatet e të nxenit sipas lëndëve për muajin dhjetor	90
Projekti i muajit.....	95
Planifikimi i temave për muajin dhjetor “Dimër, edhe të dua edhe s’të dua!”	96
Veprimtaritë mësimore për muajin dhjetor	99
Specifikat e punës në muajin janar	104
Rezultatet e të nxenit sipas lëndëve	105
Projekti i muajit.....	109
Planifikimi i temave për muajin janar “Për një trup të shëndetshëm”	110
Veprimtaritë mësimore për muajin janar	113
Specifikat e punës në muajin Shkurt.....	118
Rezultatet e të nxenit sipas lëndëve	120

Projekti i muajit	124
Planifikimi i temave për muajin shkurt “Sa të dua Kosova ime!”	125
Veprimtari mësimore për muajin shkurt	128
Specifikat e punës në muajin Mars	132
Rezultatet e të nxënët sipas lëndëve	134
Projekti i muajit	138
Planifikimi i temave për muajin mars “Në qytet apo në fshat?”	139
Veprimtari mësimore për muajin mars	142
Specifikat e punës në muajin Prill.....	146
Rezultatet e të nxënët sipas lëndëve	147
Projekti i muajit	151
Planifikimi i temave për muajin prill “Mirë se erdhe moj pranverë!”	152
Veprimtaritë mësimore për muajin prill	155
Rezultatet e të nxënët sipas lëndëve	160
Projekti i muajit	164
Planifikimi i temave për muajin maj “Mjetet e transportit”	165
Veprimtaritë mësimore për muajin maj	168
Specifikat e punës në muajin qershor.....	172
Rezultatet e të nxënët sipas lëndëve	173
Projekti i muajit	176
Planifikimi i temave për muajin qershor “Vera na fton në pushime”	177

Veprimtari mësimore për muajin qershor	180
KAPITULLI IV – NË NDIHMË TË MËSUESIT	182
Simbolet dhe kuptimi i tyre	182
Alfabeti i gjuhës së shenjave	184
Përrallat, tregimet dhe fabulat	185
Punimi i shkronjave me materiale të riciklueshme.....	216
Punimi i numrave me materiale të riciklueshme.....	223
Punimi i formave me materiale të riciklueshme	227
Etiketa me fjalë për çdo shkronjë të alfabetit.....	228

HYRJE

Libri që mbani në duar është një material ndihmës për mësuesin/en e arsimit parashkollar. Ai i vjen në ndihmë mësuesi/jat për të kuptuar filozofinë e kurrikulës së re të klasës përgatitore, për të përbushur rezultatet e të nxenit dhe për t'iu përgjigjur pritshmërite të standardeve të zhvillimit dhe të të mësuarit, të hartuara për fëmijët e moshës 5-6-vjeçare.

Libri është ndërtuar në disa kapituj.

Kapitulli i parë bën një përshkrim të konceptimit të paketës didaktike dhe të materialeve që përmban.

Kapitulli i dytë bën një analizë të kurrikulave lëndore/programeve mësimore të klasës përgatitore dhe të përthyerjes së tyre në veprimtari didaktike që përbushin rezultatet e të nxenit.

Kapitulli i tretë tregon metodologjinë që është zgjedhur nga grupei i autorëve për realizimin e programeve të klasës përgatitore dhe ndërthurjen e tyre brenda temave dhe veprimtarive të integruara. Në këtë kapitull, përshkruhet natyra e kërkesave, e ushtrimeve, e punëve praktike, e lojërave të përdorura te librat e fëmijës, vjershat, përrallat dhe tregimet.

Kapitulli i katërt përmban materiale në ndihmë të mësuesit, të cilat përdoren në veprimtari të ndryshme mësimore.

Suksese dhe punë të mbarë!

Autorët

KAPITULLI I - KONCEPTIMI I PAKETËS DIDAKTIKE

Paketa didaktike "Mësoj si nxënës, luaj si fëmijë" është mbështetur në kurrikulën e re që ka nxjerrë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për klasën përgatitore. Kalimi i fëmijëve nga kopshti në shkollë është një periudhë që kërkon vëmendje nga të rriturit, sepse ky kalim nuk përjetohet në të njëjtën mënyrë nga fëmijët e moshës 5-6 vjeçare. Për këtë arsy, ndjekja e kësaj klase, quajtur ndryshe si viti përgatitor, ndikon në përshtatjen e fëmijës me mjedisin e shkollës, me përbushjen e treguesve të standardeve të zhvillimit dhe të të nxënës, si dhe me pajisjen e fëmijëve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për shkollë.

Duke u nisur nga qëllimi i klasës përgatitore, për ta bërë gati fëmijën për shkollë, por edhe duke mos e kthyer në mësim shkollor veprimtarinë në këtë klasë, paketa mban titullin "Mësoj si nxënës, luaj si fëmijë". Veprimitaria kryesore e fëmijës është loja, është puna praktike, është demonstrimi, është konkretizimi, por nga ana tjetër fëmija mësohet me rregulla, me kërkesa, me detyra të thjeshta, me veprimitari praktike, nëpërmjet të cilave ai mëson dhe përgatitet për të përballuar kërkesat e shkollës kur të shkojë në klasën e parë.

Paketa përbëhet nga tre libra pune për fëmijën, të ndarë sipas tri periudhave:

- Libri i parë është konceptuar për periudhën Shtator-Dhjetor;
- Libri i dytë për periudhën Janar-Mars;
- Libri i tretë për periudhën Prill-Qershori.

Brenda secilit libër jepen të integruara njohuritë dhe veprimtaritë nga të gjitha lëndët që zhvillohen në klasën përgatitore. Ato ndërthuren në mënyrë të tillë që fëmija të ketë mundësi sa të punojë në librin e vet të punës, aq edhe të luajë praktikisht me objekte dhe sende konkrete në veprimtaritë e tjera të planifikuara nga mësuesi/ja.

Krahas librave të punës, paketa përmban edhe fletë të veçanta didaktike me lojëra, veprimtari praktike dhe projekte nëpërmjet të cilave fëmija luan dhe përforcon çfarë ka mësuar.

→ Janë realizuar **6 fletë për përsëritjen e shkronjave**. Përmendim këtu fletët e punës në A3:

- “Luaj me shkronja - nga shkronja A - DH”
- “Luaj me shkronja - nga shkronja E - H”
- “Luaj me shkronja - nga shkronja I - M”
- “Luaj me shkronja - nga shkronja N - R”
- “Luaj me shkronja - nga shkronja RR - U”
- “Luaj me shkronja - nga shkronja V - ZH”

→ Janë realizuar **2 fletë për përsëritjen e numrave deri në 10**. Përmendim këtu fletët e punës në A3:

- “Luaj me numra - nga numri 1 - 5”
- “Luaj me numra - nga numri 6 - 10”

→ Për gjithë vitin shkollor në lidhje me temat mujore janë parashikuar **9 projekte**:

- Projekti "Vjeshta"
- Projekti "Dimri"
- Projekti "Pranvera"
- Projekti "Vera"
- Projekti "Shtëpia ime"
- Projekti "Në fermë"
- Projekti "Ushqimet"
- Projekti "Një libër për vajzat"
- Projekti "Një libër për djemtë"

- Pjesë e paketës është "*Alfabeti i gjuhës shqipe*", i cili u shërben fëmijëve për të mbajtur mend shkronjat duke nisur nga figurat që i shoqërojnë.
- Në librin e tretë të punës së fëmijëve janë vendosur *fletë pune*, të cilat priten dhe përdoren në temat mësimore për të cilat janë parashikuar.
- Paketa didaktike përmban *kartelat me shkronjat* e mëdha të shtypit, me fjalë dhe me figura dhe *kartelat me numra*, figura, fjalë dhe paraqitjen e numrit me pikë.
- Pjesë e paketës didaktike është edhe "*Dosja e fëmijës*", e cila ndihmon mësuesin/en të organizojë punimet e fëmijëve sipas 10 muajve të vitit shkollor. Dosja përmban *kopertinat* nga muaji shtator deri në muajin qershor, *fletë pune* për

fëmijët, skeda për t'u plotësuar nga fëmijët me ndihmën e prindërve, *formate vlerësimi* dhe *vetëvlerësimi, fletë me simbole, certifikata vlerësimi* me motivacione dhe qëllime të ndryshme.

- Për prindërit janë përgatitur *3 fletë informuese*, në të cilat janë përbledhur njohuritë kryesore që do të mësojnë fëmijët nga secili program mësimor. 1 fletë tjetër informuese përmban treguesit që përcaktojnë gatishmërinë e fëmijës për në klasën e parë. Nëpërmjet këtyre fletëve, prindi ka mundësi ta ndjekë zhvillimin dhe ecurinë e fëmijës hap pas hapi.
- *Librat e punës të fëmijës* përbajnjë veprimitari praktike mbi bazën e temave të integruara ndërmjet lëndëve që zhvillohen në klasën përgatitore. Për moshën e vogël të fëmijëve, për përvojën dhe traditat e krijuara tashmë nga mësuesi/jat dhe të udhëhequr nga filozofia se loja është veprimitaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmija mëson në arsimin parashkollor, të gjitha fletët e punës janë të ndërtuar mbi bazën e kritereve pedagogjike, didaktike dhe psikologjike që shoqërojnë zhvillimin e fëmijëve të moshës 5-6-vjeçare. Gjithçka që fëmija do të mësojë gjatë vitit përgatitor do të jetë një integrim ndërmjet lojërave, veprimitarive praktike dhe temave nëpërmjet të cilave fëmijët mësojnë për veten, familjen, shoqërinë, për atdheun, për bimët, për kafshët, për lagjen, lojërat dhe për gjithçka që e rrethon dhe që e ndesh në jetën e përditshme.

Nëpërmjet vizatimeve, bisedave, lojës në role, këngëve, përrallave dhe veprimitarive të tjera fëmijët kanë mundësi të shprehen, të jasin mendime, të bëjnë pyetje dhe të fitojnë shkathësitë e nevojshme për t'i përdorur jo vetëm në mjediset e kopshtit/shkollës, por kudo që të ndodhen. Në të gjitha ushtrimet, pjesët letrare dhe veprimitaritë praktike janë mbajtur parasysh që gjithçka që është parashikuar t'i shërbejë zhvillimit të fëmijës, t'i japë mundësi atij/asaj të krijojë, t'i besohen detyra dhe përgjegjësi të përshtatshme për moshën, të respektohet individualiteti i tij/e saj, të motivohet dhe të ketë vlerësim pozitiv për veten, t'i shikojë gjërat me pozitivitet dhe të jetë dashamirës ndaj të tjerëve.

KAPITULLI II - KURRIKULA E RE E KLASËS PËRGATITORE

Sic përmendet edhe në hyrjen e dokumentit të MAShT “Kurrikula lëndore/ Programet mësimore” në klasën përgatitore “fëmijët duhet ndihmuar për t’i zhvilluar bazat themelore të të nxenit, që përfaqësojnë elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të veprimeve me numra, shkathësitë e shprehive sociale e qytetare, por dhe të kuptuarit e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive të tyre që do t’u ndihmojë të rrisin gatishmërinë e tyre për shkollimin fillor dhe për jetë”.

Kurrikulat lëndore/programet mësimore janë hartuar për shtatë fusha kurrikulare, përkatësisht për lëndët mësimore që dalin nga këto fusha. Duke u nisur edhe nga kërkesat e parashtruara në programin e secilës lëndë, mësimdhënia në këtë nivel është menduar të zhvillohet e integruar pa bërë ndarje ndërmjet fushave kurrikulare dhe veprimtaritë të kalojnë natyrshëm te njëra-tjetra pa kuptuar se cilës lëndë i përket ajo që po bën.

Në klasën përgatitore mësimdhënia do të zhvillohet sipas temave mujore, javore dhe ditore, në mënyrë që tradita e deritanishme e mësuesve të vazhdojë. Formatet e planifikimit do të ndiqen ato që ka përcaktuar MASHT. Për secilën nga kurrikulat lëndore/programet mësimore janë mbajtur parasysh rezultatet e të nxenit të fushës (RNF) për shkallën e parë të Kurrikulës (Shk1) që përcaktohen në Kurrikulën Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor, rezultatet e të nxenit të lëndëve (RNL), të dhëna për tema ose koncepte dhe për zhvillimin e kompetencave kryesore të parapara në KKK.

Pikënisje për planifikimin e çdo teme, veprimtarie, loje, pune praktike etj., ka qenë rezultati i të nxenit dhe mënyra se si ai mund të arrihet nga fëmijët. Gjithashtu, krahas kërkesave të kurrikulave lëndore/programeve mësimore, grupi i punës është mbështetur edhe te dokumenti i “Standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme” sepse ato

përshkruajnë pritshmëritë për *sjelljen* e fëmijëve, për *performancën* dhe *arritshmëritë* e tyre në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe të mësuarit. Duke qenë se Standardet janë hartuar për zhvillimin e plotë të fëmijës, është mbajtur parasysh çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët e moshës 5-6 vjeçare.

Çdo temë mësimore, përrallë, vjershë, veprimtari, lojë etj., është menduar me kujdes dhe duke mbajtur në mendje që çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë që ka, karakteristikave individuale, shoqërore, nivelit ekonomik të familjeve të tyre, prirjeve apo nivelit të aftësive të përfitojë nga gjithçka që ndodh në klasë, por jo vetëm. Gjithashtu, në vëmendje janë mbajtur edhe trajtimi dhe ndërthurrja me temat mësimore të temave ndërkurrikulare, të cilat zhvillojnë te fëmijët rezultate për arsim dhe zhvillim të qëndrueshëm, edukimin për medie, për diasporë etj.

Sic do të vihet re nga analiza e kurrikulës së re të klasës përgatitore, në qendër të secilit program mësimor është fëmija, rrethuar me gjithçka që i ofron familja, shkolla, lagjja, shoqëria, mjedisit fizik e jetësor me qëllim që të mësojë të formojë identitetin e vet, të krijojë marrëdhënie të shëndosha me të tjerët, të njohë të drejtat, të marrë përgjegjësi, të fitojë aftësi që e përgatisin për jetën. Nëpërmjet kërkesave që kanë programet e reja mësimore dhe e gjithë paketa e re kurrikulare me të gjitha dokumentet e produhuara deri tani, në vëmendje të ndryshimeve është krijimi i brezave të fëmijëve si *komunikues efektivë*, si *mendimtarë kreativë*, si *nxënës të suksesshëm*, si *kontribues produktivë*, si *individë të shëndetshëm* dhe si *qytetarë të përgjegjshëm*. Pra, fëmijë që përmbushin kompetencat kyçe.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë shqipe

Në klasën përgatitore, fëmijët përvetësojnë dhe zhvillojnë elementet bazike të shkathtësive të komunikimit, si të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, në përshtatje me kërkesat e programeve mësimore. Shkathtësitë e komunikimit lidhen me të gjitha fushat kurrikulare dhe çdo veprimtari që fëmija zhvillon kalon nëpërmjet procesit të të dëgjuarit, të të folurit, të të shprehurit dhe të vepruarit.

Gjatë çdo dite, fëmijës herë-herë i duhet *të lexojë* apo të bëjë gjoja sikur, *të shkruajë* me mjete të ndryshme shkrimi, *të vizatojë*, *të ngjyrosë*, *të krijojë*, *të qarkojë*, *të lidhë*, *të plotësojë*, *të presë*, *të ngjisë*, *të bëjë pyetje*, *të japë mendim*, *të shfaqë interes*, *dëshirë*, *emocion pozitiv* dhe *të interpretojë* atë çfarë ka bërë apo realizuar. Pra në çdo veprimtari fëmija mëson çfarë do të bëjë dhe tregon se çfarë di të bëjë. Veprimtaritë planifikohen nga mësuesi/ja të ndërthurura për punë individuale, për punë në çift, punë në grupe të vogla apo punë me të gjithë fëmijët.

Rezultatet e të nxenit të lëndës së gjuhës shqipe realizohen nëpërmjet vjershave, përrallëzave, përrallave, tregimeve, fabulave dhe gjëegjëzave, ashtu siç kërcohët në programin mësimor të kësaj lënde. Zhvillimi gjuhësor i fëmijës realizohet nëpërmjet pyetjeve, bisedave, diskutimeve, lojës në role etj., duke kaluar nga procesi i njohjes, te të kuptuarit, te analizimi, te përgjithësimi, te gjykimi e deri te dhënia e mendimit vetjak apo te zhvillimi i aftësive krijuese.

Pjesë e zhvillimit gjuhësor të fëmijës është edhe njohja e shkronjave, drejtshqiptimi i tingujve, leximi, kopjimi ose shkrimi i fjalëve dhe i fjalive të shkurtra që kanë lidhje me temat dhe bisedat e përditshme.

Përdorimi i pjesëve letrare ka për qëllim që fëmija ta kuptojë përmbajtjen, të dallojë personazhet, të analizojë veprimet e tyre, të gjejë raste apo situate në të cilat është ndodhur edhe ai vetë, të mbajë një qëndrim, të nxjerrë mësime për veten, të japë këshilla, të ritregojë përmbajtjen me fjalët e veta duke mbajtur parasysh tri etapa: fillimin, zhvillimin dhe mbylljen e një historie. Çdo përrallë, tregim, vjershë, situatë jetësore që është përcaktuar në plan jepet me ilustrime, në mënyrë që fëmija të bëjë interpretim, të bëjë sikur të lexojë dhe ta ketë më të lehtë për të treguar rrëth tyre. Të mësuarit e fëmijës zhvillohet nëpërmjet konkretizimit, prandaj edhe në veprimtaritë e përzgjedhura është mbajtur parasysh që çdo gjë t'i tregohet fëmijës apo të drejtohet për të bërë "zbulimet" e veta.

Të gjitha ilustrimet në libër janë realizuar nëpërmjet pikturave të bëra enkas për këtë paketë didaktike. Fotografitë nga jeta e përditshme, figurat, lodrat dhe objektet që fëmija i prek dhe luan me to janë parashikuar në tema të caktuara mësimore ku është menduar se nëpërmjet tyre fëmija e merr më mirë mesazhin që i është përcjellë.

Fëmijëve u pëlqejnë lojërat simbolike, lojëra ku ata vishen në rolin e një personazhi tjeter. Për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve, si dhe për pasurimin e fjalorit të tyre në shumë tema mësimore janë parashikuar lojërat në role, ku fëmijët interpretojnë për tema nga jeta e përditshme në familje, shkollë, lagje, dyqan, park etj.

Mësimi i shkronjave të shtypit, drejtshqiptimi i tingujve, leximi dhe shkrimi i fjalëve realizohet nëpërmjet lojërave, veprimtarive praktike, vizatimeve, punimeve me materiale të riciklueshme etj. Për përsëritjen e shkronjave janë përzgjedhur 6 lojëra didaktike, të cilat fëmijët mund t'i plotësojnë në fillim në grup e më pas në mënyrë individuale.

Ndër pyetjet bazë për temat dhe veprimtaritë që kanë lidhje me gjuhën shqipe, por jo vetëm renditen pyetje të tillë, si:

- Për çfarë bën fjalë kjo/ ky...?
- A veproi siç duhet...? Çfarë këshille do t'i jepje...?
- Si fillojnë përrallat?
- Ku zhvillohet ngjarja?
- Ç'do të bëje nëse do të ishe në vendin e ...?
- Çfarë tregohet në këtë figurë?/ Kush ka dalë në këtë fotografi?
- Çfarë të kujton ky objekt?
- Cila është radha e këtyre figurave?
- Cili është mesazhi? Çfarë mësojmë nga...?
- A je ndodhur edhe ti në një situatë të tillë?
- Si ndihesh kur dëgjon këto fjalë?
- Çfarë të pëlqen të vizatosh nga ...?
- Cila është pjesa që të pëlqen më shumë? etj.

Lënda e gjuhës angleze bën pjesë në fushën kurrikulare “Gjuhët dhe komunikimi”. Edhe pse ka specifikat e saj, programi mësimor përcakton trajtimin e temave të njëjta me temat që fëmija i zhvillon në gjuhën shqipe, siç është tema e përshëndetjeve, e prezantimeve, e shkollës, e shokëve, e familjes, e lodrave dhe e lojërave, e kafshëve shtëpiake, e frutave dhe e perimeve, e numrave deri në 10 dhe e formave etj. Këto tema dhe renditja e tyre janë mbajtur parasysh në planifikim për integrimin e tyre me lëndët e tjera të klasës përgatitore.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë figurative

Aftësitë krijuese fëmija i shpreh me shkarravina dhe vizatime, nëpërmjet të cilave shfaq botën e brendshme, dëshirat, ndjenjat, emocionet, atë çfarë i pëlqen ose jo, mënyrën si e sheh veten, të tjerët dhe mjedisin që e rrethon. Gjithashtu, arti zhvillon te fëmijët fantazinë, imaginatën dhe një botë e cila mund të shprehet me vizatim.

Ndër veprimtaritë që bëhen në ditët e para është vizatimi dhe kjo jo vetëm për ta njohur fëmijën dhe botën e tij të brendshme, por edhe për t'i dhënë mesazhin që fëmija edhe në klasën përgatitore do të vazhdojë të bëjë gjëra që i ka bërë edhe kur ka qenë më i vogël, do të vazhdojë të luajë e të mësojë nëpërmjet saj.

Si Edukata figurative, ashtu edhe Edukata muzikore janë dy lëndë që i përkasin fushës kurrikulare të Arteve, dhe veprimtaritë artistike, si vizatimi dhe kënga janë shumë domethënëse dhe të nevojshme për fëmijën, njësoj si lojërat dhe lodrat me të cilat nuk lodhet së luajturi.

Nëpërmjet veprimtarive dhe krijimeve artistike, mësuesi/ja fillon të kuptojë se ku ka më shumë interes fëmija. 4 veprimtaritë bazë që zhvillohen me fëmijët janë *vizatimi, pictura, modelimi* dhe *stampimi*. Sipas temave mësimore fëmijët vizatojnë me laps, ngjyrosin me ngjyra, modelojnë me plastelinë, stampojnë dhe përdorin si stampa materialet dhe objektet që i gjejnë në natyrë ose në mjedisin përreth, ndërtojnë me kuba dhe formuese, duke kombinuar ngjyra, forma dhe madhësi, realizojnë mozaikë, punim mural ose makete në grup, për të ndier dhe vlerësuar rolin e bashkëpunimit me njëri-tjetrin.

Punimet me letër, aplikacionet me letra me ngjyra, kolazhet me materiale natyrale dhe organike janë disa nga veprimtaritë kryesore nëpërmjet të cilave fëmijët zhvillojnë dhe shfaqin aftësitë krijuese. Pyetjet e shokëve dhe të mësuesi/jat për t'u shprehur rreth atyre që kanë krijuar, i ndihmon fëmijët të shprehin copëza nga ajo që ndiejnë dhe përjetojnë. Ndër to pyetje të rëndësishme janë:

- Çfarë ke vizatuar këtu? Të pëlqen çfarë ke vizatuar?
- Pse ke përdorur këtë/ këto ngjyra?
- Çfarë mund të ndërtosh me kuba?
- Çfarë materialesh ke përdorur për të bërë këtë punim?
- Cilat vija janë përdorur në këtë vizatim?
- A do t'i shtosh ndonjë element të ri punimit?
- Çfarë i mungon figurës?
- Çfarë të pëlqen më shumë: të vizatosh, të ngjyrosësh, të modelosh, të stamposh apo të bësh kombinime të ndryshme?
- Çfarë ke përdorur si stampë në këtë punim? Etj.

Për të shprehur fantazinë dhe imagjinatën janë parashikuar tema të lira që fëmija të shprehet dhe të krijojë ashtu siç mendon, pa iu referuar modeleve të caktuara. Edhe pse të vegjël, fëmijët mësojnë të përdorin elementet dhe parimet mbi të cilat ndërtohet arti, mësojnë të reagojnë ndaj përjetimit të një vepre artistike, të çmojnë dhe të vlerësojnë krijimet artistike vetanake dhe të të tjera.

Veprimtaritë që zhvillohen në lëndën e Edukatës figurative janë të integruara me temat që zhvillohen në lëndët e tjera, sepse siç e kemi përmendur edhe më sipër temat dhe veprimtaritë janë të ndërthuara me njëra-tjetrën. Po ashtu, ato kanë lidhje edhe me temat ndërkurrikulare që kanë të bëjnë me *zhwillimin e qëndrueshiën, të drejtat e tyre, çështjet e barazisë gjinore, kulturat dhe ndërkulturat* etj.

Temat nga jeta e përditshme kanë lidhje me pjesëmarrjen dhe organizimin e ngjarjeve të ndryshme artistike, si dhe njohjen me institucionet artistike si: *galeria, teatri, muzeu, vendbanimet arkeologjike, studiot artistike, të fotografisë, dizajnit, arkitekturës* etj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë muzikore

Muzika është pjesë e fushës së arteve dhe si e tillë ajo ndikon në zhvillimin e të bukurës, të prirjeve dhe të aftësive muzikore të fëmijës që në moshë të vogël. Aktiviteti muzikor ka për qëllim të sjellë te fëmijët gëzim, hare, kënaqësi emocionale, çlodhje dhe dëshirë përfshirë në lojëra dhe veprimtari muzikore, por jo vetëm.

Në program janë parashikuar të zhvillohen me fëmijët këngë të thjeshta, lojëra muzikore, lojëra në instrumente muzikore, dëgjime muzikore të tingujve, melodi të ndryshme, vepra klasike etj., kërcime dhe vallëzime të thjeshta të cilat nxisin zhvillimin emocional, social dhe prirjet artistike të fëmijës. Nëpërmjet tyre fëmija këndon këngë, ritmizon vargje dhe ritme, shoqëron me mjete të ndryshme, luan lojëra muzikore, dallon vetitë e tingullit, dallon llojet dhe gjinitë e muzikës, krijon instrumente, shpreh ndjenja dhe mendime.

Për vlerat që mbart arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti, në zërthimin tematik të programit dhe në zhvillimin e veprimtarive të përditshme janë planifikuar lojëra dhe verprimtari muzikore nga më të larmishmet, të lidhura dhe të ndërthurura me temat mësimore të lëndëve të tjera që zhvillohen në klasën përgatitore. Të gjitha këngët dhe dëgjimet muzikore janë dhënë me adresat përkatëse të internetit të cilave u janë referuar.

Krijimi i veglave të thjeshta muzikore, popullore dhe klasike, shoqërimi i ritmit të këngëve me mjete, vegla, lodra dhe lëvizje trupore, mimika e fytyrës etj., janë veprimtari të dashura përfëmijë dhe të përshtatshme përfshirë. Rezultatet e të nxënës si përfshirë ashtu edhe përlëndë janë mbajtur parasysh në planifikimin e këngëve, të lojërage dhe veprimtarive të tjera muzikore. Këngët janë përzgjedhur me përbajtje të tillë që lidhen me temat mësimore që

trajtohen në fushat e tjera kurrikulare, të tillë si këngë për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj. këndimin e këngëve fëmijët i shoqërojnë duke trokitur duar, këmbë, lapsa, shkopinj etj.

Duke dëgjuar instrumentet muzikore fëmijët dallojnë tingullin dhe vetitë e tij. Ndër pyetjet që mund t'u drejtohen fëmijëve në veprimtaritë muzikore janë:

- A ka ritëm kjo muzikë?
- A na bën të kércejmë kjo muzikë?
- Kush bën tekste për fëmijë? Po këngët kush i bën?
- Cila është kënga e fundit që ke mësuar?
- Kur e këndojmë këtë këngë?/ Në cilin rast? (p.sh: Gëzuar ditëlindjen!)
- E kujt filmi është kjo muzikë?
- Në cilën ngjarje, kohë, muaj e dëgjojmë këtë këngë/ muzikë?
- A të pëlqen kjo këngë?
- I kujt është ky zë? Etj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë

Siç përmendet edhe në programin mësimor “*të mësuarit e matematikës në klasën përgatitore, siguron bazën për zotërimin e shprehive dhe shkallitësive matematikore dhe i përgatit fëmijët për të qenë të suksesshëm në vitet e mëtejshme të shkollimit*”. Edhe pse është lëndë dhe ka program të veçantë, konceptet matematike janë të integruara brenda temave javore dhe zhvillohen si pjesë e veprimtarive të planifikuara ditore. Ato zhvillohen nëpërmjet lojërave didaktike, nëpërmjet ushtrimeve praktike, situatave problemore nga jeta e përditshme, veprimeve me objekte konkrete, nëpërmjet lojërave muzikore etj. Pjesë e këtyre veprimtarive janë temat dhe çështjet ndërkurrikulare të përmendura në program. Rezultatet e të nxenit janë pikënisja për gjetjen e veprimtarive, të lojërave dhe ushtrimeve, në mënyrë që fëmija të mësojë nëpërmjet lojës konceptet bazë për numërimin, për numrat deri në 10-të, për krahasimin e sasive, për kryerjen e veprimeve të mbledhjes e të zbritjes, të kryejë matje me mjete jo standarde, të dallojë kohën, të realizojë modelime, të kuptojë konceptet për figurat dhe trupat gjeometrikë, orientimin dhe vendndodhjen e objekteve në hapësirë, të lëvizë sipas drejtimit të kërkuar etj.

Për trajtimin e koncepteve matematike janë menduar një sërë materialesh që fëmija i gjen në mjedisin përreth dhe i përdor në konkretizimin e veprimeve dhe të situatave. Për realizimin e tyre mësuesi/jat i është lënë hapësirë që t'i zhvillojë konkretisht me fëmijët, sidomos koncepte që janë të vështira dhe duhen kohë të përvetësohen siç është koha, orientimet, modelimet etj. Veprimet kryesore që fëmija do të bëjë fëmija në matematikë janë: numërimi, kopjimi, vizatimi, modelimi, krahasimi, radhitja, mbledhja dhe zbritja, grupimi, veçimi, klasifikimi, krahasimi, matja, përshkrimi, lëvizja, leximi, dallimi, gjetja, plotësimi etj. Gjetja e veprimtarive të duhura do të bëjë të mundur që fëmija t'i përvetësojë konceptet e matematikës pa kuptuar që është në orën e saj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Njeriu dhe natyra

Fëmija parashkollar është i prirur të shfaqë interes për botën që e rrethon, për njerëzit, kafshët dhe dhe mjeshter me të cilat ndeshet në jetën e përditshme. Kurioziteti, pyetjet e shumta, dëshira për të eksperimentuar, kënaqësia e nxjerrjes së përfundimeve të njohura janë procese që zënë vend natyrshëm në lëndën “Natyra dhe njeriu”. Kërkesat e programit dhe rezultatet e të nxenit janë lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me lojërat dhe veprimtaritë që zgjojnë interesimin dhe këershërinë e fëmijëve duke u mundësuar të njohin dhe hulumtojnë botën përreth tyre, të provojnë gjëra për të parë se çfarë do të ndodhë, të dallojnë karakteristikat fizike të objekteve dhe materialeve, karakteristikat e botës së gjallë, ndryshimet klimatike, ndryshimet në Tokë, zgjedhin dhe përdorin mjete dhe materiale të ndryshme për të.

Nëpërmjet integrimit ndërlendor të temave është bërë e mundur që këto koncepte fëmija t'i marrë edhe nëpërmjet tregimit, nëpërmjet lojës, t'i shprehë me vizatim, t'i përshkruajë me fjalë dhe të gëzohet që zbuloi apo mësoi diçka të re. Edhe pse fëmijët përhumben në aktivitete të tillë zbuluese, janë marrë parasysh që një veprimitari të zgjasë aq sa ata të përfshihen në mënyrë maksimale pa u mërzitur dhe lodhur nga ajo çfarë janë duke bërë.

Çdo gjë është e mundur për t'u realizuar, prekur, vëzhguar dhe kuptuar nga ana e fëmijëve. Të gjitha temat e parashikuara në program janë të mundura të integrohen me temat nga lëndët e tjera, të tillë si temat për materialet dhe vëtitë e tyre, bimët, kafshët dhe njeriu, trupat dhe lëvizjet e tyre, Toka dhe hapësira. Po ashtu edhe konceptet që zbërthehen nëpërmjet tyre. Puna me projekte, realizimi i maketeve, libérthave të vegjël, i posterave dhe i mënyrave të tjera sensibilizuese janë pjesë e planifikimeve të parashikuara në këtë lëndë.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Shoqëria dhe mjedisi

Çdo fushë kurrikulare dhe çdo lëndë mësimore luan një rol të rëndësishëm e të veçantë në zhvillimin dhe në formimin e përgjithshëm të fëmijës. Vlerat dhe qëndrimet si individ, si anëtar grupi, si pjesëtar i shoqërisë me të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë fëmija i mëson, në mënyrë të veçantë, në lëndën “Shoqëria dhe mjedisi”. Njohuritë e kësaj lënde i mundësojnë fëmijës të mësojë si të jetojë së bashku me të tjerët, si të ndajë me ta, si të krijojë besimin te vetja, sitë bashkëpunojë me të tjerët, si të kujdeset për veten, pjesëtarët e familjes, shokët, kafshët, bimët etj.

Nëse te lënda “Natyra dhe njeriu” fëmija nxitej të eksploronte kryesisht mjedisin fizik, në këtë lëndë fëmija nxitet të eksporojë dhe të mësojë më shumë për mjedisin shoqëror që e rrethon, për të njohur më mirë vetveten, familjen, bashkësinë dhe mjedisin jetësor. Nëpërmjet pjesëve letrare, ngjarjeve të publikuara në media, situatave reale fëmija fiton njohuri për rregullat e jetës kolektive, mëson të marrë vendime të thjeshta të përshtatshme për moshën e tij, të kultivojë respektin dhe kujdesin ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit, në mënyrë që në të ardhmen të bëhet një qytetar i përgjegjshëm.

Temat “Unë dhe të tjerët”, “Vendi/ mjedisi ku jetoj”, “Festat”, “Unë dhe rregullat”, “Përgjegjësitë e mia”, “Unë vendos për veten time” dhe “Kujdesi për mjedisin rrethues” janë përcaktuar të trajtohen në mënyrë të integruar me tema të ngjashme me lëndët e tjera. Nëpërmjet veprimitarive të planifikuara fëmija mëson kush është, përshkruan veten dhe shprehët rrëth saj, mëson kush është familja, cila është përbërja e saj, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve, rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve, por edhe të fëmijëve për aq sa munden, cili është roli i tij në klasë, marrëdhëniet dhe rregullat në shoqëri, respekti për njerëzit e punës, për shërbimet në lagje, festat dhe veprimitaritë e tjera familjare dhe shoqërore, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukata fizike, sportet dhe shëndeti

Zhvillimin fizik dhe lëvizor ndodh vrullshëm në vitet e fëmijërisë së hershme. Ai ndikon në formimin e përgjithshëm psiko-fizik, social-emocional, shëndetësor dhe shoqëror të fëmijëve. Siç theksohet edhe në programin mësimore të kësaj lënde “Procesi i edukimit fizik dhe shëndetësor luan rol themelor në përgatitjen e fëmijëve për realizimin e veprimtarive kulturore-sportive dhe artistike. Ky proces merr rëndësi të veçantë veçanërisht në realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të tjera të kombinuara me ato artistike, shoqërore e shëndetësore”. Në mënyrë të veçantë kjo lëndë synon që fëmijët të zhvillohen plotësisht në përputhje edhe me standardet e kësaj fushe në aspektin fizik, psikik, social dhe emocional, të kujdesen për veten dhe të tjerët, të kuptojnë situatat e rrezikshme, t'i dallojnë e të dinë si të veprojnë për parandalimin e tyre.

Zhvillimi harmonik i trupit nëpërmjet aktiviteteve fizike, lojërave popullore, lëvizore e sportive ndikojnë në krijimin e një kulture dhe të një stili jete aktiv dhe të shëndetshëm. Koordinimi i lëvizjeve, përqendrimi, dëgjimi i komandave dhe zbatim i tyre ndikon pozitivisht te fëmija edhe për aspekte të tjera të lidhura në mënyrë të tërthortë me edukimin fizik.

Të gjitha rezultatet e të nxënët përmbushen nëpërmjet lojërave, veprimtarive fizike e lëvizore, demonstrimeve, lojërave të thjeshta të cilat organizore sanë mënyrë individuale, aq edhe në çift dhe në grup. Në të gjitha nivelet e planifikimit, lojërat dhe veprimtaritë fizike, ashtu edhe si veprimtaritë artistike zënë një vend të rëndësishëm duke ndërthurur si veprimtaritë e qëllimshme ashtu edhe lojërat e lira dhe aktivitetet që fëmijët i shpikin apo i krijojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Në planifikimin e veprimtarive fizike, sidomos në lojërat me skuadra apo në gara ndërmjet fëmijëve është mbajtur parasysh edhe puna për menaxhimin e emocioneve dhe të veprimeve si në rastin e fitores, ashtu edhe të humbjes. Loja, edhe pse është veprimitaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmija mëson, duhet mirëmenaxhuar nga mësuesi/ja në mënyrë që fëmija të mos kalojë në mbingarkesë dhe në mungesën e dëshirës për të marrë pjesë në lojë. Duke patur parasysh këtë fakt është bërë një parashikim i kujdeshshëm i lojërave dhe i veprimtarive fizike që ndërthuren gjatë ditës mësimore në përshtatje edhe me veprimitaritë nga lëndët e tjera. Në mënyrë të natyrshme edukimi fizik dhe sportiv lidhet me muzikën, vallëzimin, "shpikjen" e lëvizjeve të reja etj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Shkathësi për jetën

Arsimi parashkollar deri në moshën 5-vjeçare nuk është i detyruar. Në klasën përgatitore, fëmijët vijnë nga mjedise të ndryshme familjare. Nëpërmjet situatave të thjeshta jetësore dhe aktiviteteve praktike fëmija njihet me materiale dhe pajisje teknike konkrete, ushtrohet në punë praktike dhe në lojë në role, duke zhvilluar shkathësi për jetën dhe punën.

Programi mësimor i kësaj lënde është i rëndësishëm për t'u vlerësuar nga mësuesi/ja njësoj si edhe programet e tjera mësimore, sepse nëpërmjet temave të tij fëmija krijon kulturë bashkëpunimi, kontributi dhe bashkëpjesëmarrjeje në ekonominë familjare dhe në mjedisin jetësor.

Tema të tillë si “Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla”, “veglat, mjetet e punës dhe pajisjet elektronike”, “Materialet dhe riciklimi”, “Profesionet” dhe “Planifikimi i buxhetit familjarit” trajtohen të integruara së bashku me temat nga lëndët e tjera, për vetë natyrën që ka ky program mësimor.

Puna dhe edukimi për ndërmarrësi dhe për zhvillim të qëndrueshëm trajtohen në mënyrë specifike në programin “Shkathësi për jetën”. Loja në role, planifikimet e përbashkëta, diskutimi situatave problemore, gjetja e zgjidhjeve dhe marrja e vendimeve të duhura i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë shkathësitë e nevojshme për jetën dhe punën.

KAPITULLI III - PLANIFIKIMI I KURRIKULËS SË RE

Kurrikula e re e arsimit parashkollar është e ndërtuar me fusha të nxëni, pjesë e të cilave janë lëndët mësimore dhe programet e tyre. Për natyrën dhe specifikën që ka mosha 5-6-vjeçare, është menduar që zberthimi dhe realizimi i kërkesave të kurrikulës së re të bëhet sipas planifikimeve mujore, ku rezultatet e secilit program mësimor realizohen nëpërmjet aktiviteteve të ndërthurura nga të gjitha lëndët që zhvillohen në klasën përgatitore.

Në programin e ri që ka nxjerrë MASHT, numri i orëve javore është lënë në total 18 orë, duke mos bërë parashikime në ndarje orësh mes lëndëve. Duke u nisur nga specifikat e zhvillimit moshor të fëmijëve, nga standarde e zhvillimit dhe të të mësuarit, si dhe nga i gjithë dokumentacioni kurrikular, **kjo paketë didaktike është konceptuar si një bashkësi materialesh, fletash pune dhe veprimitari që i integrojnë lëndët me njëra-tjetrën dhe përmbushin rezultate të nxëni përtej një lënde.**

Planifikimi rrjedh nga rezultatet e të nxënës. Njohuritë që fiton fëmija në klasën përgatitore kanë lidhje dhe trajtohen në tema të jetës së përditshme, me të cilat ai ndeshet çdo ditë në mjedisin ku jeton, mëson dhe luan.

Në renditjen e rezultateve të të nxënës dhe në planifikimin e aktiviteteve janë mbajtur parasysh parimet e kalimit nga e njohura te e panjohura; nga veprimet që ndodhin tani tek veprimet që kanë ndodhur në të shkuarën dhe parashikimet për të ardhmen; nga veprimet me situata, ngjarje dhe objekte konkrete në situata që kërkojnë kohë më tepër për t'u menduar nga ana e fëmijëve sigurisht brenda moshës që ata kanë; nga analiza e pjesëve të veçanta te kalimi te e përgjithshmja, por herë-herë duke bërë ndërthurrje të këtyre kalimeve.

Në parashikimin e temave, të veprimtarive dhe të lojérave, janë mbajtur parasysh **parimet e diversitetit dhe të dimensionit gjinor**. Të gjitha veprimtaritë e parashikuara *për* dhe *me* fëmijët i jatin rëndësi të njëjtë të gjitha aspektave zhvillimore të fëmijës, dhënien e mundësive të njëjta si vajzave dhe djemve *për* të përfituar nga kurrikula, shhangjen e çdo aspekti edukimi që mund të jetë i përshtatshëm *për* njërin apo *për* tjetrin grup, është mbajtur parasysh baraspesha gjinore *për* rastet e paraqitura dhe *për* punët në çift dhe në grupe, shhangjen e parapëlqime *për* njëren gjini përkundrejt gjinisë tjetër etj.

Siq parashikohet edhe në programet mësimore, rreth moshës 5-6 vjeç, fëmija vendos një raport me veten, dhe ky rapport identifikohet me atë që fëmija di rreth emrit, nëse i pëlqen, kush ia ka vendosur emrin që ka etj., tregon *për* veten duke iu referuar cilësive fizike, preferencave, mendimeve, ndjenjave dhe mënyrës së sjelljes, tregon *për* rolin dhe vendin që zë në familje krahasuar me pjesëtarët e tjerë, në raport me vëllain/motrën, tregon kombësinë që i përket, gjuhën që flet dhe elemente të tjerë të identitetit kombëtar e kulturor; pyet fëmijët e tjerë rreth familjes, kombësisë, kulturës dhe i dëgjon me vëmendje kur ata përgjigjen.

Duke u nisur nga treguesit e mësipërm fëmijët e kësaj moshe janë të prirur të krijojnë sterotipi sjelllore, me bazë gjininë, diskriminim, gjithëpërfshirjen dhe diversitetin. Për këtë arsyе janë parashikuar veprimtari të qëllimshme ku vajzat dhe djemtë lihen të lirë të zgjedhin rolet gjatë një lojë, lodrën që pëlqeijnë, ngjyrat që pëlqeijnë, moshatarin/moshataren që pëlqeijnë, përrallën që pëlqeijnë, punimin që pëlqeijnë dhe çdo gjë tjetër që pëlqeijnë dhe më pas, mësuesi/ja merr shkas *për* të nxitur diskutime, mendime alternative, debate me thekse gjinore, përfshirje sociale, mosdiskriminime etj.

Nëpërmjet temave mësimore, lojérave të ndryshme, përzgjedhjeve “të rastësishme” të roleve dhe detyrate që u ngarkohen gjatë lojérave simbolike, përrallave, vjershavë, tregimeve etj., fëmijët prezantohen me role, detyra dhe punë të ndryshme që mund t'i bëjë secili prej tyre, qoftë djalë apo vajzë.

Fëmijët, vajza/djem, duhet të ndihmohen si të bashkeveprojnë me njëri-tjetrin, si të evitojnë shenjat e diskriminimit, si t'i pranojnë bashkëmoshatarët përtej gjinisë, racës, etnisë, gjendjes fizike, duke evituar situate ku fëmijët mund të ndihen të "përjashtuar". Kujdesi për veshjet, sendet personale, lodrat, mjedisi fizik ku luajnë, dhoma e tyre, tavolina ku vizatojnë dhe kryejnë veprimitari, éshtë detyrë për çdo fëmijë.

Mësuesi/ja, "heton" në sjelljet e përsëritura të fëmijëve dhe në parapëlqimet e tyre. Identifikon tendencat e fëmijëve se çfarë zgjedhin të veshin, rregullimit të flokëve, përdorimit të emrave përkëdhelës, sjelljeve të ndryshme që shfaqin, gjesteve që bëjnë, fëmijëve me të cilët priren të luajnë, modele të të rriturve që imitojnë, lodrat që pëlqejnë, lojërat ku përfshihen etj. Për secilin fëmijë mësuesi dallon sjelljet me frekuencë më të lartë, mëson më shumë rrith identitetit gjinor, sa fëmija, vajzë/djalë, éshtë i diskriminuar, sa priret të gjithëpërfshihet, ose sa shfaq sjellje përjashtuese.

Në moshën parashkollore fëmijët mësojnë një sërë aftësish sociale dhe emocionale, të tilla si: vetëbesimin, aftësinë për të ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhënie me bashkëmoshatarët; aftësinë për t'u përqendruar dhe për të këmbëngulur në përbushjen e kryerjes së detyrave sfiduese për ta; aftësinë për të njohur dhe për t'ua komunikuar të tjerëve emocionet e tyre etj.

Zhvillimi social dhe emocional éshtë i rëndësishëm për fëmijën për krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme me të tjeter. Në moshën 5-6 vjeç, fëmija jep arsyé për emocionet që përjeton, ndan me të tjeter (bashkëmoshatarët dhe familjarët) ndjenjat dhe emocionet, qetëson emocionet negative ose impulset e çastit, duke bërë diçka tjetër në vend të shprehjes së tyre, pranon mërzinë në rastet kur gjendet në një situatë të vështirë apo një ngjarje të rëndë. Fëmijët kanë nevojë të qeshin, të ndihen të lumtur e t'u gëzohen gjëra e bukura që i përjetojnë çdo ditë në shtëpi pranë familjes, në kopsht pranë shokëve dhe mësuesi/jat, në këndin e lojërave me fëmijë të tjera dhe në çdo mjedis tjetër.

Në jetën e përditshme përjetojmë ndjenja dhe emocione të ndryshme, herë-herë edhe mund të kalojnë nga njëra gjendje emocionale në tjetrën. E rëndësishme është ta shprehin gjendjen, të kuptojnë shkakun dhe të gjejnë zgjidhje për përmirësimin e saj. Edhe pse fëmijët kanë cilësi të ngjashme apo shije të përbashkëta me fëmijë të tjerë, njëkohësisht kanë shumë gjëra që i bëjnë unikë dhe të ndryshëm nga të tjerët. Të pranosh e të kuptosh ngjashmëritë dhe ndryshimet është shumë e rëndësishme për fëmijët, veçanërisht për ata me nevoja të veçanta.

T'u mësosh fëmijëve diversitetin bën të mundur që fëmijët të shohin nga këndvështrimi i të tjerëve, të shohin e të duken në sytë e të tjerëve, me zemrën dhe mendjen e të tjerëve. Fëmijët duhet ta kuptojnë që të gjithë fëmijët e grupit (kopshtit) janë njësoj të rëndësishëm dhe meritojnë mundësi të barabarta edukimi.

Në moshën parashkollore, shpesh fëmijët shfaqin shenjat e para të paragjykimit të shokëve apo shoqeve të caktuar, paragjykime që vijnë si rezultat i mospëlqimit të pamjes së jashtme, i mënyrës apo ngjyrës së veshjeve, i lodrave me të cilat luan etj. Duke qenë të vegjël e kanë disi të vështirë të kuptojnë nëse dhe në ç'mënyrë e kanë *fyer* një shok apo një shoqe.

Nga muaji shtator deri në muajin qershor janë parashikuar 10 tema mujore, të cilat ndahen përkatësisht në tema javore.

Periudhat	Muajt	Temat mujore
1	Shtator	Shkolla po më pret
	Tetor	Mirë se erdhe vjeshtë e artë!
	Nëntor	Shtëpi, e ëmbla shtëpi
	Dhjetor	Dimër dhe të dua dhe s'të dua
2	Janar	Për një trup të fortë e të shëndetshëm
	Shkurt	Sa të dua Kosova ime!
	Mars	Në qytet apo në fshat?
3	Prill	Mirë se erdhe moj pranverë!
	Maj	Mjetet e transportit
	Qershor	Vera na fton në pushime

SHKOLLA PO MË PRET



Specifikat e punës në muajin shtator

Përshtatja e fëmijëve me orarin e ri ditor, me mjedisin shkollor, me mësuesin/en dhe shoqërinë e re që gjen në klasë

Muaji shtator është një muaj shumë i rëndësishëm dhe duhet vlerësuar si duhet nga mësuesi/ja dhe prindërit. Fëmija vjen për herë në shkollë dhe siç thotë populli “Fillimi i mbarë, gjysma e punës”.

Tema e zgjedhur për muajin shtator është e përqendruar më tepër në nxitjen e zhvillimit gjuhësor dhe të zhvillimit social-emocional të fëmijëve. Ndër temat javore që zhvillohen gjatë këtij muaji janë menduar:

- Klasa, mësuesja dhe shokët e rinj,
- Mjediset dhe njerëzit që takoj në shkollë,
- Rregullat e shkollës dhe sjelljet e kulturuara,
- Në shkollë vijmë të pastër dhe të rregullt.

Në përgjithësi, pjesa më e madhe e ditëve në muajin shtator shkon për **përshtatjen e fëmijëve** me mjedisin e ri, me krijimin e urave të komunikimit, të njoħjes së temperamenteve të fëmijëve dhe me krijimin e një mjedisi të qetë, të këndshëm dhe mikpritës për secilin prej tyre. Me fillimin e shkollës, fëmijët ndjekin një orar të ri ditor, prandaj çdo ditë ata nxiten të flasin për veprimet rutinë të mëngjesit dhe të paragjumit.

Në klasë vijnë fëmijë që e kanë frekuentuar më parë kopshtin, fëmijë të cilët vijnë nga shtëpia, fëmijë që vijnë nga familje me problematika të ndryshme, fëmijë të cilët janë të ndjeshëm, fëmijë hiperaktivë, fëmijë të ndrojtur etj. Në këtë përbërje klase, mësuesi/ja përpinqet të krijojë një **klimë të ngrohtë** për të gjithë fëmijët, të realizojë kryesisht veprimitari që u

pëlqejnë fëmijëve, të gjejë lojëra që i nxisin të krijojnë shoqëritë e para, aktivitete që i bëjnë të ndihen të rritur dhe të gatshëm pér të nisur një etapë të re të jetës së tyre. Fëmijët e vegjël ndikohen nga fjalët e të rriturit e sidomos nga mësuesi/ja. Ata e ndiejnë që në fillim dashurinë e mësuesi/jat/es; ajo çfarë ndodh në ditët e para të shkollës, bëhet bashkëudhëtare e gjithë ecurisë vjetore të fëmijës.

Gjatë javës së parë, mësuesi/ja përpinqet “të blejë” nga fëmijët **informacione rreth tyre**. Ai/ajo tregon pér veten, pér familjen, pér punën dhe përvojën me fëmijët, pér ngjarje apo momenta të rendësishme, të bukura dhe që i bën fëmijët e rinj të ndihen mirë. Duke e nisur çdo gjë nga vetja dhe rrëth saj, fëmijët fillojnë të krijojnë përshtypjet dhe pëlqimet e para. Ka fëmijë që gjejnë në klasë shokët që i kanë në lagje apo i kanë pasur në kopsht, ka fëmijë që përshtaten menjëherë, ka fëmijë që që në ditët e para zënë shoqëri, ashtu siç ka edhe fëmijë që duan të rrinë të veçuar apo të qëndrojnë të pandarë nga lodra që kanë marrë me vete.

Pra në javën e parë, mësuesi/ja drejton **procesin e njohjes me fëmijët dhe prindërit e tyre**. Nxitja e fëmijëve pér të folur, pér t'u shprehur, pér t'u marrë me veprimtaritë që duan, kërkesat e thjeshta në formë loje, dhënia e besimit dhe e vlerësimeve pozitive fëmijëve janë dominuese pér gjithçka që vijon më tej. Vëzhgimi i fëmijëve në lojërat që luajnë, në aktivitetet që marrin pjesë, me shokët që rrinë, me lodrat që mbajnë pranë, i jep mundësi mësuesi/jat/es t'i njohë më mirë fëmijët.

Ka fëmijë të cilët vijnë me lodra nga shtëpia dhe duan t'i mbajnë pranë. Ata mund të lejohen pér t'i mbajtur, derisa të përgatiten pér t'u shkëputur prej tyre. Edhe në mjediset e klasës fëmijët lihen të lirë të zgjedhin lodra, materiale dhe mjete pune, të zgjedhin veprimitari pér të vlerësuar fushat e tyre të interesit. Lojërat që mësuesi/ja zhvillon me fëmijët duhet të

ndikojnë në krijimin e shoqërive të para dhe të punimeve kryesisht në çifte ose në grupe të vogla. Është e rëndësishme që fëmijët të zënë të paktën një shok/shoqe që në javën e parë të shkollës.

Pjesë e procesit të njoftes janë edhe **mjediset e tjera të shkollës dhe njerëzit** me të cilët fëmijët do të ndeshen çdo ditë. Fëmijët mësojnë se gjatë kohës së qëndrimit në shkollë nuk do të qëndrojnë vetëm në klasë, por do të dalin edhe në oborr, do të dalin edhe shëtitje, do të shkojnë në tualet, mund të takohen edhe me vëllezër e motra më të rritur në kohën e pushimit, njihen me klasën e parë dhe me mësueset që do të kenë ndoshta një vit më pas.

Në varësi edhe të rrjedhjes së ditëve dhe të ecurisë së tyre, gjatë muajit shtator, një veprimtari e rëndësishme është **vendosja e rregullave të përbashkëta** të klasës, ardhja dhe largimi në kohë, përgatitja e veshjes dhe e çantës që në darkë, si dhe përdorimi i shprehjeve përshëndetëse, jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë saj.

Pastërtia, higjiena dhe ardhja në mënyrë të rregullt në shkollë është një temë e rëndësishme që trajtohet që në javët e para të shkollës. Larja e duarve, e dhëmbëve, higjiena e trupit janë aktivitete praktike që fëmijët do t'i ushtrojnë që në muajin e parë. Gjithashtu, fëmijët mësohen të shkojnë drejt veprimeve të pavarura për kryerjen e nevojave të tyre vetjake, për t'u veshur, për të ndihmuar në shtëpi, për ta çuar një punë deri në fund, për të rritur kohën e përqendrimit, për të menaxhuar emocione në situata të ndryshme etj.

Duke iu referuar edhe standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit të kësaj moshe, fëmijëve do t'u duhet i gjithi viti për t'u përgatitur e për të qenë gati për në klasën e parë. Në trajtimin e temave, në vëmendje të mësuesi/jat duhet të jetë mospersonalizimi i rasteve, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë se dënohet sjellja dhe veprimet që ka kryer dhe jo vetë ata.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve për muajin shtator

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikusra për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthuren më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Njihet me mësuesen, shokët dhe shoqet e klasës.
- Bën pyetje rreth personazheve që do ta shoqërojnë gjatë librit.
- Përshëndet në mënyrën e duhur kur vjen dhe kur largohet nga shkolla.
- Mban mjetet e shkrimit në pozicionin e duhur dhe i përdor në vizatimin e elementeve të shkrimit.
- Emëron lodrat, pajisjet dhe mjetet e klasës. I përdor me kujdes ato.
- Mëson të ndajë gjërat me të tjerët.
- Dallon veshjet që përdor në shkollë nga veshjet e tjera që përdor Jashtë saj.

Edukata figurative

Fëmija:

- Realizon vizatimin e parë dhe tregon çfarë ka vizatuar.
- Vizaton rreth shkollës, shokut/shoqes dhe tregon si ndihet.

- Vizaton dhe ngjyros sendet dhe materialet që mban në çantën e shkollës.
- Vizaton dhe ngjyros sendet personale.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dëgjon këngën dhe tregon personazhet që përmenden në tekstin e këngëve.
- Dëgjon këngën për shkollën dhe e shoqëron me lëvizje ritmike të kokës.
- Këndon këngën duke sinkronizuar fjalën, muzikën, mimikën e fytyrës dhe lëvizjen e trupit.
- Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këndim e të përcjella me lëvizje trupore.

Matematika

Fëmija:

- Përdor fjalët krahasuese *më shumë/ më pak* për krahasimin e elementeve që kanë bashkësitë.
- Përshkruan vendndodhjen e shokut/shoqes referuar një objekti tjeter ose vetes: *majtas-djathtas; para-prapa*.
- Formon modele sipas veticës së objekteve (ngjyrë, formë, madhësi).
- Krahason dhe rendit objekte që gjen në mjedisin përreth sipas gjatësisë.
- Grupon sendet sipas cilësive të përbashkëta.
- Krahason peshën e sendeve duke përdorur njësi jo standard (mollë, top, libër, kub etj.).
- Rendit sipas radhës ditët e javës.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Vëzhgon dhe përshkruan çfarë shikon në mjedisin që e rrethon.
- Dallon materialet prej të cilave përbëhen lodrat dhe objektet e rrëthinës së vet dhe i grupon sipas tyre.
- Përshkruan materialet/ objektet sipas ngjyrës, formës dhe fortësisë.
- Dallon trupin më të rëndë nga trupi më i lehtë.
- Dallon ditën dhe natën dhe lidh kohën e ditës me aktivitetet vetanake.
- Tregon për përdorimin e materialeve (druri, letra, plastika, tekstili dhe metali) në jetën e përditshme.

Shoqëria dhe mjedisi

Fëmija:

- Përshkruan veten duke përdorur disa prej karakteristikave të tij bazë (p.sh.emri, mbiemri, gjinia, mosha, ngjyra e flokëve dhe e syve).
- Identifikon gjërat që mund t'i bëj vetë dhe ato për të cilat i nevojitet ndihmë ose shoqërim nga të tjérët.
- Dallon rregullat e caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe në lojë.
- Vendos rregulla të thjeshta për veprimtaritë e përditshme në bashkëpunim me të tjérët.

Edukata fizike

Fëmija:

- Merr pjesë në lojëra elementare dhe demonstron shkathësi gjatë zhvillimit të tyre.
- Shfaq emocione përmes lojës, dhe bashkëveprimit me mësuesin/en dhe fëmijët e tjerë.
- Praktikon i lirë ushtrime të thjeshta ritmike me dhe pa mjete.
- Aplikon teknikën e duhur të frymëmarries gjatë aktiviteteve fizike.
- Tregon vëmendje dhe përqendrim gjatë dëgjimit të komandave që i jepen.
- Tregon mënyrat e duhura për mirëmbajtjen e higjenës personale.
- Aplikon masat higienike *para*, *gjatë* dhe *pas* aktiviteteve fizike.
- Tregon si kujdeset për shëndetin dental dhe oral.

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët.
- Përshkruan aktivitet e ndryshme dhe të njëjta që bëhen në shtëpi dhe në shkollë.
- Identifikon veglat dhe mjetet e punës, i përdor ato për veprimtari të ndryshme.
- Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.

- Identifikon dhe përshkruan dhe klasifikon material riciklues, bazë nga ekonomia familjare duke i dalluar dhe renditur për përdorim të mëtejshëm.

Këto rezultate të nxëni përmbushen gjatë punës së përditshme përreth një muaj. Veprimtaritë dhe aktivitet që janë përzgjedhur për muajin shtator jepen në vijim. Gjatë muajit shtator, mësuesi/ja i njeh fëmijët, por edhe prindërit, me materialet që do të përdorin dhe me punën që bëhet në secilin prej tyre.

Projekti i muajit

Për muajin shtator, mësuesi/ja mund të kërkojë nga fëmijët, që në bashkëpunim me prindërit të krijojnë një libër me titull “Gjithçka rreth meje”. Projekti duhet të jetë i lidhur me gjithçka që është punuar në temat e planifikuara. Ky libër plotësohet gjatë gjithë muajit, fëmijët shtojnë të dhëna, punë e informacione kur e shohin të mundur dhe në ditët e fundit secili prezanton para shokëve librin e tij. Nëse ka fëmijë që nuk janë gati për të bërë prezantimin u lihet kohë për një ditë tjeter.

Në fund të muajit shtator, mësuesi/ja mund të zgjedhë nga Dosja një “Certifikatë vlerësimi” nëpërmjet të cilës vlerëson një sjellje, arritje apo veprim për të cilin fëmija të ndihet krenar/e.

Planifikimi i temave për muajin shtator “Shkolla po më pret”

	Java 1 Klasa, mësuesja dhe shokët e rinj	Java 2 Mjediset dhe njerëzit që takoj në shkollë	Java 3 Rregullat e shkollës dhe sjelljet e kulturuara	Java 4 Në shkollë vijmë të pastër dhe të rregullt
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> “Miqtë e mi të parë”; Letë prezantohemi: Unë jam... (Fq. 5 - 6); Tregoj për veten time; Vjersha “Këtu jam unë” (Fq. 7-9); Shoku im/ shoqja ime e re; Shkronjat që njoh (Fq. 10 - 11); Në shkollë luajmë dhe mësojmë. 	<ul style="list-style-type: none"> Shkolla jonë mban një emër; Në botën e personazheve” (Fq. 13); Vjersha “Unë tani u rrita” (Fq. 14); Përralla “Arushi që dinte të thoshte vetëm mirëmbërëma” (Fq. 16 - 17); Vija të drejta (Fq. 28 - 29). 	<ul style="list-style-type: none"> Tani që jemi në shkollë kemi një orar të ri ditor (Fq. 19); Vjersha “Flutura fjalëbukura”; Fjalët magjike (Fq. 20 - 21); Kujdesi për lodrat, pajisjet dhe mjetet e klasës; Përralla “Që lepurushi të mos dëmtohet” (Fq. 34 - 35); Vijat e thyera (Fq. 36). 	<ul style="list-style-type: none"> Në shkollë vijmë të pastër dhe të rregullt; Tregimi “Edhe ti Beni do të rritesh” (Fq. 42); “Gabimet e fëmijëve” (Fq. 43); Lojë në role “Rregullimi dhe sistemimi i rrobave, këpucëve, lodrave dhe librave”; Vijat e lakuara (Fq. 37).

Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> Vizatimi im i parë (Fq. 12) 	<ul style="list-style-type: none"> Mjetet e vizatimit: "Çanta ime" (Fq. 15) 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim me temë "Në shkollë me mësuesin/en dhe shokët" 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim & ngjyrosje "Sendet vetjake - Peshqiri, furça e dhëmbëve, shamia me inicialet e mia, larësja e trupit, krehëri etj. (Fq. 46)
Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Sikur një princeshë" https://www.youtube.com/watch?v=7a-Bs8A-3fk&feature=youtu.be 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Tring zilja, zilja tringëllon"https://www.youtube.com/watch?v=o3Td3hBLuCé 	<ul style="list-style-type: none"> Këngë pë fëmijë 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Mos, mos" https://www.youtube.com/watch?v=vpM_9r7aT-8
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Unë di të numëroj deri në... (Fq. 22); Numëroj shkronjat e emrit tim; Numëroj shokët e tavolinës ku jam ulur; Numërojmë vajzat dhe djemtë e klasës. 	<ul style="list-style-type: none"> Format gjeometrike që njoh (Fq. 23); Numërimi deri në 3; Koncepti "I gjatë-i shkurtër" (Fq. 26 - 27); Numërimi deri në 5 	<ul style="list-style-type: none"> Konceptet "Shumë/ pak" (Fq. 32 - 33); Konceptet "Para-mbrapa" (Fq. 40 - 41); Rendit sipas kohës: në mëngjes/ në mbrëmje; Konceptet "Më shumë/ më pak/ aq sa". 	<ul style="list-style-type: none"> Vendodhja e një objekti duke iu referuar një objekti tjeter; Grupimi sipas një cilësie; Gjejkush nuk i përket grupit; Ditt e javës; Peshimi i sendeve me njësi jo standarde.

<p>Dituri natyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> Në klasë <i>pashë</i> dhe më bëri përshtypje; <i>dëgjova</i> dhe njoha nga zëri...; objekti, lodra që <i>preka</i> në fillim 	<ul style="list-style-type: none"> Dita dhe nata (<i>Fq. 18</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Lodrat dhe llojet e tyre (<i>Fq. 30 - 31</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Çfarë kemi në shtëpi me këto materiale?
<p>Shoqëria dhe mjedisi</p>	<ul style="list-style-type: none"> Unë jam... Fjalët përshëndetëse: Mirëmëngjesi!, Mirëdital!, Mirupafshim!, Mirëmbrëma!, Natën e mirë! (<i>Fq. 18</i>); 	<ul style="list-style-type: none"> Gjërat që mund t'i bëj pa ndihmë 	<ul style="list-style-type: none"> Unë dhe shokët e mi; Rregullat që duhet t'i dijë çdo fëmijë 	<ul style="list-style-type: none"> Normat dhe rregullat në jetën e përbashkët (<i>Fq. 44 - 45</i>)
<p>Edukata fizike</p>	<ul style="list-style-type: none"> Ushtrime ritmike nën ritmin e muzikës Loja “Nata dhe dita” 	<ul style="list-style-type: none"> Loja “Vigani-shkurtabiqi” Luajmë nën ritmin e muzikës “Roza-rozina” Kënga Lyra Fest 2015 - Aulona Tërshana https://www.youtube.com/watch?v=Mgbrg-Yrg7U&feature=youtu.be 	<ul style="list-style-type: none"> Higjiena personale. Si lahen duart?; Vjersha “Eko-armata” (<i>Fq. 24 - 25</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Si lahen dhëmbët?; Vjersha “Porsa ngrihem në mëngjes” (<i>Fq. 38 - 39</i>)

Shkathësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Pema e klasës sonë 	<ul style="list-style-type: none"> Veprimet që kryejmë në shtëpi dhe në shkollë 	<ul style="list-style-type: none"> Kutia e mbajtjes së mjeteve shkollore 	<ul style="list-style-type: none"> Goja me dhëmbët e mi
Anglist	<ul style="list-style-type: none"> Hello! Greetings & Introduction – Basic greetings; Greeting songs 	<ul style="list-style-type: none"> Dialogue – Hello! Hi! Goodbye! Who are you? What's your name? 	<ul style="list-style-type: none"> Names and classroom objects. What is this? This is a... 	<ul style="list-style-type: none"> Names classroom objects and point to them as instructed
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Unë di të bëj... Dosja ime 	<ul style="list-style-type: none"> Shenjat e mia personale në dollapin e klasës. 	<ul style="list-style-type: none"> “Tregojmë ç’dimë të bëjmë” - Punimi i parë i fëmijëve në grup 	<ul style="list-style-type: none"> Poster me rregullat që nuk duhet të harrohen nga fëmijët në shtëpi dhe në shkollë

Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin shtator

- **Biseda** “*Unë jam...*”, ku mësuesi/ja dhe fëmijët prezantohen me njëri-tjetrin. Ky proces fillon që në ditët e para të shtatorit dhe zgjat deri në fundin e tij, duke patur parasysh që jo të gjithë fëmijët janë gati në të njëjtën kohë për t'i bërë apo për t'i thënë gjërat. Në librin e punës, muaji shtator nis me paraqitjen e një mjedisit klase me personazhet e librit. Pamjen e kësaj klase fëmijët mund ta krahasojnë me klasën e tyre, duke nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet dy mjediseve. Gjithashtu, personazhi i librit është me kokën pak të ulur, sepse ai përfaqëson ata fëmijë që janë të ndrojtur dhe duan pak më tepër kohë për t'u përshtatur me mjedisin e ri. Në dosje janë dhënë fletët me tituj “*Një foto në mes të personazheve të librit*”, “*Duam të të njohim kush je ti*”, “*Dua të tregoj diçka*”, “*Punimi im i parë*”, të cilat përdoren kur e sheh të arsyeshme mësuesi/ja.
- Gjatë javës së parë, mësuesi/ja prezanton personazhet e librit dhe vjershën “*Miqtë e mi të parë*” që lidhet me ta. **Kënga** “*Sikur një princeshë*” i fut fëmijët në botën e dashur të personazheve. Kënga mund të dëgjohet disa herë gjatë javës në mënyrë që fëmijët të dallojnë personazhet që përmenden në të dhe t'i vizatojnë në fletën e punës. Në një fletë të bardhë, fëmijët mund të vizatojnë ose të ngjisin personazhin që u pëlqen më shumë.
- Në javët e para, për mësuesin/en është e rëndësishme të kuptojë dhe të marrë informacion për atë që fëmijët dinë dhe mund të bëjnë. Për këtë arsy, në librin e fëmijës janë dhënë disa fletë pune, si: “*Shkronjat që njoh*”, “*Numrat që njoh*”, “*Format që njoh*”. Fëmijët mund të qarkojnë shkronjat që njohin, mund të ngjyrosin shkronjat e emrit të tyre, mund të qarkojnë shkronjat e para të emrit të mësuesi/jat/es, të ndonjë shoku ose të personazheve të njohur për fëmijë. Të njëjtin qëllim kanë edhe fletët e punës të matematikës për numrat dhe format. Ata ngjyrosin numrat dhe format që njohin, numërojnë duke i treguar me gisht numrat etj.

- **Vjersha** “*Këtu jam unë*”, pas leximit të së cilës, mësuesi/ja mund të organizojë me fëmijët një bisedë në lidhje me fëmijën për të cilin bëhet fjalë në vjershë: a është djalë apo vajzë. Pas kësaj bisede çdo fëmijë vizaton veten hap pas hapi. Pas realizimit të vizatimit, fëmijët kuptojnë se si djali dhe vajza kanë ngashmëri me njëri-tjetrin.
- **Biseda** për shkollën, emrin e kujt mban dhe pak nga historiku i saj. Fëmijët mund të dëgjojnë këngën “*Tring zilja*” dhe ta shoqërojnë këndimin e saj me lëvizje trupore. Fëmijët mund të bëjnë një poster me temë “*Klasa jonë*”, ku të jenë fotografitë e të gjithë fëmijëve dhe mësuesi/jat/es ose një punim me stampime duarsh dhe emrin e ri të klasës.
- **Lojëra në oborr** që fëmijët të mësojnë emrat e njëri-tjetrit. Mësuesi/ja mund të planifikojë edhe veprimitari, në të cilat fëmijët duke dëgjuar karakteristikat që përmenden dallon shokun apo shoqen për të cilën bëhet fjalë. Mësuesi/ja mund të pëргatisë etiketa të shkruara me shkronja kapitale. Secili fëmijë vizaton nga n jë simbol pranë emrit të vet. Çdo ditë mësuesi/ja gjen kohën për t'i treguar etiketat në mënyrë që fëmijët të dallojnë emrin e tyre, por edhe të ndonjë fëmije tjeter. Gjithashtu loja me etiketa mund të përdoret edhe për grupimin e fëmijëve për të kryer aktivitete në grup.
- **Biseda** në lidhje me veprimtaritë dhe aktivitetet që fëmijët do të bëjnë gjatë vitit shkollor, duke përcjellë mesazhin që fëmijët do të luajnë, por edhe do të mësojnë plot gjëra të reja.
- **Biseda** për orarin e ri ditor, kujdesin që fëmijët duhet të tregojnë për të ardhur në kohë në shkollë.
- **Biseda** për çantën dhe mjetet që duhet të marrin me vete. Në dosje është fleta “*Skedat e poimit*” të cilat priten dhe fëmijët mësojnë kur dhe si t'i përdorin.. Si pjesë e kësaj teme mund të përdoret edhe vjersha apo loja muzikore “*Porsa ngrihem në mëngjes*” që lidhet me veprimet që kryhen në mëngjes, pas zgjimit nga gjumi.
- **Biseda** për lodrat të cilat fëmijët mund t'i marrin në ditët e para, me llojet e materialeve që kanë dhe kujdesin që duhet të tregojnë për lodrat. Për këtë temë, mësuesi/ja mund të përdorë përrallën “*Që lepurushi të mos dëmtohet*”.

Gjithashtu, mësuesi/ja mund të kërkojë nga fëmijët për objekte dhe sende prej druri, letre, plastike, tekstili dhe metali që përdoren në jetën e përditshme.

- **Krëfimi i përrallave.** Përrallat janë shumë të dashura për fëmijët. Ata i mësojnë nëpërmjet prindërve, gjyshérve, librave dhe filmave që shohin në televizor. Përralla se t'u prezantohet përralla e parë, mësuesi/ja zhvillon një bisedë me fëmijët në lidhje me përrallat që ata dinë apo për përrallen që pëlqejnë më shumë. Në fillim fëmijët mund të dëgjojnë këngën “Sikur një princeshë” ose “*Kokëkashta*” dhe më tej të flasin për përrallat dhe personazhet e dashur. Mësuesi/ja u tregon se përrallat fillojnë “Na ishte një herë...” ose “Shumë e shumë kohë më parë...” ose Një herë e një kohë...” etj. më tej është momenti që mësuesi/ja t'i njohë fëmijët me përrallat që do të mësohen gjatë vitit. Vlen të përmendim faktin që, në përgjithësi, të gjitha vjershat, përrallat dhe tregimet që janë zgjedhur, janë didaktike. Nëpërmjet tyre fëmijët do të mësojnë diçka të re, do të kuptojnë e të dallojnë gabimet, do të tregojnë ngjarje apo histori të ngjashme, do të lidhen me një temë apo koncept nga lëndët e tjera. Pra janë përzgjedhur qëllimshëm dhe të lidhura me ngjarje e veprime ngajeta e përditshme. Përrallat mbizotërojnë në numër, sepse te fëmijët vjen natyrshëm dhe më lehtë diskutimi dhe në librin e fëmijëve vjen në disa forma. Përtej përrallave të sugjeruara në planin për realizimin e programeve mësimore, mësuesi/ja ka fleksibilitet të realizojë veprimitari të reja. Marrim shkas këtu për të theksuar se libri nuk është i vetmi mjet nëpërmjet të cilit fëmija do të mësojë në arsimin parashkollor në përgjithësi dhe në klasën përgatitore në veçanti. Veprimitaritë konkrete, lojërat, situatat ngajeta reale duhet të mbizotërojnë gjatë punës së përditshme. Nisur nga këto fakte në librin e fëmijës janë dhënë fotografi të veprimeve që kryejnë fëmijët si larja e duarve, e dhëmëve etj.
- Te përralla “Arushi që dinte të thoshte vetëm Mirëmbërëma” fëmijët shikojnë ilustrimet e përrallës dhe në bazë të tyre ritregojnë përrallen me fjalët e veta. Për secilën përrallë apo tregim që është dhënë në libër, mësuesi/ja ndjek të njëjtën procedura: në fillim i vë fëmijët të shikojnë figurat dhe të përshkruajnë çfarë tregojnë ato. Më tej u tregon

përrallën dhe pas përfundimit të saj u drejton pyetje për përmbajtjen e saj. Për çdo përrallë analizohen veprimet e personazheve, jepen mendime për to, këshilla nëse është e nevojshme dhe nxirren mësime të vlefshme për fëmijët. Tregimi i përrallës me fjalët e veta është një proces që zgjat në kohë, por tri etapat nëpër të cilat kalon janë fillimi, zhvillimi dhe përfundimi i saj. Ritregimi i përrallës bëhet nëpërmjet figurave, të cilat nga mësuesi/ja kërkohet edhe t'i rendisin sipas radhës. Siç duket edhe nga libri i punës së fëmijës, trajtimi i përrallave ndryshon hera-herës. Kjo bëhet me qëllim që fëmijëve t'u ofrohen modele të ndryshme dhe ata të mund të bëjnë parashikime, interpretime dhe gjetje të reja të përfundimeve të përrallave.

- **Loja në role** për përdorimin e fjalëve përshëndetëse: Mirëmengjes!, Mirëdita!, Mirupafshim!, Mirëmbrëma! Natën e mirë! dhe të fjalëve magjike Urdhëro!, Të lutem! Më fal! Fëmijët shpesh i harrojnë t'i përdorin këto fjalë dhe mësuesi/ja mund ta provojë me pyetjet që janë dhënë në librin e fëmijës te vjersha "Flutura fjalëbukura". Biseda që zhvillon mësuesi/ja për përdorimin e fjalëve përshëndetëse lidhet edhe me veprimet që kryhen gjatë ditës dhe në mbrëmje. Kjo veprimitari koordinohet edhe me lojën lëvizore "Dita dhe nata", e cila zhvillohet në oborrin e shkollës.
- **Biseda** për rregullat dhe vendosjen e tyre. Kur të flitet për rregullat dhe të përcaktohen se cilat rregulla do të zbatojnë fëmijët në klasë, duhet që të gjithë t'i pranojnë dhe të përpilen për t'i zbatuar. Në portofol janë vendosur disa etiketa të cilat mund të përdoren në veprimitari të ndryshme, kur mësuesi/ja kërkon të marrë mendimin e fëmijëve nëse u pëlqen apo jo diçka, nëse pajtohen ose jo me atë që thuhet ose tregohet, nëse duan të bëjnë diçka apo jo. Edhe pse i vogël, fëmija duhet nxitur të shfaqë mendimin dhe të japë edhe arsyë rreth përgjigjes që jep, për të kuptuar më mirë atë çfarë mendon apo dëshiron. Me materiale të riciklueshme mund të krijohet edhe kutia e mbajtjes së sendeve shkollore në çdo tavolinë pune.

- **Biseda** për kryerjen e veprimeve nga fëmijët në mënyrë të pavarur. Vjersha “Unë tani u rrita” lidhet me këtë temë. Fëmijët dëgjojnë njëri-tjetrin, tregojnë për veten dhe krahasojnë veprime që munden t'i bëjnë vetë.
- **Vjersha** “Eko-armata” është në funksion të kujdesit për higienën personale dhe më tej shoqërohet me veprimitari praktike për larjen e duarve dhe të dhëmbëve. Kënga “O maçok, çamarrok” i shërben po këtij qëllimi dhe fëmijët e shoqërojnë këngën me lëvizje trupore. Me ndihmën e prindit, fëmijët në një fletë mund të vizatojnë një gojë të thjeshtë që simbolizon dhëmbët lart dhe poshtë. Çdo fëmijë numëron sa dhëmbë ka në gojë dhe i plotëson me kokrra gruri, misri, makarona të vogla, kopsa ose mjete të tjera rrethanore.
- Fëmijët e moshës parashkollore duan t'u ngajnjë prindërve dhre të kryejnë veprime si të rritur. Shpeshherë këto janë veprime që ata i kryejnë fshehurazi dhe i tregojnë kur ndodhen në pozitë të vështirë. Tregimi “Edhe ti Beni do të rritesht” tregon disa nga veprimet që fëmijët bëjnë në shtëpi. Nëpërmjet tyre, mësuesi/ja analizon sjelljet dhe fëmijët vetë tregojnë nëse ato janë sjelljet e duhura apo jo. Gjithashtu nëpërmjet vizatimit të sendeve personale fëmijët mësojnë se disa sende u përkasin atyre dhe nuk mund të përdoren nga pjesëtarët e tjerë të familjes.
- Nëpërmjet lojës “Gjigandi dhe shkurtabiqi” fëmijët mësojnë të tregohen të vëmendshëm dhe të veprojnë pasi të dëgjojnë fjalët. Kjo lojë mund të shërbejë edhe për konceptin matematikor “I gjatë-i shkurtër” ku fëmijët dallojnë dhe renditen nga më i gjati te më i shkurtri. Pastaj ata mund të plotësojnë fletën e punës të dhënë në libër. E njëjtë procedurë mund të ndiqet edhe për konceptin shumë-pak, më shumë-më pak dhe për çdo koncept tjetër. Konceptet matematike trajtohen me lojëra dhe veprimitari praktike me mjetet dhe lodrat që ka në klasë apo që fëmijët kanë në çantë. Përmendim këtu peshimin dhe krahasimin e peshave të objekteve, grupimin, klasifikimin apo veçimin e lodrave sipas madhësisë, ngjyrës, formës, materialit përbërës etj. Nëpërmjet këtyre veprimitarive praktike fëmijët i mësojnë konceptet nëpërmjet lojës dhe ata dinë se po luajnë, kur në fakt qëllimi i mësuesi/jat është mësimi i koncepteve.

- Veprimtari e rëndësishme gjatë muajit shtator është ushtrimi i fëmijëve për të punuar me **elemente shkrimi**, përpara se të fillojnë mësimin e shkronjave. Ky proces nis me vizatimin e vijave të drejtë, e më pas me vijat e thyera dhe të lakuara. Ushtrimi i fëmijëve për të shkruar mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshmet. Mundet që fëmijët të ushtrohen duke vizatuar me gisht në ajër ose në pëllëmbën e dorës, mund të shkruajnë me shkumës në tabelë ose në oborr, mund të shkruajnë me flamstra në një fletë të madhe, mund të shkruajnë në fletë të përdorura nga njëra anë, mund t'i krijojnë me mjete rrëthanore e me plot mënyra të tjera që mësuesi/ja i gjen edhe në internet. E njëjtë procedurë ndiqet edhe për shkrimin e shkronjave.

MIRË SE ERDHE,
VJESHTË E ARTË!



Specifika të punës në muajin tetor

Njohja me karakteristikat e stinës së vjeshtës, me motin, frutat dhe veshjet e stinës

Në muajin tetor është zgjedhur të zhvillohet tema e vjeshtës. Kjo për arsyen se moti ka ndryshuar dhe karakteristikat e saj fillojnë të duken ndjeshëm nga njëra javë në tjetrën. Kjo temë është e lidhur më tepër me fushën e zhvillimit shkencor, të krijuar tarisë dhe të matematikës. Tema lidhet me karakteristikat e moshës së fëmijës dhe me kuriozitetin që kanë ata për të njohur mjedisin që i rrethon.

Temat javore për muajin tetor janë parashikuar të jenë:

- Vjeshta po troket. Karakteristikat e saj;
- Përralla "Iriqi dhe mollët". Frutat e stinës;
- Gjethet ndryshojnë ngjyrë, dallëndyshet po largohen;
- Veshjet e stinës.

Për çdo ditë fëmijët vijnë në shkollë dhe ndiejnë **ndryshimin e motit** në mëngjes, në drekë dhe në darkë, **veshjet** e tyre ndryshojnë nga njëra ditë në tjetrën, mbizotërojnë mëngët dhe pantallonat e gjata dhe ndonjë jelek a xhup i hollë përsipër. Shikojnë se gjethet kanë rënë dhe ato janë me ngjyra të ndryshme. Pra në javën e parë do të mbizotërojnë shëtitjet në natyrë, vëzhgimi nga afër i motit dhe përshkrimi i dukurive të vëzhguara.

Në javën e dytë fëmijët do të njihen me **frutat e stinës**. Në fakt, në ditët e sotme është pak e vështirë dallimi i frutave që piqen në çdo stinë, pasi ato gjenden në shitore gjithmonë. Megjithatë është nje temë që duhet diskutuar me fëmijët në

mënyrë që ata të njohin frutat dhe perimet e stinës dhe të konsumojnë më tepër ato që piqen gjatë sezonit. Gjatë kësaj jave diskutohen si frutat e pemëve edhe **frutat e pyllit** si arra, lajthia, bajamja dhe gështena.

Në javën e tretë të tetorit **gjethet** kanë rënë, janë ngjyra-ngjyra. Fëmijët nëpërmjet ngjyrave dhe formave mund të kuptojnë konceptet e matematikës dhe të punojnë në art për projektin e muajit. Gjithashtu ata vënë re se **dallëndyshet** rrallohen dhe foletë e tyre mbeten bosh. Ashtu si fëmijët fillojnë e vishen me mëngë të gjata, po ashtu edhe **shpendët** largohen për në vendet e ngrohta.

Në javën e katërt do të trajtohen **veshjet** karakteristike të stinës së vjeshtës. Në vëmendjen e mësuesi/jat/es do të jetë edhe përshtaja e veshjeve sipas motit, në mënyrë që fëmijët të veshin veshjet e duhura në mot me diell, në mot me shi, në mot me erë etj.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Pasuron fjalorin me fjalë të reja dhe i përdor në fjali të shkruutra.
- Reciton vjershat duke e shoqëruar recitimin me lëvizje trupore.
- Tregon përrallën duke ndjekur radhën e ngjarjeve.
- Analizon veprimet e personazheve dhe nxjerr mësime nga përralla.
- Gjen dhe tregon veprimitari që mund t'i realizojë në bashkëpunim me fëmijët e tjera.
- Përshkruan frutat e stinës nga ngjyra, forma, madhësia dhe shija.
- Jep këshilla të thjeshta të përshtatshme për moshën.

- Tregon raste të ngjashme ngajeta e përditshme që lidhen me historitë që dëgjon.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat A, B, C, Ç.

Edukata figurative

Fëmija:

- Vizaton peisazhin e pyllit në vjeshtë ashtu siç e shikon në natyrë.
- Përdor ngjyrat bazë në punimet që realizon.
- Realizon punime me stampim me gjethet e stinës.
- Realizon sipas fantazisë një ditë shiu.
- Modelon veshje të stinës me plastelinë.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dallon vetitë themelore të tingullit përmes dëgjimit muzikor.
- Këndon këngën duke imituar lëvizjen e gjetheve.
- Dëgjon këngën dhe dallon nëse ajo ka ritëm të shpejtë apo të ngadalshëm dhe e shoqëron me trokitje me laps ose me gishta.
- Dëgjon këngën dhe e shoqëron me trokitje me këmbë.

Matematika

Fëmija:

- Kopjon, vizaton, modelon numrin 1 dhe 2.
- Dallon grupin që ka 1 dhe 2 objekte.
- Kryen mbledhje dhe zbritje deri në 2.
- Emërton format gjeometrike, i vizaton me dorë të lirë dhe gjen në mjedis objekte të ngjashme me rrethin dhe katorin.
- Pret figurat gjeometrike dhe dallon vijën e simetrisë duke i palosur më dysh.
- Dallon pjesën nga e tëra.
- Rendit nga më i madhi te më i vogli dhe anasjelltas.
- Radhit objekte sipas ngjyrës, formës dhe madhësisë.
- Zbulon rregullin. Formon modele sipas veticë të objekteve.
- Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet më shumë, më pak, aq sa
- Lexon të dhënat në një tabelë.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Tregon karakteristikat themelore të stinës së vjeshtës.
- Emërton simbolet e motit dhe i përshkruan me fjalë.

- Përshkruan ndryshimet e motit që vëren gjatë stinës së vjeshtës.
- Dallon shqisat te kafshët.
- Dallon ndryshimet që pësojnë gjethet në stinën e vjeshtës.
- Dallon ndryshimet që pëson trupi i njeriut gjatë rritjes.

Shoqëria dhe mqedisi

Fëmija:

- Zbaton rregullat për veprimitari të caktuara në situata të ndryshme jetësore në familje, lagje, kopsht/shkollë etj.
- Identifikon shokët të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe tregon gatishmëri për t'i ndihmuar ata.
- Tregon për emocionet që përjeton kur takohet me njerëzit që jetojnë larg.

Edukata fizike

Fëmija:

- Demontron shkathësi të lëvizjeve elementare gjatë kapjes dhe hedhjes së topit me dy duar.
- Demontron mënyra të ndryshme të ecjes, vrapimit, kërcimit, hedhjes etj.
- Shfaq emocione pozitive gjatë zhvillimit të imitimeve.
- Shpreh kreativitet me lëvizje.
- Shfaq emocione përmes lojës në grup dhe bashkëveprimit me fëmijët e tjera.
- Përshtat dhe përzgjedh veshjet sipas stinëve dhe aktivitetave fizike.

- Dallon qëndrimin e drejtë dhe jo të drejt të trupit.

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Krijon punime te ndryshme duke përdorur materiale ricikluese natyrale.
- Realizon n jë punim dhe gjen ngjashmëritë dhe dallimet me punimet e fëmijëve të tjerë.
- Simulon shitjen e gjësendeve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe blerësit.
- Dallon materialet sipas llojit (p.sh pambuk, dru, lëkurë, tekstil) i përdor ato për krijimet e veta.

Projekti i muajit

Për muajin tetor, fëmijët mund të realizojnë projektin “Vjeshta e artë”. Në formatin A3 që ndodhet në dosjen e fëmijës mundet që të realizohet projekti, ku fëmijët përqendrohen:

- Në karakteristikat e stinës së vjeshtës;
- Në motin dhe ndryshimet e tij;
- Në gjethet dhe në veprimtaritë që mund të bëjnë me to: me vizatim, modelim, stampim, kolazh etj.;
- Në veshjet e stinës dhe në kombinime ngjyrash, dizajni etj.;
- Në integrimin ndërlëndor të koncepteve që trajtohen gjatë muajit tetor.

Në çdo javë të muajit dhe për gjithçka që mësojnë, fëmijët përpiken t'i shprehin në projektin e tyre. Në fund të muajit projektet e fëmijëve ngjiten në mur dhe secili qëndron pranë punimit dhe e prezanton te të tjerët. Në këtë aktivitet është mirë të jenë edhe prindërit për t'i motivuar dhe mbështetur fëmijët për punën që do të bëjnë dhe për atë çfarë kanë arritur.

Në fund të muajit çdo fëmijë mund të marrë një certifikatë vlerësimi e cila dëshmon përpjekjet, arritjen dhe punën që ka bërë secili në realizimin e projektit, në ideimin, paraqitjen e tij etj.

Planifikimi i temave për muajin tetor “Mirë se erdhe vjeshtë e artë!”

	Java 1 Vjeshta po troket. Karakteristikat e saj	Java 2 Përralla “Iriqi dhe mollët” Frutat e stinës	Java 3 Gjethet ndryshojnë, dallëndyshet shtegtojnë	Java 4 Veshjet e stinës
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> Vjersha “Vjeshtë e artë” (Fq. 49) Natyra dhe moti në vjeshtë; Tregimi “Vjeshta e artë” (Fq. 54) Dëshirat e fëmijëve përblerje (Fq. 55). Gjëgjëzat Shkronja A (Fq. 56 - 57) 	<ul style="list-style-type: none"> Përralla “Iriqi dhe mollët” (Fq. 58 - 59) Fillimi, vazhdimi dhe mbyllja e një përralle; Nga përrallat nxjerrim mësime/ marrim mesazhe; Vjersha “Molla” (Fq. 62) Frutat e stinës (Fq. 63) Shkronja B (Fq. 68 - 69) 	<ul style="list-style-type: none"> Pse themi që vjeshta është pikture? Në vjeshtë më pëlqen.../ nuk më pëlqen... Tregimi “Gjethja që donte të rrinte vetëm në pemë” (Fq. 70 - 71); Në pyll cicërimat e zogjve janë rralluar; Zogjtë shtegtarë largohen në vendet e ngrohta. Vjersha “Sikur ta dija...” (Fq. 74) Shkronja C (Fq. 78 - 79) 	<ul style="list-style-type: none"> A jemi veshur si duhet sot?; Veshjet e stinës Tregimi “Vishemi sipas stinës” (Fq. 80); Dëgjojmë prindërit dhe veprojmë siç na thonë (Fq. 81); Vjersha humoristike “Shiu dhe sandalet” (Fq. 84); Veshje për raste të caktuara, festa dhe ngjarje të shënuara; Shkronja Ç (Fq. 86 - 87)
Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> Mjetet e pikturës: “Pylli në vjeshtë”. Simbolet e motit (Fq. 50 - 51). 	<ul style="list-style-type: none"> Ngjyrat bazë: E kuqe, e verdhë, blu. 	<ul style="list-style-type: none"> Stampim me gjethet e vjeshtës; Herbarium me gjethet e stinës. 	<ul style="list-style-type: none"> Modelim me plastelinë “Çadra ime e shiut”; Vizatim dhe ngjyrosje “Një ditë shiu” (Fq. 85).

Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Macja le të lahet" https://www.youtube.com/watch?v=wiTG7Mg2sz0 	<ul style="list-style-type: none"> Ritmi, melodia dhe harmonia në këngët që dëgjoj Kënga "Ritmi" – Oqeana dhe Perla Batalli - LYRA FEST 2017, Gjakovë https://www.youtube.com/watch?v=H9ekifWnKQ&feature=youtu.be 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Gjethet e pemës" https://www.youtube.com/watch?v=l0Yv7vAY7cE 	<ul style="list-style-type: none"> Lëvizje ritmike nën tingujt e muzikës. Tingujt e kafshëve. Le t'i përkruajmë.
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Kuptimi për numrin 1 (<i>Fq. 52 - 53</i>); Simetria në figura: gjethja, arra, pema; Plotësojmë tabelën me të dhëna për gjethet Paraja dhe përdorimi i saj (<i>Fq. 55</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Koncepti "I madh - i vogël" (<i>Fq. 60 - 61</i>); Modelimi i vargut me mollë; Gjysma dhe e tëra (<i>Fq. 64</i>) Rrethi (<i>Fq. 66 - 67</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Kuptimi për numrin 2 (<i>Fq. 76 - 77</i>) Grupimi i gjetheve sipas ngjyrës, madhësisë, formës. Mbledhje dhe zbritje deri në 2 Zbulo rregullin, vazhdo modelin 	<ul style="list-style-type: none"> Katrori (<i>Fq. 82 - 83</i>); Konceptet më shumë/ më pak; Konceptet mbi/ nën; Pjesa dhe e tëra te veshjet: Kujt i përket kjo...?
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat e stinës së vjeshtës 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesët e trupit te kafshët e lëndinës: iriqi, breshka, lepuri, ketri; Nga frut në lëng -dalloj shijet: e ëmbël, e thartë 	<ul style="list-style-type: none"> Pse gjethet ndryshojnë ngjyrë në vjeshtë? 	<ul style="list-style-type: none"> Eksperiment: Shiu dhe Era në kushtet e klasës

Shoqëria dhe njedisi	<ul style="list-style-type: none"> Sjellja e drejtë/ e gabuar 	<ul style="list-style-type: none"> Gatishmëria për të ndihumar shokët (<i>Fq. 59</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Malli që ndiejmë për njerëzit që kemi larg 	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmë për njerëzit në nevojë
Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Siguria në shtëpi; Hedhje dhe pritje topi me dy duar 	<ul style="list-style-type: none"> Kërcime pupthi me dy këmbë. Imitime të lëvizjes së kafshëve:-kërcim si lepur; zvarritje si breshkë; hedhje si ketër; ecje si iriq. 	<ul style="list-style-type: none"> Përkulim trupin si gjethe para-mbrapa; majtas-djathtas; Loja "Fshesa dhe gjethet" 	<ul style="list-style-type: none"> Vishemi sipas stinës; Qëndrimet bazë të trupit
Shkathëtësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Kolazh me materiale të ndryshme të mbledhura në natyrë 	<ul style="list-style-type: none"> Modelim frutash "Shporta me fruta" 	<ul style="list-style-type: none"> Zogjtë do të kthehen sërisht në pranverë. Foleza e tyre i pret (me materiale të riciklueshme) 	<ul style="list-style-type: none"> Llojet e materialeve që përdoren për veshjet: pambuk dhe lesh
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> Number 1 My new friend 	<ul style="list-style-type: none"> Primary colours, Names the colours of the given objects 	<ul style="list-style-type: none"> Number 2 	<ul style="list-style-type: none"> Listen and sings chants and rhymes introducing classroom objects.
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Shëtitje në natyrë 	<ul style="list-style-type: none"> Si bëhet një projekt? 	<ul style="list-style-type: none"> Maska për dramatizimin e përrallës; Lista e gjëra që na duhen. 	<ul style="list-style-type: none"> Veshjet e duhura për personazhet e librit

Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin tetor

- **Shëtitje në natyrë.** Shëtitjet në natyrë janë një veprimtari shumë e rëndësishme dhe duhet aplikuar sa herë të jetë e mundur në temat mësimore. Këto shëtitje zhvillohen në temat që kanë lidhje me stinën dhe vëzhgimin e ndryshimeve që ndodhin në natyrë, zhvillohen kur ka tema për mjedisin, kur tema lidhen me lagjen, fshatin dhe qytetin, kur flitet për mjetet që lëvizin në rrugë etj. Shëtitjet që zhvillohen në grup kanë tjetër vlerë për fëmijët, sepse ata orientohen nga mësuesi/ja për atë çfarë do të vëzhojnë, për sendet që do të mbledhin dhe për pyetjet që mund të bëjnë. Edhe në librin e punës, titori nis me një pejsazh vjeshte. Mësuesi/ja kërkon nga fëmijët të përshkruajnë atë çfarë shohin dhe ta krahasojnë me natyrën që panë gjatë shëtitjes. Në mënyrë që fëmijët ta kenë të lehtë të përshkruajnë stinën, mësuesi/ja mund të kërkojnë që ata ta nisin përshkrimin duke thënë “Në vjeshtë...” e të vazhdojnë të rendisin me radhë karakteristikat e stinëve. Mundet që gjatë njërsës prej ditëve, fëmijët të marrin fleta, ngjyra dhe të vizatojnë në natyrë atë çfarë shohin e, kur të kthehen në klasë, t'i ngjisnin nëpër mure dhe të shpjegojnë vizatimet që kanë bërë.
- Për një gjë mësuesi/ja duhet të jetë i/e qartë: **të gjitha veprimtaritë që i janë sugjeruar në plan, i ndan vetë dhe i organizon gjatë ditës.** E rëndësishme është që çdo ditë të ketë në mendjen e mësuesi/jat/es një “**temë ditore**” dhe rrëth saj të **zhvillohen të integruara të gjitha veprimtaritë**. Temat që kemi sugjeruar e pranojnë fleksibilitetin dhe mund të rigrupohen ashtu siç e mendon të arsyeshme mësuesi/ja. P.sh: karakteristikat e stinës nuk janë të ndara nga ngjyrat e gjetheve apo nga frutat e stinës apo nga veshjet. Ndarja në javë dhe nxjerra e tyre si tema javore do të thotë që gjatë një jave do të punohet më shumë e më gjerë për temën e paracaktuar. Fëmijët janë të vegjël dhe e kanë të nevojshme përsëritjen e gjérave dhe kërkojnë kohë për t'i kuptuar temat dhe konceptet. Edhe këngë “**Macja le të**

lahet" lidhet me karakteristikat e stinës dhe fëmijët kuptojnë se kur bie shi. Gjatë shëtitjes në natyrë, fëmijët dëgjojnë **tingujt dhe zhurmat** dhe tregojnë se cilët prej tyre pëlqejnë dhe cilët jo.

- **Vjershat.** Gjatë muajit tetor janë parashikuar rreth tre vjersha: "Sa gëzim, sa bukuri!", "Molla", "Sikur ta dija...". Secila nga këto vjersha është e thjeshtë për t'u kuptuar nga fëmijët dhe për t'u recitar nga ana e tyre. Vjershat recitoohen në kor dhe shoqërohen edhe me lëvizje trupi. Gjatë recitimit fëmijëve u kërkohet të mos nxitojnë dhe t'i shqiptojnë drejt fjalët.

Vjershën "Molla" fëmijët mund ta interpretojnë në role 3 e nga 3, duke përfaqësuar tri ngjyrat e saj. Fëmijët mund të bëjnë maska dhe ta ngjyrosin me ngjyrën që u pëlqen, mund të numërojnë nga 1 deri në 3, mund ta lidhin me formën rrethore, me konceptet shumë/pak etj. Me mollët fëmijët mund të bëjnë renditje nga më të ndryshmet, sipas ngjyrës dhe madhësisë. Gjithashtu molla mund të përdoret si njësi jo standarde për peshimin e frutave dhe krahasimin e peshave ndërmjet tyre, duke përdorur shprehjet më i rëndë se.../ më i lehtë se....

Vjersha "Sikur ta dija..." ka lidhje me gjuhën e kafshëve. Kjo është një vjershë për t'u kujtar fëmijëve se një pjesë e shpendëve shtegtojnë dhe largohen për në vendet e ngrohta dhe rikthehen sërisht në pranverë. Mësuesi/ja mund të diskutojë me fëmijët edhe për njerëzit që ata kanë jashtë shtetit, për kushërinjtë e të afërm të tjerë dhe t'i nxise të flasin për mallin që ndiejnë për ta. Gjithashtu, vjersha lidhet me edukatën muzikore, me tingujt e zërave të kafshëve. Nëpërmjet tyre fëmijët njihen me vetitë e tingullit: gjatësinë, lartësinë, ngjyrën dhe forcën e tij.

- **Punët praktike.** Në librin e punës jepen faqe të veçanta që fëmijët të punojnë duke ngjitur simbole ose duke i vizuatuar ato. Zgjedhja është e lirë në dorë të fëmijës. E tillë është fleta "**Kalendari i motit**". Për një muaj rresht fëmija do ta plotësojë motin e çdo dite. Pas përfundimit të muajit, fëmijët mund të dallojnë se cili është moti që ka

mbizotëruar gjatë muajit, si kanë qenë ditët duke e integruar edhe konceptet e matematikës. Nëse ky shihet si një aktivitet interesant për fëmijët, mësuesi/ja mund ta përsërisë edhe për stinët e tjera.

- **Ushtime praktike me mjete konkretizimi dhe situata problemore** për mësimin e konceptit për numrin. Në muajin tetor fillon edhe mësimi i konceptit për numrin, duke nisur nga numri 1. Procedura që ndiqet nga njëri numër në tjetrin është e njëjtë. Në klasën përgatitore, fëmijët mësojnë konceptet për numrat nga 1-10. Ata njihen me mënyrat e ndryshme të paraqitjes së numrit 1, me gjetjen në mjedisin përreth të objekteve që janë 1, dallojnë ku ka 1, plotësojnë bashkësitet me nga një, shkruajnë numërorin 1 dhe plot veprimtari të tjera praktike. Kjo procedurë ndiqet edhe për numrat e tjera.
- **Zhvillimi i imagjinatës dhe i fantazisë së fëmijës.** Tregimi “**Vjeshta e artë**” është zgjedhur jo vetëm për t’u lidhur me karakteristikat e stinës së vjeshtës, por edhe për t’i nxitur fëmijët për të folur rrëth dëshirave të tyre, rrëth lodrave me të cilat luajnë dhe lodrave që duan të blejnë. Në vëmendjen e mësuesi/jat/ es mbeten konceptet e barazisë gjinore që lidhen me lodrat dhe lojërat. Më tej fëmijët mësojnë emrat e ditëve të javës, mësojnë se muajt e vitit kanë 30 ose 31 ditë me përjashtim të muajit shkurt.
- **Loja në role.** Nëpërmjet tregimit “Vjeshta e artë” fëmijët njihen me **Eurot** nga 1-10, por veprimet dhe situatat në lojërat “Shitësi dhe blerësi” mund t’i realizojnë vetëm me monedha. Kjo veprimtari mund të realizohet duke improvizuar në klasë një dyqan me artikuj të ndryshëm. Fëmijët i sjellin sendet nga shtëpitë dhe bëjnë grupin e tyre sipas llojit: fruta, lodra, veshje, artikuj të përzier, ushqime për të ngrënë etj. Mbi bazën e vlerave në treg, artikujve u vihen çmime dhe fëmijët bëjnë përllogaritjet e monedhave që u duhen për t’i blerë. Gjatë kësaj loje mësuesi/ja mund të shkojë nga njëri fëmijë në tjetrin për t’i pyetur për arsyet e zgjedhjes së artikullit.
- **Mësimi i shkronjave.** Duke filluar nga java e parë e tectorit është menduar të fillojë mësimi i shkronjave, gati një shkronjë në javë me përjashtim të rasteve kur shkronjat si E dhe Ë, N dhe Nj, X dhe Xh, Z dhe Zh trajtohen në një

javë. Në klasën përgatitore mësimi i shkronjave rrjedh nga një *fjalë e njojur për fëmijët*, që mund të jetë emri i një fëmije apo *fjalë e dëgjuar* dhe e lidhur me ndonjë përrallë, send, objekt etj. Shkronjën A mësuesi/ja mund ta lidhë me fjalën “Ariu” që e mësoi nga përralla “Ariu që dinte të thoshte vetëm mirëmbrëma”, mund ta lidhë me fjalën “e artë” nga tregimi “Vjeshta e artë”, mund ta nisë me një gjëegjëzë për akulloren, arrën, aeroplanin apo ndonjë fjalë tjetër që fillon me A. Mësuesi/ja mund të luajë me fëmijët duke u thënë “Hajde të gjejmë fjalë që fillojnë me shkronjën A: *Me A fillon...*”, mund të japë fjalë të ndryshme dhe të thonë nëse fillojnë apo jo me A. P.sh: *Fëmijë, fjalë gjethja fillon me a?* Dhe ata njëzëri të përgjigjen “Jooo”; *emri Ana fillon me A?* Dhe ata përgjigjen njëzëri “Pooo” e kështu me radhë.

Mësuesi/ja mund të paraqesë figura të ndryshme dhe të kërkojë nga fëmijët t'i ndajnë në dy grupe: grupei i fjalëve që fillojnë me A dhe grupei i fjalëve që fillojnë me shkronja të tjera. Mësimi i çdo shkronjeve shtrihet gjithë javën. Kohën ditore me të cilën mësuesi/ja merret me mësimin e shkronjës e zgjedh vetë.

- Në librin e punës, paraqitet **shkronja dhe fjalë kryesore** që fillon me të, paraqiten fjalë që fillojnë me atë shkronjë. Në çdo shkronjë është lënë një vend bosh ku fëmijët mund të ngjisnin ose të vizatojnë një figurë, emri i të cilës fillon me shkronjën që po mësohet. Mundet që fëmija nuk e gjen menjëherë atë fjalë. Le t'i lihet kohë. Herë pas herë mësuesi/ja kërkon nga fëmijët ta shfletojnë librin dhe të plotësojnë gjëra që i kanë lënë bosh. Më tej do të njihen me grafikun e shkronjës. Janë dhënë të dyja shkronjat e shtypit, e madhe dhe e vogël, dhe fëmija vizaton me dorë të lirë me laps brenda tyre. Siç e kemi përmendur edhe për rastin e vijave, fëmija e vizaton shkronjën në ajër, në pëllëmbë, në tabelë, e kudo që dëshiron. Mundet që grafiku i shkronjës të ndahet duke bërë njëherë shkronjën e madhe e pastaj shkronjën e vogël. Në klasën përgatitore, përparësi i është dhënë shkronjës së madhe të shtypit, por pa lënë pas dore edhe shkronjën e vogël. Kjo për arsyet e ngarkesës që nxënësi ka në klasën e parë në përballjen me leximin e

kërkuesave në tekstet shkolllore. Siç është përmendur edhe në programin e Gjuhës shqipe, fëmija lexon shkronja, fjalë e fjali të thjeshta.

Pra, një orientim për mësuesin/en mund të jetë shpërndarja e mëposhtme:

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
<ul style="list-style-type: none"> Prezantimi i shkronjës Lidhja me fjalë, përralla, vjersha, gjëza, objekte dhe sende të përdorimit të përditshëm 	<ul style="list-style-type: none"> Pasurimi i fjalorit me fjalë që fillojnë me shkronjën Ngjitja e etiketa pranë figurave. Gjetja e një fjale të re që fillon me shkronjën. 	<ul style="list-style-type: none"> Grafiku i shkronjës së madhe të shtypit fëmijëve për ta shkruar 	<ul style="list-style-type: none"> Grafiku i shkronjës së vogël të shtypit dhe ushtrimi i fëmijëve për ta shkruar 	<ul style="list-style-type: none"> Kopjimi i fjalëve që fillojnë me shkronjën. Qarkimi i shkronjës në një tekst të shkurtër dhe numërimi i shkronjave të gjetura.

- Përralla “Iriqi dhe mollët”** një përrallë klasike e njohur dhe e mësuar ndër breza fëmijësh. Nëpërmjet *etapave për mësimin e përrallës, për analizën e personazheve, për nxjerjen e mësimit dhe për ritregimin e saj*, mësuesi/ja duhet të ndalet edhe te sjellja e mirë dhe mendimi pozitiv i iriqit, për të menduar për shokët. Klasa është mjedisi i ngushtë shoqëror, ku fëmijët rrinë një pjesë të mirë të kohës së bashku. Kjo do të thotë që gjatë këtij qëndrimi ata duhet të jalin e të marrin me njëri-tjetrin, të luajnë e të veprojnë së bashku dhe të ndihen mirë në mes tyre. Sigurisht që ka edhe zënka, ka edhe pakënaqësi dhe hatërbetje. Përrallat dhe veprimet e personazheve në to janë mënyra më e mirë për t'i diskutuar situatat e pakëndshme dhe sigurisht për të nxjerrë mësime të vlefshme prej tyre. Kjo është arsyaja që herë pas here, në çdo muaj në libër janë dhënë ose shembuj ose veprimitari praktike ose përralla e tregime për këtë qëllim.

Pas trajtimit të përrallës fëmijët mund të tregojnë se çfarë mund të ofrojnë nga vetja për shokët e klasës. Nëpërmjet kësaj përralle trajtohen frutat e stinës, frutat e pemëve dhe të pyllit. Mund të trajtohen shijet e frutave. Fëmijëve mund t'u mbyllen sytë dhe nëpërmjet të prekurit të dallojnë frutat që prekin, të përshkruajnë karakteristikat e tyre, si formën, sipërfaqen, madhësinë, të ndiejnë aromën dhe të parashikojnë se cili frut mund të jenë. Kjo lojë mund të zhvillohet me skuadra djem dhe vajza ose me grupe të vogla mikse, ose t'u lihet fëmijëve të ndahen sipas dëshirës. Fëmijët mund të bëjnë një sallatë me të gjitha frutat e sjella dhe duke i ngrënë të tregojnë emrin e frutit dhe shijen që kanë. Fjalitë që mund të përdorin janë: “*Unë hëngra, Shija e tij/ e saj është....*”. Mundet që një pjesë e frutave të shtrydhen dhe fëmijët të provojnë shijen e lëngjeve të tyre dhe të tregojnë se cila u pëlqen. Fëmijët mund të mbledhin farat dhe bërthamat që kanë brenda frutat dhe ato t'i përdorin në kolazhe. Mund t'i lyejnë me bojëra dhe të bëjnë krijime nga më të bukurat sipas fantazisë fëminore apo sipas modeleve të para në programet artistike për fëmijë. Gjithashtu, fëmijët mund të kombinojnë vizatimin, farat dhe bërthamat me njëri-tjetrin e plot punë praktike të tjera. Me frutat në formë rrumbullake mund të mësohet **rrethi**. Fëmijët gjejnë në mjedis objekte dhe sende me formë rrethore e më tej hapin librin dhe punojnë fletën e punës përkatëse. E njëta procedurë ndiqet edhe për **katorin**. Nëpërmjet përrallës, fëmijët njihen me kafshët e lëndinës, si: ketri, breshka, lepuri dhe nëpërmjet lëvizjeve fizike imitojnë dhe kryejnë *kërcime* si lepur; *zvarritje* si breshkë, *hedhje* si ketër, *ecje* dhe *rrokullisje* si iriq.

- Po nëpërmjet frutave mund të mësohet **simetria** dhe fëmijët të dallojnë se cilat fruta ndahan në dy pjesë të barabarta. E më tej të plotësohet fleta e punës në librin e fëmijës. Mësojnë **gjysmën (pjesën) dhe të tërën**. E këtë veprimtari mund ta realizojnë edhe me veshjet.
- **Punët praktike.** Labirinthi është një veprimtari e këndshme që identifikon fëmijët që kanë durim, fëmijët këmbëngulës, fëmijët që nuk dorëzohen derisa ta mbarojnë një punë të nisur. Një tjetër punë praktike është ngjyrosja

e gjetheve sipas të dhënave që jepen në tabelë. Pasi mësuesi/ja i orienton fëmijët, kërkon prej tyre të ngjyrosin gjethet. Në fund kontrollojnë dhe krahasojnë punën që kanë bërë me fëmijët e tjerë. Të njëjtin qëllim ka edhe plotësimi i pemës sipas kérkesave që lexon mësuesi/ja. Fëmijët duhet të dëgjojnë me vëmendje dhe të pyesin në rasdt se nuk e kuptojnë se çfarë u kérkohet.

- Tregimi “**Gjethja e pemës që donte të rrinte vetëm në pemë**” është një tregim që lidhet me ndryshimin e ngjyrës së gjetheve në stinën e vjeshtës dhe rënien e tyre. Gjatë shëtitjes në pyll, mësuesi/ja u thotë fëmijëve: “*Rrugës duke ardhur në shkollë dëgjova disa fëmijë që thoshnin se vjeshta është piktore*”. A mendoni edhe ju si ata? Më pas zhvillohet me fëmijët biseda me qëllim që ata të gjejnë arsyet pse quhet e tillë vjeshta. Fëmijëve u kérkohet të mbledhin gjethe të formave, ngjyrave dhe madhësive të ndryshme, t'i fusin në qese të riciklueshme dhe t'i sjellin në klasë. Me gjethet, zhvillohen shumë koncepte matematike, modelime dhe sigurisht edhe punime artistike. Me gjethet mund të bëhet kombinim i tyre me vizatim për të krijuar figura të reja; mundet të kombinohen disa gjethe dhe të krijohet një iriq e plot figura të tjera. Mundet të stampohet me gjethe, të ngjitet dhe të vërehen ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës te gjethja natyrale; mund të krijohet një herbarium me gjethe etj.

Gjithashtu, tregimi synon që fëmijët të mësojnë t'i pranojnë të tjerët, të jetojnë në shoqëri, të ndihen mirë e të vlerësojnë jetën e përbashkët. Sigurisht që fëmijët kanë të drejtë të rrinë edhe vetëm, të luajnë edhe me një ose me pak shokë. Kjo është çështje zgjedhjeje, por kur janë në shkollë (kopsht), duhet të ndihen mirë dhe ta shijojnë praninë e fëmijëve të tjerë. Fëmijët kanë mundësi t'i vënë një titull tjetër tregimit. Gjithashtu, mund të krijojnë një pemë me gjethet e grumbulluara duke vendosur te secila emrin e tyre. Në funksion të kësaj teme është edhe loja e improvizuar “**Fshesa dhe gjethet**”, e cila luhet njësoj si loja “**Rrjeta dhe peshqit**”. Në fëmijë bëhet fshesa dhe fëmijët e tjerë janë gjethet e vjeshtës. Fshesa përpinqet t'i kapë dhe to përpinqen t'i shpëtojnë. Çdo fëmijë që kapet bashkohet me fëmijën

që luan rolin e fshesës. Gjithashtu, fëmijët mund të lëvizin si gjethe duke e rrrotulluar, kthyer dhe lëvizur trupin parambrapa, majtas-djathtas.

- Tregimi “**Të vishemi sipas stinës**”. Ky tregim lidhet me veshjet e fëmijëve dhe në mënyrë të veçantë me veshjet e stinës. Me ndryshimin e motit, në çdo familje bëhet ndërrimi i veshjeve dhe nxjerra e veshjeve të përshtatshme me stinën. Megjithatë ka fëmijë që kundërshtojnë. Nga tregimi fëmijët mësojnë të dëgjojnë prindërit dhe të veprojnë siç u thonë ata.
- Qëllim tjetër i tregimit është emërtimi i veshjeve, dallimi i materialeve të tyre dhe përzgjedhja e veshjes sipas motit. Fëmijët mësojnë t'i palosin veshjet në mënyrën e duhur, mësojnë si t'i kombinojnë ngjyrat. Nëpërmjet veshjeve fëmijët tregojnë si rriten. Nga njëri sezon në tjetrin ata vënë re se disa veshje nuk u bëjnë më. Atëherë fëmijët mund të marrin nismën për t'i dhuruar veshjet që nuk u bëjnë fëmijëve në nevojë. Kurse veshje të tjera mund t'i sjellin në klasë dhe mund të bëjnë veshje për kukullat. Mund të luajnë lojë në role “shtëpirash” mund të bëjnë sikur nderin rrobat në tel dhe kombinohen me matematikën duke i renditur ose kombinuar sipas një rregulli të caktuar. Mund të mësojnë si t'i ndajnë rrobat për t'i futur në lavatriçe, ose si mund t'i palosin ose të bëjnë gjoja sikur i hekurosin.

Nëpërmjet kësaj teme është mundësia të diskutohet edhe për sigurinë në shtëpi dhe të trajtohen veprimet që një fëmijë *mundet* dhe *nuk mundet* t'i bëjë kur është vetëm në shtëpi. Fëmijët dëgjojnë këngën “Ç'ka të vesh?” dhe flasin për veten e tyre, si i zgjedhin rrobat, kur i bëjnë gati, çfarë u pëlqen të veshin etj. Është momenti që mësuesi/ja të diskutojë me fëmijët edhe faktin që disa veshje janë vetëm për vajzat, disa vetëm për djemtë dhe disa edhe për vajza edhe për djem. Nëse e sheh të arsyeshme mësuesi/ja mund të tregojë faktin se kur kopsat janë në anën e majtë, veshja është për femra dhe kur kopsat janë në anën e djathjtë, veshjet janë për meshkuj. Fëmijët mund ta vënë re këtë në veshjet e tyre.

- Gjithashtu, fëmijët do të dallojnë edhe për llojet e ndryshme të veshjeve dhe përdorimin e tyre siaps rasteve: veshjet për në shkollë, veshjet për të luajtur, veshjet për të fjetur, veshjet për një ditëlindje, festë etj. Me karton të fortë mund të formohen shabllone për veshje dhe të përdoren në prerjen e copave për veshje kukullash.
- Një vjershë humoristike, “**Shiu dhe sandalet**” jepet në librin e fëmijës e në fund fëmijët ose me modelim me plastelinë ose me vizatim mund të realizojnë temën “Një ditë shiu”. Gjithashtu, në klasë mund të realizohet eksperimenti për krijimin e shiut, nëpërmjet avullimit dhe kondesimit në kapakun e tenxheres ku vlon uji.

SHTËPI, E ËMBLA SHTËPI!



Specifikat e punës në muajin nëntor

Koncepti i familjes, i përbërjes, i roleve, i marrëdhënieve, gjeneratake dhe ndryshimet që ndodhin gjatë rritjes

Tema e muajit nëntor lidhet me familjen. Kanë kaluar mbi 2 muaj shkollë dhe fëmijët janë më të lirshëm për të folur dhe për të përshkruar familjen e tyre, shtëpinë ku banojnë, të flasin për dëshirat e tyre, për kafshët shtëpiake dhe të tregojnë se çfarë u pëlqen më shumë. Gjatë muajit fëmijët njihen me 10 të drejtat kryesore, por edhe me përgjegjësitë dhe ndihmën që japid në familje.

Ndër temat javore që zhvillohen gjatë këtij muaji janë menduar:

- Familja ime
- Shtëpia ku jetoj. Përralla "3 derrkucët"
- Kafshët shtëpiake
- Tregoj më shumë për veten time
- Shqipëria në festë

Në javën e parë të nëntorit, tema javore lidhet me **familjen**. Fëmijët mësojnë rreth konceptit familje e ngushtë dhe familje e gjërë, njihen me lloje dhe përbërje të ndryshme familjesh, me brezat, marrëdhëniet dhe lidhjet që fëmijët kanë brenda familjes dhe në rrethin familjar. Pjesë e bisedave janë punët dhe profesionet që kryejnë anëtarë të ndryshëm të familjes, si dhe organizimet, gëzimet, rregullat, festat dhe traditat e çdo familjeje. Familja është një temë e ndjeshme. Përpara se mësuesi/ja të nisë ta trajtojë, duhet të njohë mirë përbërjen e familjes së çdo fëmije të klasës, në mënyrë që gjatë diskutimeve dhe bisedave askush të mos ndihet keq.

Në javën e dytë, trajtohet **përralla “3 derrkucët”** e cila lidhet me shtëpinë, me llojet e ndërtesave të banimit, lidhet me nevojat jetësore dhe të drejtën e fëmijëve për kushtet e duhura të jetesës, lidhet me pajisjet dhe orënditë shtëpiake dhe me ndihmën dhe lehtësirat që kanë krijuar për jetën në familje. Nëpërmjet përrallës trajtohen edhe marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, vëllezërve dhe motrave. Gjithashtu, fëmijët mësojnë se para se të bëjnë një punë duhet të mendohen mirë, t'i përkushtohen dhe të bëjnë më të mirën. Pjesë e diskutimeve janë edhe veprimet dhe lojërat që fëmijët mundet ose jo t'i kryejnë në shtëpi, flitet për sigurinë në shtëpi kur ata janë vetëm etj.

Në javën e tretë, trajtohet **tema e kafshëve shtëpiake**. Në përgjithësi të gjithë fëmijët i duan kafshët shtëpiake dhe janë të ndjeshëm rreth tyre. Sot në një pjesë të konsiderueshme të familjeve ndodhet një kafshë shtëpiake. Fëmijët mësojnë që jo vetëm t'i pëlqejnë e t'i duan kafshët shtëpiake, por edhe të kujdesen për to, të respektojnë nevojat e tyre jetësore, e gjithashtu të kujdesen edhe për mjedisin. Bëhet fjalë për familjet që mbajnë qen dhe duhet të pastrojnë jashtëqitjet e tyre kur ata ndotin në mjediset publike. Temë bisede gjatë kësaj jave janë vendimet që merr një fëmijë për të zgjedhur një kafshë shtëpiake, por duke dhënë edhe arsyet rreth zgjedhjes së bërë.

Gjatë javës së katërt fëmijët do të flasin **për veten**, do të tregojnë për veten, do të shprehen rreth vetes, duke e lidhur bisedën me çdo gjë që u intereson, që e duan, që e pëlqejnë, për ëndrrat dhe gjërat që duan të bëjnë kur të rriten.

Në javën e pestë fëmijët mësojnë më shumë rreth **Shqipërisë**, tregojnë nëse kanë shkuar dhe cilat qytete kanë vizituar, njihen me festën e Flamurit, flasin për mjediset natyrore dhe figurat e shquara shqiptare si Skënderbeu, Nënë Tereza etj. Gjithashtu, fëmijët flasin edhe për të afërmit që kanë jashtë Kosovës dhe tregojnë mallin që ndiejnë për ta.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve përmuanjin nëntor

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara përlëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Dëgjon vjershat dhe tregon se për çfarë bëhet fjalë në to.
- Përshkruan familjen e vet. Tregon për pjesëtarët dhe marrëdhëni që ka me secilin prej tyre.
- Tregon ngjarje të ndryshme ngajeta familjare.
- Shprehet për aktivitetet që i ka më përzemër.
- Përshkruan shtëpinë ku banon, emerton orënditë dhe pajisjet shtëpiake.
- Përshkruan kafshën shtëpiake, duke dhënë edhe arsyen përsë e pëlqen.
- Tregon për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë rritjes dhe lidh objekte, ngjarje veshje me të shkuarën.
- Dallon dëshirat n ga nevoja.
- Tregon cilësi që i ka të ngjashme ose të ndryshme nga fëmijët e tjerë.
- Dëgjon përrallën dhe e ritregon me fjalët e veta duke parë figurat. Nxjerr mesazhin nga përralla.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat D, Dh, E, Ë, F, G.

Edukata figurative

Fëmija:

- Vizaton familjen e vet dhe tregon për atë çfarë ka paraqitur.
- Zbukuron sipas fantazisë kornizën për fotografinë e familjes së vet.
- Realizon me kolazh "Shtëpinë e derrkucit". Tregon se cilën shtëpi zgjedh për të ndërtuar dhe pse.
- Realizon me aplikacion me letra me ngjyra shtëpinë.
- Vizaton nëpërmjet formave gjeometrike një nga kafshët shtëpiake (zogu, macja, qeni, peshku, breshkë lepurin etj.).
- Realizon me aplikacion ose punim me fije "Flamurin kuq'e zi".

Edukata muzikore

Fëmija:

- Përshkruan ngjarje muzikore në familje, shkollë dhe më gjerë.
- Dallon elementet themelore muzikore në këngën që dëgjon.
- Dallon instrumentin muzikor që shoqëron këngën dhe përpinqet të imiton lojën me të.
- Dëgjon këngët dhe i shoqëron me lëvizje trupore, duartrokite etj.
- Dëgjon këngët përfëmijë dhe dallon llojin e melodisë që kanë (të shpejtë-të ngadaltë)

Matematika

Fëmija:

Emërton figurat gjeometrike trekëndëshin dhe drejtkëndëshin dhe I vizaton me dorë të lirë.

- I dallon format në objekte e sende që ndodhen në mjedisin që e rrethon.
- Njihet me konceptin e numrit 3 dhe 4. Kryen mbledhje dhe zbritje deri në 4.
- Zgjidh situata të thjeshta problemore me një veprim dhe nëpërmjet objekteve ose figurave që shikon.
- Dallon grupin që ka 1 deri në 4 objekte.
- Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet më i gjatë se, më i shkurtër se, po aq i gjatë sa.
- Dallon pjesën nga e tëra.
- Grupon me dy mënyra që të krijohet numri 4.
- Përshkruan vendndodhjen e shokut/shoqes duke iu referuar vetes.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Dallon ndryshimet që pëson trupi i njeriut gjatë rritjes.
- Tregon ndryshimet që vë re te rritja e vet.
- Tregon në rrethinën e vet trupat që janë në qetësi dhe disa të tjera që janë në lëvizje.
- Dallon ditën dhe natën dhe lidh kohën e ditës me detyrimet familjare.

- Tregon rrjedhën kohore të ngjarjeve gjatë një dite.
- Emërton pjesë të reliefit që shikon nëpër figura.
- Dallon shqisat te kafshët shtëpiake dhe flet për funksionin e tyre.

Shoqëria dhe mjedis

Fëmija:

- Tregon pozitën e tij në raport me të tjerët si fëmijë-prind, nip/ mbesë-gjysh/ gjyshe, motër-vëlla etj.
- Zbaton rregullat për veprimtari të caktuara në situata të ndryshme jetësore si në familje, lagje, kopsht/ shkollë, rrugë/ komunikacion, etj
- Identifikon vendime të cilat mund t'i marrë për veten e tij, në raport me moshën.
- Tregon për anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë (p.sh.emri, mbiemri, gjinia, mosha, profesionin etj).
- Dallon familjen e tij të ngushtë nga ajo e gjerë për nga numri dhe afërsia farefisnore.
- Tregon mënyrat e sjelljes (të drejtë dhe të gabuar) për kujdesin ndaj mjedisit në rrugë, lagje, park etj.

Edukata fizike

Fëmija:

- Kryen lëvizje lokomotore sipas udhëzimeve që dëgjon.
- Merr pjesë në lojë dhe demonstron shkathësi gjatë zhvillimit të saj.
- Shpreh kreativitet me lëvizje, fjalë dhe krijime të ndryshme.

- Merr pjesë në lojë dhe demonstron shkathësi gjatë zhvillimit të saj.
- Shfaq emocionet që i përcjell loja dhe bashkëveprimi me fëmijët e tjerë.
- Shpreh kreativitet me lëvizje gjatë zhvillimit të lojës.

Shkathësi për jetën

Fëmija

- Përshkruan funksionin e disa pajisjeve elektronike në jetën e përditshme dhe i përdor për punë.
- Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kuption dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë.
- Përdor mjetet elektronike për punime të ndryshme në vizatim dhe ngjyrosje.
- Identifikon veglat dhe mjetet e punës, i përdor ato për lojëra dhe veprimitari të ndryshme në shtëpi apo kopshtshkollë.
- Identifikon veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në nsima vetjake apo të propozuara nga i rrituri.
- Stimulon shitjen e gjësendeve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe blerësit.
- Dallon ngashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet krijimeve të veta dhe të fëmijëve të tjerë.

Projekti i muajit

Në muajin nëntor është menduar projekti “**Shtëpia dhe familja ime**”. Në dosjen e fëmijës gjendet formati A3, i cili përmban një model shtëpie. Në fletë të veçantë fëmijët kanë shumë orendi dhe pajisje shtëpiake. Ata do të ngjisin vetëm ato që i kanë në shtëpitë e tyre, duke i vendosur në mjediset përkatëse. Gjithashtu pjesëtarët e familjes mund të krijohen me modelim me plastelinë, ose mund të apraqiten me vizatim ose me një fotografi. Kjo veprimitari kërkon të zhvillohet në bashkëpunim me prindërit, sepse fëmijët duhen ndihmuar për t'i vendosur gjërat në vendin e duhur.

Në një ditë të caktuar, mësuesi/ja kërkon nga fëmijët që të flasin rreth shtëpisë, t'i bëjnë pyetje njëri - tjetrit dhe të dallojnë çfarë kanë të përbashkët dhe nga ndryshon shtëpia e tyre nga shtëpitë e fëmijëve të tjerë.

Në fund të muajit çdo fëmijë merr një certifikatë vlerësimi të dhënë nga shokët. Pra përgatitin certifikata dhe vlerësojn pozitivisht projektet e shokëve të tyre. Projekti më i mirë i klasës zgjidhet në bazë të stikerave që fëmijët kanë vendosur në punimet e njëri-tjetrit.

Planifikimi i temave për muajin nëntor “Shtëpi, e ëmbla shtëpi”

	Java 1 Familja ime	Java 2 Shtëpia ime. Përralla “3 derrkucët”	Java 3 Kafshët shtëpiake	Java 4 Tregoj më shumë për veten time	Java 5 Shqipëria në festë
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Familja” (<i>Fq. 89</i>) • Pjesëtarët dhe brezat në familje • Profesionet dhe punët e prindërve • Ngjarje të rëndësishme në familje; Fundjavat dhe festat në familje • Vjersha “Që të kenë veç gjëzim” (<i>Fq. 97</i>) • Shkronja D (<i>Fq. 98- 99</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtëpitë e banimit janë të ndryshme • Shtëpitë në qytet, shtëpitë në fshat • Shtëpia ku jetoj • Orenditë dhe pajisjet shtëpiake • Përralla “3 derrkucat” (<i>Fq. 100</i>) • Shkronja Dh (<i>Fq. 104 - 105</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Kam një mace, kam një qen” (<i>Fq. 106</i>) • Kafshët shtëpiake që mbajnë në shtëpi (<i>Fq. 107</i>) • Në dyqanin e kafshëve (<i>Fq. 111</i>) • Orari ditor i qenit/ maces; • Lojë në role “Te veterineri” • Shkronja E (<i>Fq. 108 - 109</i>) • Shkronja Ë (<i>Fq. 112 - 113</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Si linda unë? (<i>Fq. 114</i>) • Dje – Sot - Nesër; Vjersha “Tani jam 5 vjeç” (<i>Fq. 115</i>) • Përralla “Kotelja e zezë që donte të ishte e gjitha e bardhë” (<i>Fq. 118 - 119</i>) • Dëshirat e mia; më pëlqen, nuk më pëlqen • Ngjaj me..., ndryshoj nga... • Shkronja F (<i>Fq. 120 - 121</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Nëntori vjen bashkë me festën e Flamurit; • Vjershat (<i>Fq. 124</i>) “Sa të dua Shqipëri!”, “Shqiponja” • Kur ka festë të gjithë gëzojmë; • Bukuritë e Shqipërisë • Shkronja G (<i>Fq. 126 - 127</i>)

Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> Një kornizë për fotografinë e familjes sime (Fq. 96) 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim dhe ngjyrosje "Shtëpia ime" (Fq. 101) 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim dhe ngjyrosje "Kafsha që më pëlqen të kem në shtëpi" (Fq. 111) 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim "Unë dhe lodrat e mia" 	<ul style="list-style-type: none"> Aplikacion/ punim me fije "Flamuri kuq' e zi" (Fq. 125)
Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Këngët që i këndojmë nëpër festa e gëzime familjare 	<ul style="list-style-type: none"> Instrumentet muzikore Më pëlqen të këndoj; më pëlqen të luaj në piano; 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Sa do të doja një qenush..." 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Nina -nana" 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Ty flamur të duam shumë"
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Numri 3 (Fq. 92 - 93) Renditje nga 1-3. Shoqërimi njëpërnjë (Fq. 110) Zbulo rregullin, vazhdo modelin. Më i madh/ më i vogël se... 	<ul style="list-style-type: none"> Trekëndëshi (Fq. 102 - 103) Më i gjati/ më i shkurti/ po aq i gjatë. Mbledhje dhe zbritje deri në 3. Krijime me forma gjeometrike. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesa dhe e tëra. Numërim dhe renditje nga 1 në 3 dhe anasjelltas. Gjej 3 ndryshimet. Renditja në kohë e ngjarjeve - Mëngjes, drekë, darkë. 	<ul style="list-style-type: none"> Numri 4 (Fq. 116 - 117) Krijimi i bashkësive me deri në 4 elemente. Krahasimi i tyre. Më shumë/ më pak/ po aq Më i gjatë, më i shkurtër, po aq i gjatë. 	<ul style="list-style-type: none"> Konceptet "Afër dhe larg". Drejtëkëndëshi (Fq. 122 - 123) Situata problemore me mbledhje dhe zbritje deri në 4. Grupimi, klasifikimi, veçimi i objekteve deri në 4.

Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimet që pëson trupi i njeriut gjatë rritjes (<i>Fq. 94 - 95</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Kujdesi për natyrën dhe mjedisin ku jetoj. Ndikimi i njeriut në mjedis. 	<ul style="list-style-type: none"> Shqisat te kafshët (<i>Fq. 110</i>) Kujdesi për kafshët shtëpiake (<i>Fq. 107</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Detyrimet familjare gjatë orëve të ditës. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesët e reliefit: Mali, fusha, kodra, lumi, deti, liqeni
Shoqëria dhe mjedis	<ul style="list-style-type: none"> Familje e ngushtë, familje e gjerë (<i>Fq. 90 - 91</i>) Marrëdhëniet¹ në familje 	<ul style="list-style-type: none"> Kujdesem që mjedisi të jetë i pastër. 	<ul style="list-style-type: none"> Unë vendos për veten time. Dua..., sepse... 10 të drejtat kryesore të fëmijëve. 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet me pjesëtarët e tjera të familjes. Respekti për më të rriturit. 	<ul style="list-style-type: none"> Monumentet, figurat dhe ngjarjet historike. Veshjet në rastin e ngjarjeve dhe të festave zyrtare.
Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Loja muzikore “Çova një letër mu në postë”. Goditje në shenjë. 	<ul style="list-style-type: none"> Loja “Kush e zë i pari karrigen” 	<ul style="list-style-type: none"> Loja “E ka, kush e ka”; Loja “Macja kapi miun”. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndihem i gëzuar kur... mërzitem kur...; Lojë me birila 	<ul style="list-style-type: none"> Lojë muzikore “Ne jemi 2 shqiponja”

¹ Në këtë temë është rasti të diskutohet me kujdes raste të tillë kur fëmijët jetojnë me prindër të divorcuar, kur jetojnë në familje të madhe, kur njëri ose të dy prindërit janë rimartuar, kur në familje do të shtohet një fëmijë tjetër, kur jetojnë me një prind etj.

Shkathësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Pajisjet shtëpiake dhe përdorimi i tyre 	<ul style="list-style-type: none"> Jam i zoti për... 	<ul style="list-style-type: none"> Llojet e materialeve që mund të përdorim te: Kolibja e qenit dhe kocka; akuariumi i peshkut, kaçilja e maces; topi i kavies, kafazi i kanarinës. 	<ul style="list-style-type: none"> Libri "Familja ime". Lojë në role "Në familje" 	<ul style="list-style-type: none"> Marr dhe jap (Shkëmbime që mund të bëj)
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> My home; Number 3 	<ul style="list-style-type: none"> All about me- My self 	<ul style="list-style-type: none"> My favourite pets. Collage of pets. 	<ul style="list-style-type: none"> My family members. 	<ul style="list-style-type: none"> Number 4
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Zarfi magjik - Dëshirat tonë fusim brenda tij. 	<ul style="list-style-type: none"> Kapela e muratorit 	<ul style="list-style-type: none"> Libër për kafshët shtëpiake. Emrat që mund të kenë. 	<ul style="list-style-type: none"> Biznesi që mund të hap kur të rritem 	<ul style="list-style-type: none"> Si të binjakëzohemi me një shkollë në Shqipëri.

Veprimtaritë mësimore të parashikuara për muajin nëntor

- **Biseda rreth familjes.** Fëmijët nxiten të flasin rreth figurave që shohin në librin e punës. Të drejtuar nga mësuesi/ja ata shohin familje me numër të ndryshëm anëtarësh, veprimtari që kryejnë familjet së bashku dhe tregojnë se cilat prej tyre u përket ose ka lidhje familja e tyre. Gjatë gjithë javës fëmijët përmenden ngjarje të ndryshme që përfjetojnë në familje, tregojnë se kur ndihen të gëzuar, kur ndihen të lumtur, kur ndihen të mërzitur etj. Në bisedë e sipër fëmijët mësojnë se të gjithë anëtarët e familjes kujdesen për njëri-tjetrin, e ndihmojnë dhe kontribuojnë për mirëqenien e jetës familjare. Edhe fëmijët megjithëse janë të vegjël mundet të kryejnë punë në familje duke rregulluar lodrat e duke i vënë në vendin e tyre, duke ndihmuar prindërit në punë të thjeshta, duke iu bindur kërkesave që bëjnë më të rriturit etj. Gjatë bisedës fëmijët tregojnë si janë rritur dhe si kanë ndryshuar gjatë rritjes. Fëmijët mund të kujtojnë lodrat, veshjet, ushqimet, fotografitë kur kanë qenë më të vegjël, t'i krahasojnë me lodrat, lojërat dhe veshjet që veshin tanë dhe të bëjnë një parashikim si do të duken kur të rriten.

Në fletën e punës **“Duke u rritur, duke ndryshuar”** janë dhënë dy bebe. Kur fëmijët t'i lidhin figurat me njëratjetren dhe të përshkruajnë si rritet një djalë dhe një vajzë dhe ndryshimet e dukshme gjatë rritjes, është me vend që mësuesi/ja të ndalet dhe të kërkojë nga fëmijët se cilin prej atyre bebeve e konsideruan vajzë e cilin djalë. Fëmijët do të kuptojnë që kur janë të vegjël, fëmijët nuk kanë dallime të dukshme në pamjen fizike, kur rriten, edhe ndryshimet bëhen më të dukshme. Nga ana tjeter, mësuesi/ja do të kërkojë që fëmijët t'i ngjyrosin figurat dhe pasi t'i përfundojnë duhet ta drejtojë bisedën te përdorimi i të gjitha ngjyrave, duke luftuar stereotipet gjinore. Fëmijët mund të tregojnë për dëshirat që kanë, për gjërat që u pëlqejnë duke gjetur mes fëmijëve të tjerë ngjashmëri dhe ndryshime. Renditja në kohë e ngjarjeve dhe momentet ngajeta familjare përmenden gjatë bisedave për jetën në familje. E njëjtë veprimtari kryhet edhe për lindjen e fëmijëve dhe histori që fëmijët kanë dëgjuar për këtë temë.

Fëmijëve duhet t'u tregohet e vërteta, por aq sa është e nevojshme për moshën që ata kanë dhe për aq sa ata mund të kuptojnë.

- **Vjershat** “Familja” dhe “Që të kenë veç gëzim”. Fëmijët i dëgjojnë vjershat dhe u përgjigjen pyetjeve rrith përbajtjes së tyre. Nëpërmjet vjershave, fëmijët shprehin dashurinë për prindërit, gjyshërit, motrat dhe vëllezërit. Ata krijojnë pemën e familjes me pjesëtarët e familjes, gjyshërit dhe kushërinjtë që njohin.
- Në vjershën “Kam një mace, kam një qen” fëmijët mësojnë për dobinë e kafshëve shtëpiake dhe lidhjen e fortë që kanë me njeriun. Fëmijët mund të ndahen në grupe sipas kafshës që pëlqejnë dhe u tregojnë shokëve se pse duhet të blejnë një qen, mace, lepur, breshkë, peshk, zog apo ndonjë kafshë tjeter në shtëpi. Kjo lojë mund të lidhet edhe me konceptin e matematikës “Më shumë-më pak” ku pasi numërohen preferencat e fëmijëve krijohet një tabelë me të dhëna dhe shpallet cila është kafsha më e preferuar e fëmijëve dhe cila më pak e preferuar.
- **Loja me figura** është një veprimitari që i nxit fëmijët t'i përshkruajnë figurat dhe të gjejnë radhën e tyre. Këtij qëllimi i shërben fleta e punës “Unë kujdesem për...”. bisedat për kafshët shtëpiake kanë lidhje jo vetëm me njohjen dhe emërtimin e tyre, por edhe për dallimin e vednit ku jetojnë kafshët, për sendet e tyre personale, për emrat që mund të kenë dhe për kënaqësinë që të falë secila prej tyre. Fëmijët mund të zgjedhin dhe të marrin në klasë një peshk, breshk, lepur apo zog dhe të kujdesen për ushqimin, pastrimin dhe për dashurinë që edhe kafshët kanë nevojë.
- **Loja në role** është një veprimitari e rëndësishme për interpretimin e marrëdhënieve brenda familjes, e lidhur me situata ngajeta e përditshme në familje, fëmijët mund të mendojnë sikur do të rganizojnë një festë, një ditëlindje, një piknik, një udhëtim diku dhe secili merr përgjegjësitë e duhura brenda familjes që gjithçka të shkojë në

mënyrën më të mirë. Lojëratë në role “Te veterineri” ose “Në dyqanin e kafshëve” i ndihmon fëmijët të shprehin një shqetësim, një dëshirë, të bëjnë pyetje dhe të zgjidhin një problem.

- **Përralla** “3 derrkucët” është një përrallë klasike që fëmijët mund ta kenë dëgjuar edhe më parë. Këtë përrallë fëmijët mund ta shohin në CD, në internet e më pas ta tregojnël përbajtjen me fjalët e tyre. Në librin e punës, përralla vjen ndryshe, nëpërmjet leximit me figura. Figurat janë dhënë të tillë që fmëija ta ketë të lehtë ta rritre gojë përbajtjen nëpërmjet tyre. Gjithashtu, kjo përrallë lidhet edhe me bisedën për shtëpinë si ndërtesë, për llojet e banesave të banimit, të ndryshimeve që ato kanë nga njëra-tjetra. Fëmijët flasin për shtëpinë ku banojnë. Qëllimi i bisedës është që fëmijët të pasurojnë fjalorin me fjalë dhe terma që kanë lidhje me familjen, shtëpinë, orenditë, pajisjet, arredimin, ngjyrat dhe të tregojnë edhe kujdesin e duhur në shtëpi. Për këtë temë mund të shërbejë edhe tregimi “**Loja kukafshehti në shtëpi**”, duke u tërhequr vëmendjen fëmijëve për lojërat që nuk duhet të bëjnë në shtëpi kur janë vetëm ose me shokë, ose ku shkojnë në një shtëpi tjeter etj. Është me vend të diskutohet edhe tregimi “**Mos e fshih fajin**” që ka lidhje me gabimet që fëmijët bëjnë në shtëpi dhe me mos kallëzimin e fajit. Loja në role, pyetjet dhe situatat problemore i ndihmojnë fëmijët të mësojnë më shumë dhe të tregojnë ngjarje nga jeta e përditshme.
- **Përralla** “**Kotelja e zezë që donte të ishte e gjitha e bardhë**”, trajton një aspekt tjeter të jetës familjare, kur një anëtar familje ndryshon nga të tjerët. Është rasti që fëmijët të ndihen mirë me veten ashtu siç janë, ta vlerësojnë veten për anët dhe cilësitë e mira që kanë, të pranojnë dhe të ndihen të pranuar nga të tjerët. Arsyet e këtyre ndryshimeve janë të ndryshme, por nuk është rasti që mësuesi/ja të ndalojë rrëth tyre. Kur një familje shtohet me një fëmijë tjeter, zakonisht fëmijët më të rritur shfaqin shenja xhelozie, ose herë-herë fëmijët dëgjojnë t'u jenë pjesë e krahasimeve me pjesëtarë të tjerë që ndoshta nuk u pëlqejnë. Prandaj mësuesi/ja e drejton me kujdes bisedën. E rëndësishme është që fëmijët të kuptojnë se ata janë unikë dhe prindërit i duan shumë, që jeta në familje është e

ndryshme dhe situatat që jetohen në familjet e tjera po ashtu. Këto ndryshime fëmijët mund t'i vënë re edhe ndërmjet tyre në klasë dhe të mësojnë të ndihen mirë e të vlerësojnë veten për aftësitë e veçanta që kanë.

- **Punimet artistike** që do të zhvillohen gjatë muajit nëntor kanë lidhje me temën qendrore. Fëmijët do të vizatojnë familjen e tyre dhe do ta zbukurojnë kornizën e saj sipas dëshirës. Për ata fëmijë që nuk mundën mund të ngjisnin një fotografi dhe të flasin rrëth saj. Gjithashtu, fëmijët do të vizatojnë shtëpinë ku banojnë, por mundet që ta realizojnë me aplikacione ose me kolazh nëse vendosin të bëjnë shtëpinë e njërit prej derrkucëve. Gjithashtu, fëmijët do të vizatojnë një kafshë shtëpiake që do të donin të kishin. Mësuesi/ja mund t'i shfrytëzojë punimet e fëmijëve për të bërë krahasime ndërmjet tyre dhe për të nxjerrë në dukje elemente të caktuara të përdorura në realizimet e kryera. Pas realizimit të punimeve mësuesi/ja mund t'i pyesë fëmijët nëse duan t'i shtojnë ndonjë gjë të re punimit, nëse do të donin ta bënin me teknika të tjera, nëse do të donin të përdornin materiale të reja etj.
- **Punë praktike** “**Një libër i gjithi për mua**”. Fëmijët flasin për veten, tregojnë për jetën e tyre, për ngjarje që mbajnë mend, për lodrat, veshjet, ushqimet, për prejardhjen e emrit, për emrat që mund të jenë thirrur kur kanë qenë më të vegjël, për vendet që frekuentonin me prindërit, gjyshërit etj. Gjithahtu, mësuesi/ja mund të kërkojë nga fëmijët e tjerë të shprehin vlerësime pozitive për shokët e tyre, për atë çfarë u pëlqen, si dhe ëpr të shfaqur ndonjë këshillë apo mendim për të bërë përmirësime të mundshme. Në këtë muaj mund të shpallet edhe fëmija më paqësor, duke qenë se jemi te muaji i të drejtave të fëmijëve.
- **Këngët** që fëmijët do të këndojnë kanë lidhje me temat javore. Ndër to përmendim “**Oh, ç'u rrëzova**”, “**Ninanana**”, “**Sa do doja një qenush**”, “**Ty flamur të duam shumë**”. Fëmijët përpiken t'i këndojnë e të shoqërojnë këndimin me lëvizje trupore, me mimikë dhe përplasje duarsh. Me ndihmën e prindërve fëmijët mund të tregojnë për këngë që i këndojnë në familjet e tyre apo të gjithë së bashku të këndojnë këngën “**Gëzuar ditëlindjen!**” në gjuhë të huaja.

- Edhe në edukimin fizik janë përgjedhur **lojëra muzikore tradicionale** si “Çova një letër mu në postë”, “Ne jemi dy shqiponja” të cilat janë të thjeshta për t'u luajtur nga fëmijët, por edhe për t'u përsëritur disa herë gjatë muajit. Po kështu lojërat lëvizore “**Kush e zë i pari karrigen**”, “**Macja kapi miun**” dhe “**E ka kush e ka**” zhvillon te fëmijët aftësitë lëvizore, koordinuese, vëmendjen, përqendrimin dhe shkathtësinë për të shpëtuar në situatat që krijohen. Të njëtin qëllim ka edhe loja muzikore “**Ne jemi 2 shqiponja**”.
- **Vepriptari praktike** për konceptet e matematikës. Gjatë muajit nëntor fëmijët do të njihen me **koncepcin për numrin 3** dhe **4** dhe me **format gjeometrike** të trekëndëshit dhe të drejtkëndëshit. Nëpërmjet formave të mësuara fëmijët krijojnë figura të reja, zbaviten me kombinimin e tyre, zbulojnë rregullin dhe vazhdojnë vargun etj. Gjithashtu, ata do të përsërisin edhe konceptet e mësuara më përpara.
- Gjatë muajit nëntor do të mësohen shkronjat **D, Dh, E, Ë, F, G**. Procedura që ndiqet për mësimin e tyre është e njëjtë si edhe për shkronjat e mësuara më parë.
- Pas mësimit të shkronjës Dh është menduar që mësuesi/ja të ndalojë e të bëjë **përsëritjen e shkronjave** të mësuara nga A-Dh. Në dosjen e fëmijëve gjendet formati A3 “Luaj me shkronja” dhe kartelat me shkronjat e mëdha të shtypit dhe me fjalët përkatëse.

DIMËR, EDHE TË DUA EDHE S'TË DUA!



Specifikat e punës në muajin dhjetor

Njohja me karakteristikat e stinës së dimrit, motin, kafshët e pyllit, veshjet e stinës dhe festat e fundvitit.

Dhjetori është muaji i fundit i vitit dhe në fokus të tij është stina e dimrit dhe festat e fundvitit. Në dhjetor mbylllet periudha e parë e vitit shkollor, prandaj krahas mësimit të koncepteve të reja, mësuesi/ja organizon edhe përsërithjen e koncepteve të mësuara përgjatë këtyre muajve.

Ndër temat javore të këtij muaji përmendim:

- Dimër dhe të dua dhe s'të dua,
- Pylli, shtëpia e kafshëve të egra,
- Veshjet e stinës,
- Dhurata dhe pretime.

Në javën e parë fëmijët do të njihen me **karakteristikat e stinës së dimrit**, me natyrën në dimër, me reshjet dhe motin, me virozat e stinës, me pajisjet e ngrohjes dhe me kujdesin në rrugë, por jo vetëm. Kënaqësia e veçantë e fëmijëve me stinën e dimrit lidhet me lojën me topa bore dhe përgatitjen e një dordoleci (njeriu prej bore).

Në javën e dytë fëmijët njihen me **kafshët e egra**, me kafshët e pyllit. Fëmijët mësojnë se një pjesë e tyre dimërojnë dhe bien në gjumë të gjatë letragjik. Fëmijët mësojnë pér vendet ku jetojnë kafshët e egra, shqisat dhe nevojat që kanë pér të jetuar.

Në javën e tretë tema ka lidhje me **veshjet e dimrit**. Në varësi edhe të qytetit/ fshatit ku jetojnë fëmijët bëhet përshkrimi i veshjeve që duhet të veshin, me qëllim që të jenë ngrohtë. Një pjesë të veshjeve që fëmijët nuk i veshin më, mund t'i mbledhin për t'ua dhënë njerëzve në nevojë. Është e rëndësishme që fëmijët të ndiejnë kënaqësi kur u bëjnë mirë shokëve, fëmijëve, të moshuarve që jetojnë në vështirësi.

Java e katërt ka lidhje me **atmosferën festive të Vtitit të Ri**, me zbukurimin e klasës, me mësimin e vjershavë, të valleve dhe të këngëve së Vtitit të Ri, me përgatitjen e dhuratave, me shprehjen e dëshirave dhe me bërjen e premtimeve për vitin e ri.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve përmuanjin dhjetor

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara përlëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan një ditë dimri.
- Dallon karakteristikat e dimrit dhe përshkruan motin.
- Reciton vjershat dhe nxjerr kuptimin e tyre.
- Përshkruan veshjet që përdoren gjatë dimrit.

- Krijon një përrallë duke parë figurat.
- Tregon për dhuratën që do të marrë.
- Njihet me kafshët e egra dhe bën pyetje për të mësuar më shumë për to.
- Parashikon fundin e historisë që dëgjon.
- Tregon për arritjet e deritanishme dhe bën një premtim për vitin e ri.
- Përgatit një kartolinë dhe tregon se për kë e ka.
- Përshkruan emocionet që përjeton në ngjarje e ditë të caktuara.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat Gj, H, I, J.

Edukata figurative

Fëmija:

- Vizaton dhe ngjyros peisazhin e pyllit në dimër.
- Realizon dordolecin (njeriun prej bore) me teknika të ndryshme.
- Realizon me tekstile veshjet e dimrit.
- Zbukuron sipas modelit të dhënë kapucin, dorezat dhe shallin e dimrit.
- Realizon një kartolinë urimi me teknikën e kolazhit.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dallon llojet e ndryshme të muzikës përmes dëgjimit muzikor.
- Dallon vetitë themelore të tingujve në lojërat, këngët dhe pjesët muzikore që dëgjon.
- Dëgjon muzikë dhe *shpik* lëvizje ritmike.
- Shpreh mendimin e vet për krijimet dhe performimet vetanake dhe të bashkëmoshatarëve.
- Këndon këngën e Vtitit të Ri duke shprehur gëzimin në forma të ndryshme.

Matematika

Fëmija:

- Dallon se sfera ka formë të rrumbullakët.
- Gjen në mjeshtësi objekte të ngjashme me formën rrethore.
- Kryen mbledhje dhe zbritje brenda numrit 4.
- Dallon sipërfaqet brenda dhe jashtë një figure.
- Radhit numrat deri në 5.
- Dallon grupin që ka 2 - 5 objekte
- Dallon qoshet te kubi.
- Krahason përmasat e tyre.
- Grupon objektet me disa mënyra për të krijuar numrin 5.

- Përshkruan vendndodhjen e një objekti.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Tregon karakteristikat themelore të stinës së dimrit.
- Përshkruan ndryshimet e motit gjatë stinës së dimrit.
- Dallon pajisjen që ngroh më shumë.
- Dallon trupin më të nxeh të nga trupi më i ftohtë.
- Tregon nevojat themelore jetësore të kafshëve: strehim, ushqim, ujë, ajër, dritë
- Dallon trupin më të ndritshëm.

Shoqëria dhe mjedisi

Fëmija:

- Përshkruan emocionet e veta në situata të ndryshme jetësore.
- Dallon dëshirat nga nevojat.
- Dallon sjelljet e drejta në veprimet e personazheve.
- Gjen mënyra për të dhënë ndihmën e vet për njerëzit në nevojë.
- Emëronton disa nga festat familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e vet përshkruan organizimin e tyre.

Edukata fizike

Fëmija:

- Demonstron shkathtësi dhe përqendrim gjatë lojës.
- Menaxhon emocionet gjatë lojës.
- Zhvillon shkathtësi lëvizore.
- Respekton rregullat gjatë lojës.
- Kombinon lëvizje të ndryshme jo lokomotore.
- Njeh dhe praktikon mënyrat e çlodhjes gjatë lojës dhe ushtrimeve fizike.

Shkathtësi për jetën

Fëmija:

- Identifikon veglat, pajisjet dhe makinat e thjeshta të ekonomisë familjare.
- Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
- Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve, sa u përket talenteve, interesave dhe prirjeve.
- Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale ricikluese natyrale dhe artificiale.
- Dallon vlerën e parasë sipas formës dhe cakton deshirën për blerje.

Projekti i muajit

Në muajin dhjetor është parashikuar projekti “**Në stinën e dimrit**”. Çdo javë fëmijët do të punojnë për të realizuar projektin në fletën e tyre A3 ashtu siç e mendojnë. Në ditët e fundit të vitit fëmijët e prezantojnë projektin duke dhënë sa më shumë detaje dhe duke treguar kënaqësinë që kanë fituar gjatë punës. Si edhe në rastet e tjera, edhe për realizimin e këtij projekti fëmijët duhet të ndihmohen edhe nga prindërit.

Në mbyllje të periudhës së parë të vitit mësimor, mësuesi/ja shpërndan Certifikat e vlerësimit për secilin fëmijë, duke i lexuar para klasës dhe duke evidentuar për çdo fëmijë punimet më të mira, sjelljen, bashkëpunimin, aftësitë krijuese, intepretuese, shoqërizimin, dashurinë dhe vlera të tjera të cilat i japid fëmijëve motivim për të vazhduar me të njëjtën mënyrë.

Pas shkronjës H, mësuesi/ja zhvillon veprimtqarinë “Luaj me shkronja” për grupin e tyre të dytë nga shkronja E – H.

Planifikimi i temave për muajin dhjetor “Dimër, edhe të dua edhe s’të dua!”

	Java 1 Në stinën e dimrit	Java 2 Pylli, shtëpia e kafshëve të egra	Java 3 Veshjet e stinës së dimrit	Java 4 Dhurata dhe premtimi
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> Vjersha “Bie borë”; Natyra dhe moti në dimër (<i>Fq. 129</i>) Tregimi “Bredhi i vogël”; Më pëlqen/ nuk më pëlqen (<i>Fq. 130 - 131</i>) Vjersha “Kush e qethi pyllin?” (<i>Fq. 134</i>); Jo të gjitha pemët i rrëzojnë gjethet në dimër Shkronja Gj (<i>Fq. 136 - 137</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Pylli shtëpia e kafshëve të egra; Në dimër disa kafshë bien në gjumë të gjatë. Vjersha “Kënga e trenistik” (<i>Fq. 138</i>) Përralla “Cili hyri brenda në dorashkë?” (<i>Fq. 139</i>) Renditja e ngjarjeve në një përrallë. Shkronja H (<i>Fq. 144 - 145</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Veshjet e dimrit; Si bëhet një triko (<i>Fq. 142 - 143</i>) Mësimet që nxjerrim nga përrallat; Dikush ka nevojë për veshjet që nuk përdoren më Pajisjet e ngrohjes Përralla “Miri, njeriu prej bore dhe Viti i Ri” (<i>Fq. 146 - 147</i>) Shkronja I (<i>Fq. 150 - 151</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Tregimi “Kapelat e Vitit të Ri” (<i>Fq. 152</i>) Dhurata që dua të marr dhe premtimi që duhet të mbaj Shtrojmë bukur tavolinën Pushimet dimërore Shprehim dëshira dhe kërkesa Na këndon zemra e vogël Shkronja J (<i>Fq. 156 - 157</i>)
Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> Punim me bojëra uji “Peisazh në dimër” 	<ul style="list-style-type: none"> “Njeriu prej bore” me teknika të ndryshme 	<ul style="list-style-type: none"> Punim me tekstile “Dorezat, kapuç i dhe shalli i dimrit”. 	<ul style="list-style-type: none"> Kartolinat e urimit Vizatim “Dhurata që dua” (<i>Fq. 159</i>)

Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Llojet e muzikës: për vallëzim, për film vizatimor, për fëmijë, për festa, ditëlindje, raste. 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Oh sa mirë, oh sa keq". Shoqërimi i këngës me përplasje duarsh. 	<ul style="list-style-type: none"> Tingulli dhe vetitë e tij: gjatësia, lartësia, ngjyra dhe forca. Dallimi i veteve të tij te kënga "4 stinët e vitit". 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Ja na erdhi Viti I Ri".
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Figura me forma gjeometrike (<i>Fq. 132 - 133</i>) Sfera Koncepti "i nxehtë/ i ftohtë" Mbledhje dhe zbritje deri në 4 	<ul style="list-style-type: none"> Numri 5 (<i>Fq. 140 - 141</i>) Mix konceptesh Koncepti "Brenda-jashtë" Problema të thjeshta me një veprim 	<ul style="list-style-type: none"> Kubi Situata problemore me mbledhje e zbritje deri në 4 Zbullo rregullin dhe vazhdo modelin Plotësim dhe krahasim bashkësish deri në 5 elemente. 	<ul style="list-style-type: none"> Numri rreshtor deri në 5 Kuboidi Nga formë në trup gjeometrik Parashikime blerjesh deri në 10 euro.
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat e stinës së dimrit 	<ul style="list-style-type: none"> Nevojat themelore jetësore të kafshëve: strehim, ushqim, ujë, ajër, dritë 	<ul style="list-style-type: none"> Burimet natyrale dhe artificiale të ngrohjes (<i>Fq. 149</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Burimet e dritës. Cila ndriçon më shumë? (<i>Fq. 148</i>)
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> Ndjenjat dhe emocionet e mia. Ndihem... kur... 	<ul style="list-style-type: none"> Rregullat në jetën personale fëmijëve (<i>Fq. 153</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Nevojat dhe dëshirat e fëmijëve (<i>Fq. 153</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Emocionet që më tregon fytyra (<i>Fq. 155</i>) Traditat e festimit të Vitit të Ri.

Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Bëjmë, hedhim dhe presim topa bore; 	<ul style="list-style-type: none"> Lojëra me top; Kafshët e egra 	<ul style="list-style-type: none"> Lëvizje rreth pengesave; Hedhje dhe kërcime mbi 20 cm 	<ul style="list-style-type: none"> Ushqime të shëndetshme që marrim nga bimët dhe kafshët.
Shkaktuesi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Pajisjet e ngrohjes – kujdesi me to Mjedisi i sigurt në shtëpi dhe në shkollë. 	<ul style="list-style-type: none"> Maket “Në kopshtin zoologjik”. Skeda për kafshët e egra. 	<ul style="list-style-type: none"> Krijime me materiale dhe mjete të riciklueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Lista e gjërave që na duhen për të blerë zbukurimet e Vtitit të Ri Kursimet e mia.
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> Names the objects of the classrrrom 	<ul style="list-style-type: none"> The animals. Number 5 	<ul style="list-style-type: none"> My friends 	<ul style="list-style-type: none"> A shopping list
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Njeriu prej bore me çorape dhe i mbushur me oriz. 	<ul style="list-style-type: none"> Dorashka më e madhe në botë që i zë të gjitha kafshët e pyllit. 	<ul style="list-style-type: none"> Në dyqanin e veshjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> Në dyqanin e lodrave.

Veprimtaritë mësimore përmes muajin dhjetor

- **Shëtitje në natyrë.** Stina e dimrit është një stinë e ftohtë, por fëmijët mund të dalin në mjedisin përrreth kopshtit/ shkollës. Gjatë shëtitjes, fëmijët përshkruajnë çfarë shohin në natyrë, pemët, tymin që del nga oxhaqet e shtëpive, dritaret e myllura, njerëz që ecin me duar në xhepa etj. Pas shëtitjeve që bëjnë në natyrë, fëmijët ulen dhe vizatojnë natyrën në dimër. Tregimi “**Bredhi i vogël**” i ndihmon fëmijët të kuptojnë se ndër pemët që nuk i rrëzojnë gjethet janë bredhat dhe pishat. Nga analiza e tregimit, fëmijët mësojnë të kënaqen me pamjen që kanë, me afësitë dhe gjërat që dijnë t'i bëjnë vetë. Secili fëmijë mund të tregojë ngjarje ose momente kur ka dashur të ishte ndryshe nga ç'është tani ose diçka që nuk i është realizuar siç e dëshironte.
- **Bisedat** për pajisjet e ngohjes, për burimet e dritës, për sigurinë në shtëpi/klasë janë tema që realizohen duke marrë shkas nga situata reale. Fëmijët janë të vegjël, kanë natyrë kureshtare dhe sidomos kur qëndrojnë vetëm në shtëpi synojnë të bëjnë gjëra e veprime që prindërit i ndalojnë. Këto janë procese të lidhura me dëshirën dhe kuriozitetin e fëmijëve për të zbuluar rreth mjedisit që i rrithon. Mësuesi/ja duke u treguar fotografi dhe raste të ndryshme të improvizuara kërkon mendimin e fëmijëve për veprime që duhet ose jo t'i bëjnë, pra që lidhen me sigurinë në shtëpi. Gjithashtu, fëmijët mund të njihen me numrin e policisë, të ambulancës, të zjarrfikëses dhe të improvizojnë lojë në role për të kërkuar ndihmë në rast urgjencë.
- **Vjershat** “**Bie borë**”, “**Kush e qethi pyllin**”, “**Kënga e trenistit**” janë të lidhura me temat javore. Fëmijët i mësojnë përmendësh dhe bëjnë interpretimin e përbajtjes së tyre. Jo të gjithë fëmijët e pëlqejnë dimrin dhe për këtë arsy me mësuesi/ja pyet dhe merr mendime në lidhje me të mirat dhe problemet që krijojnë gjatëtinës së dimrit. Gjatë recitimit, fëmijët përdorin edhe mimikën dhe gjuhën e gjesteve. Te vjersha “**Kënga e trenistit**” fëmijët mësojnë të duan dhe të respektojnë njerëzit që punojnë dhe janë në shërbimin tonë edhe në orët e vona të natës, edhe në ditët e

pushimit edhe në ditët e festave. Vjershat janë në formën e dialogut dhe fëmijët zgjidhen në çifte për të bërë recitim e tyre.

- **Biseda për kafshët e egra.** Kafshët e egra fëmijët i shohin në kopshtin zoologjik, në filma, në libra dhe në fotografji. Mësuesi/ja mund të improvizojë përshkrime të kafshëve të pyllit dhe në bazë të tyre të kërkojë nga fëmijët të gjejnë se për cilën prej tyre bëhet fjalë. Fëmijët mësojnë se në dimër kafshët i mban ngrrohtë gëzofit, se disa kafshë bien në gjumë të gjatë dhe zgjohen në pranverë si ariu, mësojnë për “shtëpitë e tyre” për guvat ose gropat e tunelet nën tokë, zgavrat në trungjet e pemës. Për këtë temë mund të krijohet një maket me pemë, pambuk dhe kafshë të krijuara me shabllone letre. Fëmijët mund t’i shohin kafshët e egra edhe në linkun e dhënë dhe të bëjnë kahasime ndërmjet tyre.
- **Biseda për veshjet e stinës.** Fëmijët mësojnë t’i emërhojnë si duhet veshjet, të mësojnë t’i mbërthejnë vetë veshjet me susta, kopsa të mëdha dhe zinxhira. Mësuesi/ja u kujton tregimin “**Të vishemi sipas stinës**” dhe mund t’u tregonjë fëmijëve pamje që tregonjë raste kur fëmijët janë veshur ose jo për një ditë të ftohtë dimri. Nëpërmjet bisedave fëmijët japid ide për grumbullimin e veshjeve dhe faljen te fëmijët që kanë nevojë. Gjithashtu me fëmijët bëhet një bisedë në lidhje me ndjenjat që përfjetojnë kur falin, kur dhurojnë, kur ndihmojnë, kur sillen mirë etj.
- **Përrallat.** Edhe gjatë këtij muaji janë zgjedhur përrallat që lidhen me secilën nga temat javore. Te secila përrallë fëmijët do të tregonjë si fillojnë ato, do të tregonjë përbajtjen sipas rrjedhës së ngjarjeve, do të nxjerrin mësime, do të analizojnë sjelljen dhe veprimet e personazheve, do të bëjnë pyetje për të mësuar informacione të reja, i interpretojnë në role ose në dramatizime të thjeshta. Mësuesi/ja u kërkon fëmijëve *të gjejnë tituj* të tjera për to, *të fantazojnë* e *të krijojnë histori* nëpërmjet figurave, *të gjejnë një fund tjetër*; mundet t’u bëjë pyetje dhe fëmijët të japid një përgjigje ashtu siç e mendojnë.

- **Tregimet.** “Miri, njeriu prej bore dhe Viti i Ri” dhe “Kapelat e Vtit të Ri” trajtojnë aspekte të marrëdhënieve dhe sjelljeve të fëmijëve me njëri-tjetrin. Fëmijët mësojnë të mendojnë edhe për shokët, të bëjnë dhurata e mesazhe që u falin gëzim të tjerëve, që të luajnë me të tjerët dhe të kënaqen për lojërat dhe aktivitetet që kryejnë së bashku, të zënë miqësi të reja, por të mos harrojnë “shokët e vjetër”. Duke u nisur nga mësimet që nxjerrin nga tregimet fëmijët mund të dalin jashtë, nëse është kohë e mirë, të luajnë në grupe, mund të përgatisin një kuti ku do të fusin mesazhe dashurie dhe urimi për fëmijët e tjerë. Mësuesi/ja duhet të ketë parasysh që kur të hapet kutia të gjithë fëmijët të marrin mesazhe, të bëjnë dhurata të thjeshta me materiale dhe mjete të riciklueshme, të shkruajnë një urim të shkurtër dhe të tregojnë për kënaqësitë që fituan për sjelljen e tyre.
- **Lojë në role.** Duke qenë se në muajin dhjetor mbizotëron gjithandej atmosfera festive, fëmijët mund të luajnë lojë në role në dyqan dhe të improvizojnë sikur janë duke blerë zbukurime për pemën e vitit të Ri, gjëra për të qerasur, mund të jenë në dyqanin e lodrave, në dyqanin e veshjeve etj. Fëmijëve u pëlqen të marrin dhurata, por mësojnë se duhet edhe të bëjnë dhurata të thjeshta me mundësitë që kanë. Është koha që të diskutohet edhe për kursimin dhe për gjetjen e mënyrave se si të realizojnë dëshirat për blerjet që duan të bëjnë.
- **Diskutime.** Fëmijëve u prezantohen raste dhe situata ku u kërkohet të dallojnë nëse kanë të bëjnë me një dëshirë apo një nevojë, a mund ta zëvendësojnë apo duhet ta sigurojnë patjetër; është momenti i duhur apo jo. Situatat me blerje dhe shpenzime deri në 10 euro mund të jenë një aktivitet praktik që lidhet me mbledhjet dhe me zbritjet dhe me parashikime nëse mund të bëjnë apo jo blerje me eurot që kanë në dispozicion.
- **Veprimitari praktike.** Krijimet me forma gjeometrike, koncepti për trupat gjeometrikë, dallimi i një figure nga trupi gjeometrik duhet të realizohet me mjete konkrete dhe me objekte që fëmijët i gjejnë në sklasë, në shtëpi apo në mjedisin përreth. Renditja e figurave në një varg, zbulimi i rregullit dhe krijimi i një vargu janë ushtrime të cilat

térheqin vëmendjen dhe përqendrimin e fëmijëve. Veprimtari praktike është shtrimi i tavolinës dhe vendosja e lugës, pirunit, gotës, pecetës, kripores në vendin e duhur.

- **Punë me letër e me karton.** Në librin e fëmijës jepet një kub i hapur, i cili mund të përdoret për disa qëllime: mundet që në faqet e tij të vendosen personazhet nga përrallat e mësuara, mund të lidhet me numrat, me shkronjat, me format, me pyetje të ndryshme, me lodra, me euro, mund të luajnë “**Mos u nxeh**” etj. Fëmijët zgjedhin sipas dëshirës qëllimin e përdorimit të kubit të tyre.
- **Biseda** për mënyrat tradicionale të festimit të Vtit të Ri, për zbukurimin e pemës së shtëpisë, të ushqimeve që përgatiten, të dhuratave, të veshjeve, të surprizave, të udhëtimeve, të takimit me kushërinjtë dhe të afërmit që jetojnë jashtë vendit, për pushimet e dimrit, për orarin ditor gjatë pushimeve dhe aktivitetet që kryejnë gjatë ditës. Pjesë e bisedave janë edhe emocionet që përjetojnë fëmijët, filmat e rinj që shfaqen në TV, koncertet dhe në përgjithësi atmosfera festive kudo që shkojnë.
- **Krijime artistike** me materiale dhe mjete të riciklueshme, skulptura me materiale të buta, kombinime të vizatimeve me mjete, përgatitja e zbukurimeve për klasën etj.
- **Këngët dhe dëgjimet muzikore.** Gjatë muajit dhjetor fëmijët do të mësojnë këngën tradicionale të Vtit të Ri. Ata do të dëgjojnë lloje të ndryshme muzikash dhe do të dallojnë se me cilën mund të kërcejnë, cilën ekanë dëgjaur në filmat vizatimore, cilit film i përket muzika që dëgjojnë, cilën këngë e dëgjojnë në gëzime familajre, cilën e kërcejnë me dëshirë, cilën e këndojnëpër ditëlindje, cilën këngë e dinë edhe prindërit e tyre etj. Nëpërmjet këngëve që dëgjojnë, fëmijët dallojnë edhe vetitë e tingujve: *gjatësinë, lartësinë, ngjyrën* dhe *forcën* e tij.

PËR NJË TRUP TË SHËNDETSHËM

ciu-ciu



Specifikat e punës në muajin janar

Rëndësia e të ushqyerit të shëndetshëm dhe kryerja e ushtrimeve fizike për një trup të fortë.

Janari është muaji i parë i viti. Fëmijët vijnë nga pushimet e dimrit dhe pas festimit të festës së Vtitit të Ri. Ata kanë marrë dhurata dhe mund t'i sjellin në klasë dhe t'ua tregojnë shokëve. Tema e muajit lidhet me njohjen e pjesëve të trupit të njeriut, me shqisat, me zgjedhjen e ushqimeve të shëndetshme dhe me rëndësinë e edukimit fizik.

Ndër temat javore të muajit janar janë:

- Unë jam vajzë, unë jam djalë. Të dy jemi fëmijë.
- Shqisat e njeriut
- Trupi ka nevojë për sport dhe ushqime të shëndetshme.

Në javën e parë të muajit flitet për **trupin e njeriut**, për pjesët e përbashkëta dhe të ndryshme që fëmijët vënë re te njëritjetri. Në këtë temë është e rëndësishme të diskutohet rreth barazisë gjinore ndërmjet djemve dhe vajzave, të shprehura në veshjet që veshin, në lodrat që luajnë, në punët që kryejnë, në lojërat që luajnë, në shoqëritë që zënë etj.

Në javën e dytë fëmijët njihen me **shqisat**, me rolin dhe funksionet e tyre, për kujdesin që duhet të tregojnë dhe me shmangien e lojërave dhe të mjeteve të rrezikshme.

Në javën e tretë fëmijët njihen me rëndësinë e **të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme**, me zhvillimin e lojërave në ajrin e pastër dhe me pjesëmarrjen në **veprimtari të ndryshme sportive**.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan pjesët kryesore të trupit të vet.
- Dallon ndryshimet që ndodhin gjatë rritjes ndërmjet vajzës dhe djalit.
- Sjell shembuj të përdorimit të lodrave të njëjta si nga djemtë edhe nga vajzat.
- Tregon se në familje ndihmojnë njësoj si vajzat edhe djemtë.
- Emërtion shqisat dhe përshkruan funksionin dhe rëndësinë e kujdesit për to.
- Nxjerr mësim nga vjershat që dëgjon dhe tregon se çfarë mund të bëjë ai në situatat që dëgjon.
- Shprehet për ushqimet që pëlqen të hajë. Mëson dhe tregon për ushqimet që duhet të hajë.
- Tregon për lojën që i pëlqen. Përshkruan lodrën e dashur.
- Vlerëson cilësitë pozitive që ka vetë dhe ato që i dallon të fëmijët e tjerë.
- Krijon një menu ditore dhe përshkruan ushqimet që konsumon në vakte të ndryshme ditore.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat K, L, LL.

Edukata figurative

Fëmija:

- Vizaton portretin e vet dhe të shokut ose shoqes së ngushtë.
- Krijon me materiale të riciklueshme trupin e njeriut.
- Përshkruan vizatimet që realizon.
- Zbukuron një menu sipas dëshirës.
- Shpreh një mesazh për shokun/ shoqen nëpërmjet një punimi.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dallon ngjyrën muzikore të disa prej instrumenteve muzikore përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën.
- Identifikon dhe dallon instrumentet edhe me pamje.
- Ndjek dhe krijon ritme me kërcitje gishtërinj dhe përplasje këmbësh.
- Dëgjon muzikë dhe shpik lëvizje ritmike.

Matematika

Fëmija:

- Renditet nga më i gjati te më i shkurtri dhe anasjelltas.
- Identifikon pozicionin e figurave dhe të objekteve në një rresht: i/e para...
- Pret figurat gjeometrike, i palos dhe dallon vijën e simetrisë.
- Numëron dhe gjen sa janë.
- Dallon një figurë nga një trup gjeometrik.
- Njihet me konceptin për numrin 6.
- Kryen mbledhje dhe zbritje me sende dhe objekte konkrete deri në 6.
- Shoqërimi njëpërnjë i objekteve të dy bashkësive.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Dallon pjesët kryesore të trupit të njeriut.
- Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut (strehim, ushqim, ujë, ajër dhe dritë)
- Dallon shqisat e njeriut.
- Realizon veprime duke përdorur shqisën e caktuar.
- Identifikon gjatë këndimit zërin më të lartë nga zëri më i ulët (integrim me muzikën)
- Dallon trupin më të shpejtë nga trupi më i ngadalshëm.

Shoqëria dhe mjedis

Fëmija:

- Dallon të përbashkëtat dhe ndryshimet me fëmijët e tjerë të klasës.
- Kryejnë veprime dhe shfaqin sjellje të duhura në shoqëri.
- Vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme.
- Identifikon shërbimet që i ofrohen në familje, lagje/ kopsht/shkollë, mjedisin rrëthues (kujdesin prindëror, shërbimet mjekësore dhe rekreative).

Edukata fizike

Fëmija:

- Zhvillon shkathtësi elementare gjatë lojës dhe respekton rregullat gjatë lojës.
- Demonstron shkathtësi gjatë kapjes dhe hedhjes së objekteve.
- Dallon sjelljet e duhura gjatë lojës dhe veprimtarive ku merr pjesë.
- Njeh dhe dallon rreziqet gjatë lojës.
- Njeh rëndësinë e shëndetit të shqisave dhe faktorët që ndikojnë në të.

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Dallon materialet sipas llojit (p.sh pambuk, dru, lëkurë, tekstil) i përdor ato për krijimet vetanake.
- Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës simbolike (gatuan ushqime, rregullon ambientin, përgatit tryezën etj.)

Projekti i muajit

Në muajin janar është parashikuar projekti “**Ushqimet**”. Ky projekt merr shkas nga prirjet që ka pjesa më e madhe e fëmijëve për të ngrënë ushqime të thata, të njëjta dhe nuk preferojnë ushqime të shëndetshme që gatuhen në shtëpi dhe që përmenden në piramidën e ushqimeve. Ndërmjet fëmijëve mund të bëhet një garë se cili fëmijë gjatë muajit ka ngrënë ushqime të shëndetshme, ose kanë kryer aktivitete fizike në natyrë, kanë zhvilluar lojëra në bashkëpunim, janë sjellë mirë me njërin-tjetrin, kanë ndihmuar fëmijë e njerëz në nevojë etj. Në përfundim të muajit fëmijët marrin një certifikatë për punën në grup ose për mirësjelljen në shoqëri.

Në ditët e para të muajit janar, mësuesi/ja nxjerr nga dosja e secilit fëmijë fletën “**Ja si ndihem unë**” dhe i pyet si ndihen pas 4 muajve që vijnë në shkollë/kopsht.

Planifikimi i temave për muajin janar “Për një trup të shëndetshëm”

	Java 1 Unë jam vajzë, unë jam djalë. Të dy jemi fëmijë	Java 2 Shqisat e njeriut	Java 3 Trupi ka nevojë për sport dhe ushqime të shëndetshme
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Ç’më pëlqen të bëj” (<i>Fq. 5</i>); Një vit i ri filloj... (<i>Fq. 6 - 7</i>) • Veshjet për djem, veshjet për vajza dhe veshjet për të dyja gjinitë. (<i>Fq. 14</i>); Vjersha “Kopsa e Gimit” (<i>Fq. 15</i>) • Punët s’janë të ndara. Po ashtu edhe lojërat; Vjersha “Topi dhe kukulla” (<i>Fq. 18 - 19</i>) • Tregimi “Kukulla me makinë të kuqe” (<i>Fq. 22 - 23</i>) • Shkronja K (<i>Fq. 16 - 17</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shqisat tona (<i>Fq. 26</i>) • Me sy shikoj; Me veshë dëgjoj; Me hundë nuhas; Me gjuhë shijoj; Me dorë dhe këmbë prek (<i>Fq. 27</i>) • Lojërat didaktike për përdorimin e shqisave të ndryshme “Njihe shokun nga zëri”, “Njihe shoqen nga prekja” etj. • Vjersha “Çdonjëri prej nesh është i bukur”; Gjuha e shenjave (<i>Fq. 28</i>) • Shkronja L (<i>Fq. 32 - 33</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Si u bë Pati sportiste”; Sporti që më pëlqen të merrem (<i>Fq. 34 - 35</i>) • Me këmbëngulje arrihet gjithçka; Fabula “Lepuri dhe breshka” (<i>Fq. 36 - 37</i>) • Ushqime të shëndetshme; Tregimi “Majmuni që hante vetëm banane” (<i>Fq. 44 - 45</i>) • Vjersha “Genci mësoi të hajë vetë” (<i>Fq. 46</i>) • Shkronja LL (<i>Fq. 48 - 49</i>)
Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> • Dora dhe këmba ime (<i>Fq. 10</i>) • Punimi i trupit me materiale të riciklueshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Krijime me form gjeometrike (<i>Fq. 52 - 53</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • “Një tryezë e shtruar bukur” - (<i>Fq. 47</i>)

Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Dëgjoj muzikë dhe shpik lëvizje ritmike Kënga "Hapa-dollapa" <p>https://www.youtube.com/watch?v=gybq2kUFGqo</p>	<ul style="list-style-type: none"> Ndjekja dhe krijimi i ritmeve me kërcitje gishtërinj dhe përplasje këmbësh. 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga "Merri vitaminat" <p>https://www.youtube.com/watch?v=HTrG0pQ7jUo</p>
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Numri rreshtar deri në 5 (<i>Fq. 12 - 13</i>) Roboti me trupa gjemometrikë (<i>Fq. 20</i>) Hedhja e të dhënave në tabelë Mbledhje e zbritje deri në 5 (<i>Fq. 24 - 25</i>) Grupimi, klasifikimi dhe veçimi 	<ul style="list-style-type: none"> Gjej çfarë kemi 1, 2, 3, 4, 5 pjesë në trupin tonë Numri 6 (<i>Fq. 30 - 31</i>) Mbledhje deri në 6 (<i>Fq. 50</i>) Të kundërtat (<i>Fq. 51</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Pozicionet dhe vendodhjet Orientimi në hapësirë Lëvizje sipas drejtimit të shigjetave Zbritje deri në 6
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> Pjesët kryesore të trupit të njeriut. Ndryshimet e djalit dhe të vajzës gjatë rritjes 	<ul style="list-style-type: none"> Shqisat e njeriut 	<ul style="list-style-type: none"> Trupi më i shpejtë dhe trupi më i ngadalta (<i>Fq. 42 - 43</i>)
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimet dhe të përbashkëtat që gjej me shokët e mi; Unë jam fëmijë si gjithë të tjerët; Aftësitë e mia të veçanta (<i>Fq. 11</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmojmë shokët që kanë nevojë për ndihmë (<i>Fq. 29</i>). Nuk shajmë dhe nuk ofendojmë njëri-tjetrin 	<ul style="list-style-type: none"> Ushqime të shëndetshme; Vjersha "Perimet më bëjnë më të fortë" (<i>Fq. 40 - 41</i>) Shërbimi shëndetësor; Lojë në role "Te doktori"

Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Lojë lëvizore “Gjilpëra, peri, nyja” • Garë “Kush e kap i pari shaminë” 	<ul style="list-style-type: none"> • Lojë “Hapa-dollapa” • Loja “Dembeli mbeti pa shtëpi” 	<ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi për shqisat. • Simptomat e para të dhimbjeve/ sëmundjeve. • Rëndësia e përdorimit të barnave
Shkathëtësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> • Unë di të bëj njësoj si ty. • Kukulla në gisht. Përgatisim pupeta për përrallat tona 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjëra prej pambuku, lëkure, druri dhe metali 	<ul style="list-style-type: none"> • Si ta përgatisim një vakt vetë (<i>Fq. 45</i>) • Kujdesi me pajisjet e gatimit.
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> • My body parts • Draw the outline of the body shape and colour it 	<ul style="list-style-type: none"> • My face. Number 6 	<ul style="list-style-type: none"> • I love bananas
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> • Një libër i gjithi për vajzat • Një libër i gjithi për djem 	<ul style="list-style-type: none"> • Pema me “Ndjenjat dhe emocionet” 	<ul style="list-style-type: none"> • Një kupë për fituesin (<i>Fq. 38 - 39</i>)

Veprimtaritë mësimore për muajin janar

- **Bisedë për mbresat nga Viti i Ri.** Fëmijët gjatë javës që apo janë kthyer nga pushimet mund të sjellin me vete dhuratat që kanë marrë, por u kërkohet të përshkruajnë mbresat që u ka lënë e gjithë atmosfera festive. Meqë viti i ri apo filloi, fëmijët pyesin njëri-tjetrin dhe plotësojnë kalendarin e ditëlindjeve të shokëve dhe shoqeve të klasës. Kjo veprimtari lidhet edhe me matematikën, për renditjen e muajve dhe të stinëve të vitit, për të krahasuar muajt lidhur me numrin e ditëlindjeve që festohen në secilin prej tyre, lidhen me konceptet i madh/ i vogël, lidhet me veprimtarinë gjuhësore të shkrimit të emrave të fëmijëve të tjerë të klasës.
- **Veprimtari praktike.** Mësuesi/ja mund të kërkojë që para klasës të dalin dy fëmijë, një djale dhe një vajzë. Fëmijët i shohin dhe gjejnë të përbashkëtat që kanë dy fëmijët, siç janë pjesët e fytyrës, gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme, pjesët e dukshme të trupit. Më pas fëmijët dallojnë ndryshimet ndërmjet një vajze dhe një djali. Fëmijët do të kuptojnë se të përbashkëtat dhe ndryshimet vihen re edhe ndërmjet fëmijëve të së njëjtës gjinie. Një aktivitet i veçantë mund të ishte vizatimi i trupit të një fëmije në një tabak të madh letre. Një fëmijë shtrihet dhe vizatohet nga fëmijët e tjerë. Te ai trup vendosen pastaj pjesët e jashtme dhe organet e brendshme kryesore të trupit të njeriut. Në librin e punës së fëmijës janë vendosur dy silhueta të njëjta, por me vizatimet që do të bëhen fëmijët do të dallojnë djalin nga vajza. Vizatimet fëmijët i bëjnë pasi dëgjojnë kérkesat nga mësuesi/ja. Në fletën tjeter të punës fëmijët vizatojnë dorën dhe këmbën e tyre dhe më pas bëjnë krahasime me duart dhe këmbët e fëmijëve të tjerë.
- **Bisedë për diversitetin.** Kjo temë bisede ka lidhje me diversitetin. Fëmijët duhet të kuptojnë se secili prej tyre është unik, që ngjajnë me njëri-tjetrin në shumë parametra, por njëkohësisht secili prej tyre paraqitet si individualitet i papërsëritshëm. Diversiteti paraqitet përshkak të: gjinisë, kuptimi për veten si djale/vajze, për shkak të konteksit socio-kulturor prej nga vijnë dhe ku zhvillohen fëmijët, për shkak të statusit socio-ekonomik ku fëmijët rriten dhe

zhvillohen, pér shkak tē racës, besimit dhe gjithë konteksit socio-kulturor ku fëmijët përmbushin fëmijërine e tyre. Në këtë kontekst fëmijët kuptojnë se tē jesh ndryshe nuk përbën asnjë problem. Mund tē kujtojnë këtu përrallën "Kotelja e zezë që donte tē ishte e gjitha e bardhë". Në këtë kontekst shërben fleta e punës "**Unë kam aftësi tē vecanta**". Fëmijët shohin figurat dhe dallojnë veprimet që kryejnë fëmijët që paraqiten aty. Pastaj fëmijët që duan tregojnë se çfarë mund tē bëjnë ata njësoj apo ndryshe apo njësoj si shokët e tjerë. Në këtë kontekst fëmijët mësojnë si tē ndihmojë fëmijët që paraqesin vështirësi apo aftësi tē ndryshme fizike.

- **Pyetje-përgjigje.** Kush i thotë këto fjalë? Mësuesi/ja lexon vjershëm "**Kam një kukull, kam një top**" dhe kërkon nga fëmijët tē gjejnë se pér kë bëhet fjalë: pér një vajzë apo pér një djalë. Fëmijët argumentojnë thjesht mendimet që paraqesin. Në tē njëjtën linjë janë edhe veprimtaritë pér veshjet ndërmjet fëmijëve, pér ushqimet që pëlqejnë dhe pér punët dhe ndihmën që japid në familje. Mësuesi/ja mund tē kërkojë nga fëmijët tē ndahanen në dy grupe veç vajzat dhe veç djemtë dhe tē krijojnë një libër "I gjithi pér vajza" dhe "I gjithi pér djem". Secili grup paraqet vizatimet dhe mendimet. Ndërmjet tyre mësuesi/ja kërkon tē evidentohen më pas tē përbashkëtat ndërmjet dy grupeve. Këtij qëllimi i shërben edhe tregimi "**Kukulla me makinë tē kuqe**". Fëmijët kuptojnë se lodrat nuk janë tē ndara pér djem apo pér vajza. Çdo fëmijë ka tē drejtë tē luajë me lodrat që i pëlqen tē luajë. Nëpërmjet këtij tregimi fëmijët nxjerrin në dukje rëndësinë e mirëmbajtjes dhe tē kujdesit tē lodrave.
- **Lojë në role** pér luftimin e stereotipeve gjinore, tē cila kanë tē bejnë me rolet sociale mashkulllore/femërore, tē "ngurtësuara" tē cilat ndryshojnë me shumë vështirësi dhe kérkojnë kohë shumë tē gjatë.
- **Lojërat didaktike pér përdorimin e shqisave.** Fëmijëve mund t'u mbyllen sytë me një shall dhe tē kérkohet tē gjejnë shokët që flasin, shokët që këndojnë, ose tē dallojnë nëpërmjet prekjes në trup, apo tē dallojnë fruta dhe objekte tē tjera nga prekja duke treguar edhe cilësitë që vënë re, mund tē dallojnë shijet e ushqimeve, tē frutave dhe tē lëngjeve që pijnë. Më tej mësuesi/ja zhvillon edhe biseda pér kujdesin ndaj shqisave, përdorimin me masë tē pastruesve tē

veshëve, të larjes së syve, të pastrimit të hundëve, të shmangies së mjeteve të rrezikshme, të respektimit të rregullave të lojës etj. Pasi dëgjojnë vjershën “Ç’më pëlqen të bëj”, fëmijët vetë tregojnë se çfarë u pëlqen të bëjnë me shqisat që kanë.

- **Biseda për ushqimet** që hanë fëmijët. Fëmijët duhet të tregojnë për ushqimet që u pëlqejnë dhe i hanë dhe për ushqimet që duhet të hanë edhe pse nuk i pëlqejnë. Edhe shumëlojshmëria e ushqimeve është e rëndësishme për t'u theksuar. Gjithashtu fëmijët mësojnë se trupi i tyre ka nevojë për konsumimin e ushqimeve të ndryshme dhe për marrjen e vitaminave që janë të rëndësishme për shëndetin. Për këtë arsyе është zgjedhur vjersha që gjendet në Youtube “**Perimet më bëjnë më të fortë**”. Po këtij qëllimi i shërben edhe përralla “**Majmuni që hante vetëm banane**”. Fëmijët shohin figurat, tregojnë çfarë kuptojnë, krijojnë një histori dhe në fund parashikojnë mbylljen e saj. Nga kjo veprimtari fëmijët presin figurat dhe plotësojnë piramidën e ushqimeve.
- **Vjersha humoristike** “**Genci mësoi të hajë vetë**” u shërben për të kuptuar gabimet që bënte Genci tek hante ushqim. Shtrimi i tavolinës, vendosja e *pjatës, lugës, pirunit, gotës, pecetës* dhe *kriporesh* janë veprimtari praktike që fëmijët e realizojnë konkretisht në klasë. Po ashtu fëmijët mund të përgatisin një menu për ushqimet e shëndetshme që do të konsumojnë në shtëpi.
- Nga bisedat për **lojërat që luajnë fëmijët**, për lodrat që u pëlqejnë, për llojet e lojërave individuale, në grup, në skuadër etj, fëmijët mësojnë për rëndësinë që ka aktiviteti fizik në të gjitha fushat e zhvillimit tyre. Nëpërmjet vjershës “**Si u bë Pati sportiste**” apo fabulës së njohur “**Lepuri dhe breshka**”, fëmijët flasin rreth lojërave lëvizore, parasporive dhe veprimtarive të ndrsyhme sportive. Pas punimit të përrallës fëmijët mund të bëjnë gara veprimi për të shpallur fituesin dhe më të shkathtin e klasës. Për tri vendet e apra mund të improvizohen kupa të realizuar me materiale të riciklueshme. Gjithashtu, në fletën e punës fëmijët dallojnë trupin që lëviz më shpejt nga trupi që lëviz më ngadalë.

- **Veprimtaritë praktike, situatat problemore**, orientimet në hapësira, plotësimi i fletëve të punës janë të rëndësishme për mësimin e koncepteve të matematikës. Siç e kemi përmendur edhe më parë, metodologja që zgjedh mësuesi/ja për mësimin e tyre është e njëjtë. Si mbledhja dhe zbritja mësohen nëpërmjet veprimeve konkrete, nëpërmjet situatave, por edhe duke u lënë kohën e duhur fëmijëve për t'u menduar dhe për t'i zgjidhur. Numërimet me gisht, shoqërimet një për një, plotësimi i bashkësive me aq elemente sa u kërkohen lëvizjet dhe kombinimet e tyre sipas drejtimeve janë veprimtritë kryesore që do të zhvillohen në muajin janar. Sipas fantazisë, fëmijët do të kombinojnë format gjeometrike për të krijuar një robot të ri.
- **Lojërat lëvizore “Gjilpëra, peri, nyja”, “Hapa-dollapa”, “Dembeli mbeti pa shtëpi”** (Kush e zë i pari karrigen) dhe gara “**Kush e kap i pari shaminë**” i shërbjenë zhvillimit të motorikës së madhe.
- **Mësimi ishkronjave K, L dhe LI.** Gjatë muajit janar fëmijët do të mësojnë shkronjat me të njëjtën procedurë siç është thënë edhe në shkronjat e mëparshme.

SA TË DUA
KOSOVA IME!



Specifikat e punës në muajin Shkurt

Krenaria për Atdheun dhe vlerësimi i arritjeve në 100 ditët e kaluara së bashku me njëri-tjetrin.

Në muajin shkurt Kosova feston Ditën e Pavarësisë. Veprimtaritë kryesore të muajit i kushtohen atdheut, njohjes së simboleve kombëtare, krenarisë kombëtare, punimit të flamurit, mësimit të vjershave dhe vizitave në vende historike, në muze etj. Gjithashtu, fëmijët festojnë edhe 100 ditët e qëndrimit së bashku në shkollë. E me këtë rast ata do të organizojnë veprimtari të ndryshme promovuese duke u krenuar për arritjet e deritanishme.

Për muajin shkurt janë parashikuar këto tema javore:

- 100 ditë së bashku,
- Jam krenar për vendin tim,
- Vendet e bukurat të vendit tim,
- Qyteti, lagjja ku jetojmë.

Java e parë e muajit shkurt² shkon për organizimin e veprimtarive promovuese në kuadrin e 100 ditëve që fëmijët kanë ardhur në shkollë dhe qëndrojnë së bashku. Gjatë kësaj jave mësuesi/ja së bashku me fëmijët kujtojnë përrallat, vjershat dhe tregimet e mësuara deri në muajin janar, rikujtojnë konceptet matematike, veprimtaritë kryesore, festat, ditëlindjet, shëtitjet, veprimtaritë argëtuese, lojërat e zhvilluara në klasë dhe jashtë saj. Çdo fëmije ndan me të tjerët momentet më të bukura të kaluara së bashku.

² Në varësi të fillimit të vitit shkollor dhe të periudhave të pushimit mësuesi/ja përllogarit kohën e saktë kur mbushen 100 ditët e jetës së përbashkët me fëmijët. Në këtë varësi zhvendos edhe temat javore.

Në javën e dytë, fëmijët mësojnë më shumë për atdheun dhe ndihen krenarë për të. Vjershat e dhëna përgjatë muajit e përforcojnë ndjenjën e krenarisë kombëtare.

Në javën e tretë fëmijët njihen me bukuritë natyrore të Kosovës, me vendet që mund të vizitohen, me pjesët e reliefit duke I pasqyruar me vizatime dhe fotografi.

Në javën e katërt fëmijën mësojnë më shumë për qytetin/ fshatin ku jetojnë, për shërbimet që ofrohen në lagje dhe për kujdesin që duhet treguar për ta mbajtur pastër mjedisin ku jetojnë.

Rezultatet e të nxënshit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënshit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënshit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Reciton vjershat për atdheun.
- Tregon për vjershën që i pëlqen më shumë dhe jep arsyen pse.
- Përshkruan ngjarjet më të bucura që ka përjetuar në shkollë
- Shfaq dashuri për dhe respekt për shokët dhe mësuesin/en.
- Tregon dhe shprehet si ndihet në shkollë.
- Flet për shërbimet që ofrohen në lagje.
- Luan në role situata ngajeta e përditshme.
- Përcjell mesazhe miqësie te fëmijët e tjera të shkollës.
- Tregon për aktivitetet dhe punët kryesore që bëjnë njerëzit në qytetin/fshatin ku jetojnë.
- Analizon veprimet e personazheve dhe jep këshilla për ta.
- Përshkruan emocionet që përjeton në ngjarje e ditë të caktuara.
- Interpreton një rol duke luajtur me pupeta.

- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat M, N, NJ, O, P.
- Lexon dhe shkruan fjalë që lidhen me shkronjat e mësuara.

Edukata figurative

Fëmija:

- Zgjedh një punim për në ekspositë dhe tregon pse i pëlqen.
- Gjen elemente që i vlerëson në mënyrë të veçantë te punimet e fëmijëve të tjera.
- Realizon me mozaik, ngjyrosje, aplikacion apo me fije Flamurin e Kosovës.
- Punon elemente të veshjes popullore që përdoren në zonën ku jeton.
- Mëson për jetën artistike të qytetit dhe për artistë të njojur të Kosovës, por jo vetëm.
- Dallon veprimtaritë që organizohen në një ekspositë, galeri, muze, vend arkeologjik etj.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dëgjon Himnin e Kosovës dhe e përcjell nëpërmjet një vizatimi.
- Identifikon grupe dhe figura markante nga fusha e muzikës.
- Tregon për këngën që i pëlqen më shumë.
- Mëson për studiot muzikore, këngëtarët dhe instrumentistët e njojur të Kosovës.

Matematika

Fëmija:

- Lëviz në drejtime të caktuara duke u orientuar nga fjalët: para, prapa, drejt, majtas, djathtas;
- Lexon orët e plota;
- Lexon numrat prej 1-7;
- Grupon me dy mënyra që të krijohet numri 7;
- Rendit ditët e javës;
- Radhit objekte sipas ngjyrës, formës dhe madhësisë;
- Formon modele sipas veticë të objekteve;
- Përdor shprehje: dje, sot, nesër për të treguar ngjarje.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Tregon rrjedhën kohore të ngjarjeve ndaj së djeshmes, të sotmes, të nesërmes
- Emërtón pjesë të reliefit të mjedisit ku jeton.
- Përshkruan botën e tyre bimore dhe shtazore.
- Përshkruan klimën në qytetin ku jeton

Shoqëria dhe mjedis

Fëmija:

- Përshkruan emocionet e veta për dhe në situata të ndryshme jetësore.
- Merr pjesë në organizime të ndryshme familjare dhe shoqërore dhe përshkruan në forma të ndryshme ngjarjet dhe përjetimet e tij.
- Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse vendin ku jeton
- Emërtón disa nga festat familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e vet përshkruan organizimin dhe manifestimin e tyre.
- Zbaton rregullat për veprimtari të caktuara në situata të ndryshme jetësore.

Edukata fizike

Fëmija:

- Kupton rëndësinë e përdorimit të barnave për shëndetin e njeriut.
- Njeh dhe respekton udhëzimet për përdorimin e mjeteve dhe të pajisjeve të ndryshme.
- Merr pjesë në lojëra elementare dhe demonstron shkathtësi gjatë zhvillimit të tyre.
- Shfaq ndjenja dhe emocione pozitive ndaj sportistëve të talentuar.

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Tregon për veprimtaritë që bën në shkollë
- Tregon ç’di të bëjë dhe çfarë do të bëjë.
- Përgatit një orë mësimore me materiale të riciklueshme

Projekti i muajit

Në muajin shkurt është parashikuar të bëhet një **projekt për Atdheun** duke nxjerrë në dukje vlerat më të mira dhe gjërat për të cilat krenohet çdo fëmijë i Kosovës. Projekti mund të integrohet edhe me festimin e 100 ditëve që fëmijët luajnë dhe mësojnë së bashku duke organizuar një aktivitet të përbashkët.

Pas përfundimit të shkronjës M, fëmijët mund të zhvillojnë aktivitetin “**Luaj me shkronja nga I-M**” me kartelat përkatëse.

Planifikimi i temave për muajin shkurt “Sa të dua Kosova ime!”

	Java 1 100 ditë së bashku	Java 2 Jam krenar për vendin tim	Java 3 Vendet e bukurat e vendit tim	Java 4 Qyteti/ lagjja ku jetojmë
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> • Vjershat dhe përrallat që kemi mësuar deri tani. • Falim dashuri dhe mesazhe miqësie për shokët e klasës • Vjersha “Shoku im” (<i>Fq. 57</i>) • Gjej të bukurën te punimi/ veprimi/ sjellja e shokut/ shoqes • Shkronja M (<i>Fq. 60 - 61</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Festa e Pavarësisë” (<i>Fq. 55</i>) • Njerëzit për të cilët krenohemi • Vjersha “Kosova – Atdheu im” (<i>Fq. 64</i>) • Prishtina, kryeqyteti i Kosovës; • Simbolet Kombëtare; • Shkronja N (<i>Fq. 66 - 67</i>) • Shkronja Nj (<i>Fq. 72 - 73</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Si ruhet Atdheu?” (<i>Fq. 68</i>) • Çdo popull ka historinë e tij • Vjersha “Miku Oksigjen” (<i>Fq. 74</i>) • Bukuritë e natyrës së Kosovës (<i>Fq. 75</i>) • Vendet historike dhe monumentet e kulturës • Shkronja O (<i>Fq. 80 - 81</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjersha “Në teatrin e kukullave” (<i>Fq. 76 - 77</i>) • Si të vlerësojmë një shfagje • Tregimi “Shkarravitësit” (<i>Fq. 82 - 83</i>) • Shërbimet që na ofron qyteti (<i>Fq. 86 - 87</i>) • Tregimi “Qyteti më i ri në botë” (<i>Fq. 90 - 91</i>) Shkronja P (<i>Fq. 88 - 89</i>)

Edukati ^e figurative	<ul style="list-style-type: none"> • 100 punime për në ekspozitë • Mozaik "Flamuri dhe Harta e Kosovës" (Fq. 65) 	<ul style="list-style-type: none"> • Kostumi popullor. Punimi me tekstile, fije dhe aksesorë i elementeve të tij 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeta artistike e qytetit. Artistë të njohur në Kosovë. Imitim i veprave artistike
Edukati ^e muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Këngët që kemi mësuar deri tani • Tinguj që dëgjoj në natyrë (Fq. 63) 	<ul style="list-style-type: none"> • Himni i Kosovës. • Këngë dhe këngëtarë të njohur nga Kosova 	<ul style="list-style-type: none"> • Studiot muzikore në qytetin tonë. • Këngëtarë dhe instrumentistë të njohur.
Matem atikë	<ul style="list-style-type: none"> • Numri 7 (Fq. 58 - 59) • Renditja e ditëve të javës • Sa është ora? (Fq. 62) • Numri rreshtor deri në 7 (Fq. 78) 	<ul style="list-style-type: none"> • Konceptet majtas-djathtas (Fq. 70) • Mbledhje deri në 7 (Fq. 79) • Peshimi i trupave me njësi jo standarde • Grupim në dy mënyra për të krijuar numrin 7 	<ul style="list-style-type: none"> • Dje, sot, nesër • Koncepti "Më i rëndë - më i lehtë" (Fq. 71) • Numëro dhe gjiej sa janë • Zbulon rregullin, vazhdon vargun
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> • Renditja e ngjarjeve sipas rrjedhës kohore 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i materialeve të ndryshme në jetën e përditshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Relievi i Kosovës: Malet, fushat, lumenjtë etj.

Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> Përjetimi i emocioneve në ngjarje dhe raste të caktuara. Menaxhimi i tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> Do t'i shërbej Atdheut tim. Detyrat dhe përgjegjësitë qytetare (<i>Fq. 69</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Të drejtat e fëmijëve (<i>Fq. 84</i>) Dëshirat dhe nevojat (<i>Fq. 85</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Rregullat e mirësjelljes në mjediset publike; Festat lokale; Traditat fetare, shoqërore, etnike, kulturore
Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Lojë me stafeta Në poligon 	<ul style="list-style-type: none"> Ushtrime në terren në lartësi; Lojëra popullore 	<ul style="list-style-type: none"> Sportistët e Kosovës që shkëlqejnë 	<ul style="list-style-type: none"> Lojëra popullore Lojëra ritmike me dhe pa mjete
Shkathësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Me duar të arta 	<ul style="list-style-type: none"> Gatimet tradicione 	<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e orës mësimore me mjete të riciklueshme 	<ul style="list-style-type: none"> Lojë në role "Në dyqan", "Në rrugë", "Në supermarket", "Në teatër", "Në park", "në qendër argëtimi" etj.
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> My friends; 	<ul style="list-style-type: none"> Number 7 	<ul style="list-style-type: none"> Free times activities 	<ul style="list-style-type: none"> Sports. Draw and colour the favourite sport or activity
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Vizitë në një ekspozitë/ panair 	<ul style="list-style-type: none"> Në muze; Në varrezat e dëshmorëve 	<ul style="list-style-type: none"> Sende të vjetra që kemi në shtëpi 	<ul style="list-style-type: none"> Një plan i ri për qytetin tonë. Një ditë politikan

Veprimtari mësimore për muajin shkurt

- **Veprimtari praktike.** Në javën e parë të shkurtit të gjitha aktivitetet do të kenë lidhje me rikujtimin e përrallave, të vjershavë, të historive dhe të ngjarjeve më të rëndësishme që kanë ndodhur që nga fillimi i viti shkollor. Qëllimi i bisedave me fëmijët është që ata të nxiten dhe të shprehen në lidhje me gjithçka që u pëlqen të bëjnë në shkollë, për vjershat dhe përrallat, për personazhet, për lojërat, aktivitet, punët në grup dhe çdo gjë tjeter që i bën të ndihen mirë në shkollë. Fëmijët tregojnë për shokët më të mirë që kanë, shpërndajnë mesazhe dashurie dhe miqësie. Vjersha “**Shoku im/ Shoqja ime**” i nxit fëmijët të flasin dhe të përshkruajnë se përse dhe çfarë pëlqejnë te shoku apo shoqja e tyre e ngushtë.
- **Biseda** për aktivitetet që mund të krijohen me rastin e 100 ditëve. Fëmijët edhe pse të vegjël mund të japid ide nëse duan të bëjnë një shfaqje, duan të bëjnë një ekspozitë, duan të bëjnë një veprimtari në antyrë, nëse secili do të pëgatisë diçka të veçantë të cilën e prezanton në ditën e festës. Në vëmendje të mësuesi/jat është që secili fëmijë të prezantohet me aktivitetin më të mirë që mund të bëjë.
- Në dy javët e tjera veprimtaritë kryesore lidhen me atdheun me vjershat, figurat, simbolet kombëtare, dëshmorët e Kosovës. Gjatë muajit shkurt mësuesi/ja mund të organizojë shëtitje dhe ekskursione me fëmijët për të vizitur vende të bukurat e Kosovës, mund të vizitojnë kryeqytetin ose në vende të tjera që kanë vlera të veçanta për fëmijët. Fëmijët tregojnë dhe shprehen për përfjetimin e emocioneve në ngjarje dhe raste të caktuara.
- **Vjershat** “**Festa e Pavarësisë**”, “**Kosova-Atdheu im**” kanë për qëllim të zgjojnë te fëmijët ndjenjën e atdhedashurisë dhe të krenarisë kombëtare. Fëmijët dëgjojnë Himnin e Kosovës dhe përpilen ta shoqërojnë me goditje ritmike. Më tej ata ngjyrosin Flamurin e Kosovës, të cilin mund ta realizojnë me teknika të ndryshme.

Nëpërmjet vjershës “**Si ruhet Atdheu**” fëmijët tregojnë dhe mësojnë për përgjegjësitë qytetare për të ruajtur dhe pasuruar pasuritë kombëtare, për të mbajtur pastër mjedisin ku jetojnë dhe për të kryer aktivitete për të cilat krenohen.

- **Mësim praktik** për leximin e orëve të plota. Fëmijët e vegjël paraqësin vështirësi në leximin e orës. Mësim i i saj mund të bëhet me veprimitari praktike ku fëmijët e ndërtojnë orën, dallojnë akrepin e vogël dhe të madh të saj dhe fillojnë të mësojnë orët e plota. Me fëmijët mund të bëhen gara se kush gabon më pak ose aspak në gjetjene orëve që paraqet mësuesi/ja. Fëmijët vizatojnë orën kur shkojnë në shkollë, kur kthehen dhe kur flenë në darkë. Ora mund të ndërtohet me ndihmën e prindërve me amteriale të riciklueshme.
- Në mjedisin përreth fëmijët dëgjojnë tinguj të prodhuar nga burime të ndryshme. Fëmijët i dallojnë dhe i imitojnë. Ata tregojnë tingujt që u pëlqejnë ose jo, që janë të fortë apo të butë, të shkurtër apo të gjatë etj. Vjersha “**Miku Oksigjen**” lidhet me rëndësinë e mbrojtjes së mjediseve antyrore e në mënyrë të veçantë të pyjeve. Fotografitë e përzgjedhura për të treguar mjediset fizike i nxit fëmijët për të mësuar më shumë për vendin e tyre.
- **Shëtitje nëpër qytet**, lagje apo në një zonë të afërt banimi. Fëmijët njihen me qytetin/ fshatin ku jetojnë, me shërbimet që ofrohen në komunitet, me gjërat, ndërtesat dhe dyqane të tjera që fëmijët do të donin të kishte në lagjen e tyre. Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të vlerësojnë atë që kanë dhe të shprehin dëshira për atë që do të donin të ishte apo të kishte në lagjen e tyre. Fëmijët mund të bëjnë krahasime me qytete e fshatra të tjera që kanë vizituar. Vëzhgimet e fëmijëve do të orientohen edhe në kujdsin e tyre për mjedisin ku jetojnë. Fëmijët mësojnë për të drejtat e tyre. Por krahas të drejtave fëmijët kanë edhe përgjegjësi për ta mbajtur pastër qytetin/ fshatin dhe për t'u kujdesur për të. Pasi dëgjojnë tregimin “**Shkarravitësit**” fëmijët dënojnë sjelljen e gabuar të personazhit, japin këshilla për personazhet që nxitohen dhe duan të bien në të njëjtat gabime, vlerësojnë nismën e fëmijëve të tjera për të bërë një aksion për pastrimin e mjedisit dhe tregojnë si do të kishin vepruar ata në raste të ngjashme. Nisur nga

ky tregim fëmijët mund të sjellin raste të ngjashme që kanë ndodhur në lagjen e tyre. Fëmijët tregojnë dhe diferencojnë aktivitete që edhe ata mund t'i kryejnë për të mbajtur pastër mjedisin si: mbledhja e shisheve plastike, mbjellja e pemëve, ecja me bicikleta, grumbullimi i gjetheve në stinën vjeshtës etj.

- **Në shfaqje.** Çdo qytet ka një jetë artistike, ka vende argëtimi, parqe, kënde lojërash të cilat frekuentohen nga fëmijët. Vjersha “**Në teatrin e kukullave**” nxit fëmijët të flasin për filmat që shohin në TV, nëse kanë marrë pjesë në n jë shfaqje me kukulla dhe të marrin një vendim për përrallën që mudntë dramatizojnë me veshje, me maska me pupeta, me kukulla në gisht etj. Fëmijët tregojnë se çfarë u pëlqen të shohin e të dëgjojnë. Në kuadrin e 100 ditëve fëmijët mund të organizojnë një dramatizim për një përrallë që u pëlqen.
- **Në lagje** ka edhe njerëz që u shërbejnë qytetarëve siç janë mjekët, policët, zjarrfikësit, mjetet e shërbimit publik, taksitë të cilët gjenden pranë qytetrëve sa herë që ata kanë nevojë. Fëmijët mund të improvizojnë lojë në role “Në dyqan”, “Në rrugë”, “Në supermarket”, “Në teatër”, “Në park”, “Në qendrën e argëtimit” etj. Pas çdo aktiviteti që kryejnë fëmijët tregojnë për kënaqësinë që fituan apo për gjërat që mësuan. Gjithashtu fëmijët mësojnë për rregullat e mirësjelljes në mjediset publike, për festat lokale, traditat fetare, shoqërore, etnike dhe kulturore të zonës, por jo vetëm.
- **Maketi i një qyteti.** Duke u mbështetur në historinë që dëgjojnë, fëmijët ndëtojnë sipas fantazisë një qytet me objekte me trupa gjeometrikë, si sfera, kuba, kuboida, kone, cilindra etj. Ndërtesat, dyqanet, pemët, njerëzit dhe gjithçka që krijojnë i vendosin në maketin me titull “**Qyteti më i ri në botë**”.



NË QYTET APO
NË FSHAT?

Specifikat e punës në muajin Mars

Dashuria për nënën dhe mësuesin/en. Dallimet ndëmjet qytetit dhe fshatit. Njohja me profesionet dhe vlerësimi i njerëzve të punës.

Në fokus të muajit mars janë festat e 7-8 marsit, dy festa këto të dashura përfshinë fëmijët. Gjithashtu, në këtë muaj do të flitet për qytetin dhe përfshatin, përfshinë dallimet ndërmjet tyre, përfshinë mundësitë që ofrojnë, përfshinë profesionet e njerëzve, përfshinë buta, përfshinë prodhimet që marrim prej tyre etj.

Për realizimin e veprimtarive janë parashikuar vizita pranë një ferme, ekskursione në qytete ose në kryeqytet dhe vizita në institucione, biznese dhe punishte të ndryshme përfshinë njohur më nga afër me njërit që punojnë aty.

Si temat javore përfshinë këtë muaj janë parashikuar:

- Zemra jonë e vogël kërcen nga gjëzimi
- Qyteti dhe profesionet më të përhapura
- Duarartët zanatçinj
- Të mirat që na ofron fshati dhe qyteti

Java e parë e muajit i kushtohet mësimit të vjershave dhe të këngëve përfshinë mësuesin/en, nënën dhe gjyshen, me qëllim që fëmija të shfaqë dashurinë, respektin dhe mirënjojen e vet. Fëmijët do të gjejnë mënyra origjinale përfshinë uruar mësuesin/en dhe nënën nëpërmjet fjalëve, gjesteve, kartolinave dhe dhuratave simbolike të përgatitura prej tyre.

Në javën e dytë trajtoht tema e qytetit, gjatë të cilës fëmijët do të njihen me të mirat e tij, me mundësitë që ofron, me institucionet, punët dhe profesionet që kryejnë njerëzit në një qytet, me vendet e argëtimit, dyqanet, parqet, restorantet, me jetën kulturore dhe artistike etj.

Në javën e tretë fëmijët do të njihen me zanatet më të përhapura në Kosovë, me punimet artizanale që kryejnë zanatçinjtë duarartë. Gjatë javës mund të vizitojen punishte të ndryshme dhe dyqane dhuratash në të cilat tregtohen punime artizanale.

Në javën e katërt, fëmijet do të bëjnë krahasimin mes qytetit dhe fshatit dhe do të votojnë se ku u pëlqen të jetojnë. Në punë në grup fëmiëjt shprehin ide si e duan qytetit/ fshatin ku jetojnë dhe çfarë do të donin të kishte tjetër. Fëmijët do të njihen me kafshët e buta dhe me prodhimet që merren prej tyre.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthuren më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan karakteristikat e jetës në qytet.
- Përshkruan karakteristikat e jetës në fshat.
- Evidenton të mirat që na ofron si qyteti dhe fshati.
- Tregon përrallat mbi bazën e figurave që shikon.
- Përshëndet në mënyrën e duhur njerëzit që shikon duke punuar.
- Njihet me kafshët e buta që jetojnë në fshat dhe bën pyetje për të mësuar më shumë për to.
- Përgatit një kartolinë dhe tregon se kujt ia ka kushtuar.
- Nxjerr kuptimin e fjalëve të urta popullore.
- Dallon ushqimet që merren nga toka dhe nga kafshët e buta.
- Përshkruan emocionet që përjeton në ngjarje e ditë të caktuara.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat Q, R, RR, S.

Edukata figurative

Fëmija:

- Krijon sipas fantazisë një kartolinë urimi.
- Shikon dhe jep mendim për vepra nga artistë të njojur në botë.
- Realizon me thurrje, me plastelinë ose me materiale të tjera një punim artizanal.
- Punon me shabllon kafshët e fermës.
- Paraqet me vizatim qytetin dhe fshatin dhe interpreton ndryshimet që ka paraqitur.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Shpreh mendimin e vet për këngën që dëgjon me dy-tri fjali të thjeshta, me shprehje figurative ose me lëvizje.
- Dallon kafshët nga tingujt që lëshojnë.
- Këndon këngët duke e shoqëruar me lëvizje ritmike.
- Paraqet me ilustrim pjesë nga tekstet e këngëve që dëgjojnë.
- Realizon instrumente popullore me materiale të riciklueshme.

Matematika

Fëmija:

- Lexon numrat prej 1-8.
- Radhit numrat deri në 8
- Grupon me 4 mënyra që të krijohet numri 8.
- Mat gjatësinë e objekteve me njësi jostandardë (*pëllëmbë, shputë, hap, laps, shkop*)
- Radhit objekte sipas ngjyrës, formës dhe madhësisë.
- Përllogarit blerjet që mund të bëjë me Eurot që kanë.
- Dallon objektin që nuk i përket grupit.
- Dallon sipërfaqen brenda dhe jashtë një figure.

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Identifikon sipërfaqen më shumë të lëmuar nga sipërfaqet e tjera më pak të lëmuara
- Dallon trupin më të rëndë nga trupi më i lehtë.
- Përshkruan lidhjen reciproke në mes shtazëve dhe njeriut (*për sigurimin e ushqimeve, veshimbathjeve dhe kujdesit reciprok*)
- Shikon punimet artizanale dhe dallon materialin me të cilin janë përgatitur.
- Kupton dhe krijon zinxhira të thjeshtë ushqimorë.

Shoqëria dhe mjedis

Fëmija:

- Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe merr përgjegjësi për to.
- Tregon për profesionet e anëtarëve të familjes dhe të personave që njeh.
- Dallon rregullat e caktuara në veprimitari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë/kopsht, lojë etj.
- Argumenton në mënyrën e vet vendimet vetanake për profesionin që i pëlqen.

Edukata fizike

Fëmija:

- Praktikon ushtrime të thjeshta ritmike me dhe pa mjete
- Mban ekuilibrin e trupit gjatë ecjes në një vijë të drejtë
- Merr pjesë në lojëra elementare dhe demonstron shkathtësi gjatë zhvillimit të tyre.
- Shfaq kënaqësi kur bashkëvepron si duhet me fëmijët e skuadrës
- Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim me çifte dhe grupe.
- Respekton rregullat gjatë lojës.
- Shfaq kënaqësi kur bashkëvepron si duhet me fëmijët e skuadrës

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Simulon shitjen e gjësendeve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe blerësit
- Luan lojë me role duke imituar profesionistet, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer.
- Ndjek udhëzimet gjatë aktivitetave të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.
- Luan lojë me role duke imituar profesionistet, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer

Projekti i muajit

Gjatë muajit mars do të zhvillohet projekti “**Në fshat**”. Fëmijët në projektin e tyre do të paraqesin kafshët e buta, kujdesin që njeriu tregon për to, familjet e kafshëve, prodhimet që na jepin etj. Fëmijët mund të punojnë me shabllone dhe mund të krijojnë skeda të thjeshta në gjuhën e kafshëve. Në përfundim të projektit, fëmijët marrin një certifikatëpër punën që kanë bërë dhe për trajtimin e veçantë që i kanë bërë temës.

Pas përfundimit të shkronjës R fëmijët zhvillojnë aktivitetin “Luaj me shkronja” dhe me kartelat për katëse duke punuar me grupin e aktër të të shkronjave.

Planifikimi i temave për muajin mars “Në qytet apo në fshat?”

	Java 1 Zemra jonë e vogël kërcen nga gjëzimi	Java 2 Qyteti dhe profesionet më të përhapura	Java 3 Duarartët zanatçinj	Java 4 Të mirat që na ofron fshati dhe qyteti
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> Vjersha “Kur vjen 7 Marsi” (<i>Fq. 96</i>); Fjalët që dua t’i them mësueses sime të dashur Vjersha “Rend te mami, rend te gjyshja” (<i>Fq. 97</i>) Fjalët që dua t’i them mamit tim të shtrenjtë Tregimi “Mami mos më lavdëro” (<i>Fq. 100 - 101</i>) Shkronja Q (<i>Fq. 98 - 99</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Profesionet e prindërve (<i>Fq. 102 - 103</i>) Emërtimet, mjetet, veglat, veshjet që përdorin Aftësitë që kërkon çdo punë Në qytet ka shumë dyqane (<i>Fq. 108</i>) Çfarë do të bëhem kur të rritem? Shkronja R (<i>Fq. 106 - 107</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Përralla “Pse hëna s’ka fustan?” (<i>Fq. 112 - 113</i>) Zanatçinjtë dhe punishtja e tyre Punimet artizanale mbartin vlera të veçanta; Vjersha “3 shkronjat e Hënës” (<i>Fq. 114 - 115</i>) Fjalët e urta popullore Shkronja RR (<i>Fq. 116 - 117</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Të mirat që marrim nga fshati (<i>Fq. 118</i>) Përralla “Miu i fshatit dhe miu i qytetit” (<i>Fq. 120 - 121</i>) Ushqimet që marrim nga toka që punon bujku; Prodhimet që marrim nga kafshët e fshatit Vjersha “Në qytet apo në fshat?” (<i>Fq. 95</i>) Shkronja S (<i>Fq. 122 - 123</i>)
Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> Kartolinë urimi “Për ty” 	<ul style="list-style-type: none"> Artistë të njohur në botë 	<ul style="list-style-type: none"> Instrumente popullore me materiale të riciklueshme: daulle, çifteli, dajre 	<ul style="list-style-type: none"> Punim me shabllon “Kafshët e fermës”
Edukatë muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Kënga “O mësuese e dashur” 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga “Simfonia e kafshëve” 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga “Kominoshet ngjyrë kaltëroshe” 	<ul style="list-style-type: none"> Kënga “Qengji i vogël”

Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> • Numri 8 (<i>Fq. 104 - 105</i>) • Simetrike apo jo? • Matje me njësi jo standarde • Parashikimi i ngjarjeve: e mundur, e pamundur 	<ul style="list-style-type: none"> • Euro dhe veprimet me të Mbledhje deri në 8 (<i>Fq. 110</i>) • Peshimi i sendeve me njësi jo standard • Klasifikimi i objekteve sipas formës, ngjyrës dhe madhësisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi dhe plotësimi i tabelave • Përsëritje deri në 8 • Kush nuk i përket grupit? (<i>Fq. 119</i>) • Sipërfaqja brenda dhe jashtë 	<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizje sipas drejtimit; • Zbulo rregullin, vazhdo vargun; • Radhitja e objekteve sipas 2 cilësive • Zbritje deri në 8 (<i>Fq. 111</i>)
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> • Zinxhiri ushqimor 	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet me të cilat bëhen lodrat e fëmijëve • Sipërfaqe e lëmuar/ sipërfaqe e ashpër 	<ul style="list-style-type: none"> • Objektet prej druri, letre, metali, tekstili 	<ul style="list-style-type: none"> • Produktet që marrim nga kafshët • Të vegjëlit e kafshëve.
Shoqëria dhe mjetësi	<ul style="list-style-type: none"> • Mburrjet dhe lavdërimet (<i>Fq. 101</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Profesionet e anëtarëve të familjes. Puna siguron të ardhurat në familje 	<ul style="list-style-type: none"> • Respekti për njerëzit e punës. • Rregullat në një panair, ekspositë etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Profesioni/ puna që do zgjedh kur të rritem.

Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Garë: Kush e kapi i pari shaminë? Tërheqje litari 	<ul style="list-style-type: none"> Loja "Mos u nxeh" Lojë "Gjilpëra, peri, nyja" 	<ul style="list-style-type: none"> Emocionet që më përcjell loja me shokët; Ecje, kërcime, hedhje dhe vrapime 	<ul style="list-style-type: none"> Imitime ecjesh të kafshëve të fermës; Konsumimi i ushqimeve të shëndetshme: bulmeti, drithërat, mishi, frutat dhe perimet
Shkathësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Jam i zoti dhe kam talent në.../ për... 	<ul style="list-style-type: none"> Lojë në role "Shitësi dhe blerësi" 	<ul style="list-style-type: none"> Si është bërë kjo trikoja që kam veshur? Presim dhe qepim si një rrobaqepës 	<ul style="list-style-type: none"> Si prodhohet buka? (Fq. 109)
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> Urime në gjuhë të huaj Number 8 	<ul style="list-style-type: none"> Toys names 	<ul style="list-style-type: none"> Mimes and guesses actions used in playing games and sports 	<ul style="list-style-type: none"> My favourite animals Collage of animals
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Si të paketojmë bukur një dhuratë 	<ul style="list-style-type: none"> Bëjmë dhe "shesim" kukulla dore - pupeta 	<ul style="list-style-type: none"> Në muzeun etnografik 	<ul style="list-style-type: none"> Malli që do të shisja. Një reklamë për biznesin tim të ri.

Veprimitari mësimore për muajin mars

- **Gëzuar festat!** Me rastin e 7-8 Marsit fëmijët do të mësojnë vjersha për mësuesin/en dhe nënën. Fëmijët shprehin me mënyrat e tyre urimet më të përzemërta për këta dy njerëz të shtrenjtë. Fëmijët mund të organizohen dhe të mendojnë vetë se çfarë duan të bëjnë për të gëzuar dhe surprizuar mësuesin/en dhe nënën. Fëmijët këndojnë këngët për mësuesin/en dhe nënën dhe e shoqërojnë këndimin e tyre me lëvizje trupore.
- **Vjershat** “Kur vjen 7 Marti” dhe “Rend te mami, rend te gjyshja”. Fëmijët dëgjojnë vjershat dhe tregojnë me fjalë përbaltjen e tyre. Ata flasin për marrëdhëniet me nënën dhe me gjyshen. Para se të trajtojë këtë temë mësuesi/ja duhet të ketë dijeni për përbërjet e familjeve të fëmijëve të klasës me qëllim që nëse ka fëmijë që nuk e kanë nënën atëherë të flitet për gjyshen apo për gra të tjera të familjes. Më tej fëmijët realizojnë një kartolinë, një vizatim apo një dhuratë simbolike për mësuesin/en dhe nënën. Shkruajnë një urim të shkurtër dhe shprehin gjithë dashurinë e tyre për personin që do t’ia jepin.
- **Bisedë për marrëdhëniet prind-fëmijë.** Tregimi “**Mami mos më lavdëro!**” merr shkas nga situata reale që ndodhin shpesh në familjet tonë. Prindërit, sidomos nënët përpilen të mburrin fëmijët e tyre para shoqeve duke treguar gjëra dhe aftesi të veçanta që u duket sikur kanë fëmijët e tyre. Nëpërmjet tregimit dhe ngjarjeve të tij, fëmijët komentojnë veprimet e prindërvë dhe pozitën e vështirë ku u ndodh vajza. Fëmijët mësojnë se ndonjëherë edhe të rriturit bëjnë gabime. Në raste të tilla atyre u duhet t’u kërkojnë falje fëmijëve. Më tej fëmiëjt tregojnë nëse kanë patur raste të ngjashme.
- **Bisedë për profesionet.** Qëllimi i bisedës është që fëmijët të mësojnë më shumë rreth profesioneve dhe punët që kryejnë prindërit e fëmijëve dhe njerëzit në moshë të rritur. Fëmijët kuptojnë rëndësinë e punës për sigurimin e të

mirave materiale dhe pér kënaqësinë që tē ofron ajo. Mësuesi/ja u paraqet fëmijëve fotografi ku paraqiten njerëz që punojnë në profesione tē ndryshme. Fëmijët dallojnë veshjen, mjetet, kapelat dhe institucionet ku punojnë.

- **Shëtitje në qytet.** Pér t'u njojur me punët, profesionet e njerëzve në qytet me fëmijët mund tē organizohen shëtitje ose ecje në rrugët e qytetit. Duke ecur mësuesja u tregon fëmijve pér njerëzit që punojnë në institucione tē ndryshme, në dyqane, në lokale duke u treguar edhe llojin e shkollës që njerëzit duhet tē bëjnë pér tē ushtruar një profesion tē caktuar. Mësuesi/ja zhvillon bisedë me fëmijët pér profesionin që ata duan tē zgjedhin kur tē rriten. Në qytet fëmijët shikojnë shumë dyqane. Pér secilin lloj ata emërtojnë profesionet dhe punët që kryejnë njerëzit në to. Në librin e punës jepen figura që tregojnë gjëra tē ndryshme që tregtohen nëpër dyqane.
- **Përralla “Pse Hëna s’ka fustan?”** i lidh fëmijët me punët që kryejnë artizanët. Një ndër ta është edhe rrobaqepësi. Fëmijët dëgjojnë përrallën dhe kuptojnë domethënien e saj. Në mënyrë simbolike, ata luajnë në role dhe veprojnë si rrobaqepësa duke u marrë masën kukullave dhe tē lodrave tē buta me tē cilat luajnë. Mësuesi/ja i ndihmon tē presin disa shabllone dhe nëpërmjet tyre tē presin në rroba që nuk i përdorin më veshje pér kukullat. Pér ndihmë mësuesi/ja mund tē marrë edhe ndonjë prind ose gjyshe vullnetare.
- Nëpërmjet përrallës fëmijët njihen me format që merr Hëna gjatë rrotullimit tē saj rrëth Tokës. Gjatë një muaji fëmijët mund tē shikojnë Hënën dhe tē mbajnë shënim format që merr ajo. Po këtij qëllimi i shërben edhe vjersha “**3 shkronjat e Hënës**”. Duke shfrytëzuar imagjinatën dhe fantazinë, fëmijët realizojnë një veshje pér diellin dhe një fustan pér hënën, pér secilën nga fazat e saj.
- **Ditë e hapur pér prindërit dhe komunitetin.** Një ditë, mësuesi/ja mund tē lajmërojë prindërit ose gjyshërit e fëmijëve pér tē ardhur në shkollë dhe pér tē organizuar *një ditë ndryshe*. Së bashku mund tē realizojnë punë tē ndryshme duke i përfshirë sa më shumë fëmijët në aktivitet dhe duke i bërë ata tē dobishëm. Punët e përbashkëta që mund tē bëhen janë: prerja dhe qepja e veshjeve pér kukullat, përgatitja e një ëmbëlsire tē thjeshtë, mbjellja e një

bime etj. Fëmijët mësojnë këngën “**Kominoshet ngjyrë kaltëroshe**” dhe e këndojnë gjatë kohës që punojnë. Ata shprehen nëse u pëlqen kënga dhe flasin për dyqanin ku shkojnë për të blerë veshjet e tyre.

- **Ekskursion në fshat dhe vizitë në një fermë.** Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të vlerësojnë dhe të dallojnë të mirat që u siguron fshati, punët e bujkut dhe të blegtoret. Fëmijët njihen me kafshët e buta, emërtojnë saktë emrat e tyre, i dallojnë nga tingujt, emërtojnë familjet e kafshëve, dhe prodhimet që marrim prej tyre. Si përpunohen më tej prodhimet dhe si dalin prej tyre produkte të reja. Mësuesi/ja zhvillon bisedë edhe për rëndësinë e konsumimit të ushqimeve të shëndetshme, si: bulmeti, drithërat, mishi, frutat dhe perimet
- **Ushtrime zbavitëse.** Në librin e punës, fëmijët kanë një fletë ku do lidhin kafshët me hijen e tyre apo kur do t'i gjejnë prindin të voglit të kafshëve. E lidhur me kafshët e fshatit janë këngët “**Simfonia e kafshëve**” dhe “**Qengji i vogël**”, për të cilat fëmijët interpretojnë muzikën që dëgjojnë. Fëmijët imitojnë ecjen dhe zërat e kafshëve të fermës.
- **Eksperiment.** Mbjellja e kokrrës së grurit dhe kujdesi për mirërritjene saj. Buka është një produkt që konsumohet nga të gjithë. Fëmijët dëgjojnë përrallën “**Pula e vogël e kuqe**” dhe nëpërmjet saj tregojnë fazat e rritjes së grurit, bluarjes dhe përgatitjes së ushqimeve të ndryshme.
- **Përralla “Miu i qytetit dhe miu i fshatit”** nxjerr në dukje ndryshimet ndërmjet të mirave që ofron fshati dhe qyteti, për thjeshtësinë dhe jetën më të qetë që të ofron fshati, por edhe mundësitë më të mëdha dhe larminë që të ofron qyteti.
- **Konceptet matematike** janë të lidhura me mësimin e numrit 8, me mbledhjet dhe zbritjet brenda 8, me leximin dhe plotësimin e tabelave, me lëvizjen sipas drejtimeve, me zbulimin e rregullit në një varg etj. Fëmijët mund të luajnë me masat dhe peshimin e objekteve të ndryshme dhe krahasimin e peshave.

MIRË SE ERDHE MOJ PRANVERË!



Specifikat e punës në muajin Prill

Njohja me karakteristikat e stinës së pranverës, motin, rizgjimin e natyrës, veshjet dhe punët e stinës.

Tema e muajit prill është e lidhur me stinën e pranverës. Në natyrë kanë filluar të duken shenjat e para të fillimit të kësaj stine. Dita është bërë më e gjatë, bari ka filluar të çelë, lulet po ashtu. Njerëzit heqin veshjet e dimrit dhe vishen më lehtë. Fillojnë të piqen frutat e stinës dhe në fshat kryhen punët e pranverës.

Temat javore të parashikuara për muajin prill janë:

- Karakteristikat e stinës së pranverës
- Rizgjimi i natyrës. Përralla "Tri fluturat"
- Në pyll po dëgjohen ca zëra. Kafshët po zgjohen një e nga një.

Në javën e parë të do të flitet për stinën e pranverës dhe për karakteristikat e saj. Shëtitjet në natyrë, vëzhgimi i përditshëm i motit, përdorimi i simboleve të motit dhe përshkrimi i ditëve në këtë stinë janë temat kryesore që diskutohen me fëmijët.

Në javën e dytë do të mësohet përralla "Tri futurat" e lidhur me insektet, me lulet dhe me motin e paqëndrueshëm në pranverë.

Në javën e tretë do të flitet për kafshët e pyllit, për ndryshimet që ndodhin në këtë stinë edhe në pyll dhe për kënaqësinë që të jep një punë e përbashkët.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthuren më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan një ditë pranvere.
- Dallon karakteristikat e pranverës dhe përshkruan motin në këtë stinë.
- Reciton vjershat dhe nxjerr kuptimin e tyre.
- Përshkruan veshjet e stinës së pranverës.
- Nxjerr mësime nga përrallat që dëgjon.
- Tregon përrallat mbi bazën e figurave.
- Rendit ngjarjen sipas radhës.
- Zgjedh një rol dhe e interpreton me dashuri.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat Sh, T, Th.

Edukata figurative

Fëmija:

- Vizaton dhe ngjyros pyllin në pranverë.
- Krijon me materiale të riciklueshme natyrale dhe artificiale rrëth stinës së pranverës.
- Realizn me kolazh, me karton ose me material druri folënë e dallëndyshes ose të zogut në pyll.
- Ngjyros sipas fantazisë tortën e ditëlindjes duke shprehur dëshirat e veta.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dëgjon muzikë klasike dhe dallon instrumentin muzikor që luan në të.
- Lëviz duart duke imituar lojën në tastierë.
- Këndon këngën dhe eshoqëron me lëvizje.
- Dëgjon muzikë dhe përpinqet të ndjekë ritmin e saj.
- Emërtón instrumentet muzikore.

Matematika

Fëmija:

- Lexon numrat prej 1-9
- Formon modele sipas veticë të objekteve.
- Klasifikon objekte/ sende sipas ngjyrës, formës, madhësisë.
- Lexon të dhëna të thjeshta në një tabelë.

- Dallon pjesën nga e tëra dhe gjen kujt i përket një pjesë e dhënë.
- Grupon me dy mënyra që të krijohet numri 9.
- Kryen mbledhje dhe zbritje deri në 9

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Tregon karakteristikat kryesore të stinës së pranverës.
- Përshkruan ndryshimet e motit gjatë stinës së pranverës.
- Dallon pjesët kryesore të bimëve.
- Tregon nevojat themelore jetësore të bimëve (ushqim, ujë, ajër dhe dritë).
- Përshkruan shfrytëzimin e bimëve (për ushqim të shtazëve dhe të njeriut) dhe për zburime.
- Përshkruan eksperimentin e gjendjeve të ujit.

Shoqëria dhe mjedisi

Fëmija:

- Identifikon vendime të cilat mund t'i marrë për veten e tij, në raport me moshën.
- Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe merr përgjegjësi për to.
- Nëpërmjet veprimeve të personazheve dallon cilat prej tyre duhen qortuar dhe cilat vlerësuar.
- Vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit dhe të kryerjes së një pune me fëmijët e tjerë.

Edukata fizike

Fëmija:

- Dallon llojet e ushqimeve që përdor në mënynë e vet.
- Përshkruan si duket një person i shëndoshë (i shëndetshëm).
- Dalon shenjat e lodhjes dhe i menaxhon në mënyrën e duhur.
- Praktikon mënyrat e çlodhjes gjatë lojës.
- Njeh rëndësinë e shëndetit dhe faktorëve që ndikojnë në shëndet.
- Improvizon lojëra lëvizore të lidhura me temën.
- Kërcen dhe hidhet duke ndjekur ritmin e muzikës.

Shkathtësi për jetën

Fëmija:

- Krijon punime te ndryshme duke përdorur materiale ricikluese (materiale natyrale, artificiale)
- Përdor mjete elektronike për punime të ndryshme ose për të marrë foto dhe pamje.
- Dallon çfarë ka pasur më parë e çfarë ka tanë “më parë kishte...tani ka...”

Projekti i muajit

- Për muajin prill do të zhvillohet projekti “**Panvera**”. Në formatin A3 që kanë në dosje fëmijët do të punojnë gjithë muajin për ta plotësuar dhe për ta finalizuar projektin për këtë stinë. Siç është thënë në përfundim të projektit organizohet një veprimtari me prindërit që të shohin punën dhe arritjet e fëmijëve të klasës.
- Në fillimin e këtij muaji, mësuesi/ja merr nga dosja e fëmijëve fletën “**Ja si ndihem unë**” dhe i pyet me radhë si ndihen ata gjatë 7 muajve që vijnë në shkollë/kopsht.

Planifikimi i temave për muajin prill "Mirë se erdhe moj pranverë!"

	Java 1	Java 2	Java 3
	Karakteristikat e stinës së pranverës	Rizgjimi i natyrës. Përralla "Tri fluturat"	Në pyll po dëgjohen ca zëra; Kafshët po zgjohen një e nga një
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> Natyra dhe moti në pranverë; Veshjet e stinës; Vjersha "Manushaqja" (Fq. 5) Vjersha "Iu lut lulja yllkës" (Fq. 14 - 15) Rikthimi i shpendëve shtegtarë; Vjersha "Foleja e re e dallëndyshes" (Fq. 6 - 7) Frutat dhe perimet e stinës; Përralla "Zogu dhe farëza" (Fq. 10 - 11) Shkronja Sh (Fq. 12 - 13) 	<ul style="list-style-type: none"> Përralla "Tri fluturat"; Miqësia e vërtetë (Fq. 18 - 19) Renditja e ngjarjeve në një përrallë; Mesazhi që marrim; Dramatizimi i një përralle Vjersha "Marshi i buburrecit" (Fq. 27) Unë dhe shokët e mi/ shoqet e mia Shkronja T (Fq. 24 - 25) 	<ul style="list-style-type: none"> Pylli -Shtëpia e bimëve dhe e kafshëve; Përralla "Të gjithë së bashku" (Fq. 30 - 31) Një punë e mirë e bërë së bashku Vjersha "Kush këndon më bukur?" (Fq. 23) Vjersha "Ëmbëlsira" (Fq. 32) Shkronja TH (Fq. 34 - 35)
Edukatëfi gurative	<ul style="list-style-type: none"> Kolazh/ Aplikacion "Foleja e dallëndyshes" 	<ul style="list-style-type: none"> Pylli në pranverë 	<ul style="list-style-type: none"> Vizatim dhe ngjyrosje "Torta e ditëlindjes"

Edukatë muzikore	Instrumentet muzikore (<i>Fq. 22</i>) Sara Lamoja - Sa i dua lulet, Fest 11 Ulqin 2016 https://www.youtube.com/watch?v=16sJ4RsZouA	Kënga "Flutur moj" https://www.youtube.com/watch?v=8EehDjly900	Kënga "Simfonia e kafshëve"
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Numri 9 (<i>Fq. 8 - 9</i>) Numërimi nga 1 – 9 dhe nga 9 – 1 (<i>Fq. 28</i>) Krahasimi i elementeve të dy bashkësive: më shumë/ më pa/ aq sa Grupimi me dy mënyra për të formuar numrin 9 	<ul style="list-style-type: none"> Mbledhje deri në 9 (<i>Fq. 16</i>) Matje me peshore Zbritje deri në 9 (<i>Fq. 17</i>) Nxë më shumë/ nxë më pak (<i>Fq. 29</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Trupat gjeometrike (<i>Fq. 33</i>) Parashikimi i blerjeve të sendeve deri në 10 Euro Cili numër është? (<i>Fq. 38</i>) Pjesa dhe e tëra (<i>Fq. 39</i>)
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat e stinës së pranverës 	<ul style="list-style-type: none"> Çdo gjallesë ka ciklin e vet jetësor: lulja, flutura njeriu (<i>Fq. 20</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Insektet (<i>Fq. 26</i>) Pjesët e bimës (<i>Fq. 21</i>)
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> Vendime që mund të marr në rapport me moshën që kam 	<ul style="list-style-type: none"> Rregullat në lojë 	<ul style="list-style-type: none"> Fjalët magjike Sjelljet e kulturuara në mjedise të ndryshme

Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Loja “Ngriva-shkriva” 	<ul style="list-style-type: none"> • Shenjat e lodhjes. Si të çlodhemi gjatë lojës. • Loja “Fluturon, fluturon” 	<ul style="list-style-type: none"> • Pijet dhe ëmbëlsirat. Trupi ynë ka nevojë për to, por jo për sasinë e tyre • Loja muzikore “Patat po notojnë” <p>https://www.youtube.com/watch?v=93YEV0iunNs</p>
Shkathësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e zogut me tekstile dhe mbushje me oriz/ pambuk 	<ul style="list-style-type: none"> • Më parë kishte... tani ka... 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrotja e pyllit
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> • Number 9 • Mimes and guesses various pets and animals 	<ul style="list-style-type: none"> • My favourite drink • My favourite food. 	<ul style="list-style-type: none"> • Draw a picture of his/her friend doing their favorite activities together
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> • Paraja: Kursimi dhe përdorimi 	<ul style="list-style-type: none"> • Ku shkuan dinosaurët? 	<ul style="list-style-type: none"> • Ëmbëlsira nga duart e gjyshes time.

Veprimtaritë mësimore për muajin prill

- **Shëtitje në natyrë.** Shëtitjet në natyrë kanë lidhje me stinën dhe vëzhgimin e ndryshimeve që ndodhin në natyrë. Siç e kemi përmendur edhe më parë, kur bëhet fjalë për vëzhgimin e natyrës dhe të motit, sugjerohet që mësuesi/ja t'i çojë fëmijët te i njëjti vend në çdo stinë, në mënyrë që ata të dallojnë ndryshimet që kanë ndodhur dhe të bëjnë karahasime “më parë kishte..., tani ka...”. Në muajin prill në natyrë ndryshimet e stinës vërehen lehtë. Fëmijët orientohen të vëzhgojnë barin, lulet, pemët, qiellin, veshjet e njerëzve dhe të flasin prej tyre. Gjatë shëtitjes në natyrë, fëmijët dëgjojnë tingujt dhe zhurmat dhe tregojnë se cilët prej tyre pëlqejnë dhe cilët jo. 5 prilli është Dita Ndërkomëtare e zogjeve dhe me këtë rast fëmijët mund të përgatisin fole për zogjtë, t'u hedhin thërrime buke në dritare dhe të bëjnë postera sensibilizues për mbrojtjen e pyjeve dhe mbjelljen e pemëve.

Që nga shtatori që kanë filluar shkollën, fëmijët kanë patur mundësi të njihen me 3 stinë dhe nga rimarrja e temës së stinëve mbajnë mend karakteristikat e secilës prej tyre. Edhe në librin e punës, prilli nis me pamjen e rizgjimit të natyrës në pranverë.

- **Vjershat** “Manushaqja”, “Iu lut lulja yllkës”, “Marshi i buburrecit” janë të lidhura me lulet që çelin në pranverë dhe simbolizojnë ardhjen e saj, siç është manushaqja, insektet dhe rikthimi i shprendëve shtegtarë. Si edhe në rastet e tjera, vjershat, përrallat, tregimet dhe çdo veprimtari e përfshirë në librin e punës të fëmijës janë didaktike dhe i shërbejnë disa qëllimeve mësimore; përbajtja e tyre lidhet me trajtimin e koncepteve dhe të çështjeve nga shumë programe mësimore dhe natyrshëm kalohet nga njëra veprimtari në tjetrën dhe nga njëra lëndë në tjetrën. Të gjitha veprimtaritë janë të ndërthurura dhe realizimin e tyre mësuesi/ja e sheh brenda javës dhe jo brenda ditës, duke mbajtur parasysh edhe kohën që u duhet fëmijëve për t'i mësuar dhe kuptuar gjërat dhe aktivitetet që bëhen në

klasë. Kështu p.sh. nga recitimi i vjershës "Iu lut lulja yllkës", mësuesi/ja trajton pjesët e bimës dhe përdorimin e bimëve për ushqim dhe zbukurim që lidhen me lëndën "Natyra dhe njeriu", lidhet me veglat dhe mjetet e punës që duhet për mbjelljen e bimëve nga "Shktathtësi për jetën", mësohet kënga "Sa i dua lulet", lidhet me Edukatën figurative me vizatimin dhe ngjyrosjen e pyllit në pranverë, lidhet me konceptet e matematikës për numërim, shoqërim një për një, për kryerjen e mbledhjeve dhe të zbritjeve etj.

- **Veprimitari praktike:** Eksperimenti për vëzhgimin dhe përshkrimin e gjendjeve të ujit. Ky eksperiment mund të zhvillohet në kushtet e klasës ose t'u jepet detyrë fmëijëve në shtëpi ta realizojnë me ndihmën e prindit. Fëmijët do të shpjegojnë çfarë ndodhi me ujin kur u fut në ngrirje dhe çfarë ndodhi me akullin kur u la në diell. Një tjetër veprimitari lidhet me pasurimin e mjedisit të klasës me lule të reja, sepse koha është e përshtatshme për të bërë mbjelljen e farave të luleve. Mundet që të shpallet një konkurs përfëmijën që është kujdeset më shumë përlulet dhe fituesi mund të shpallet në 22 prill që është edhe Dita e Tokës.
- **Përralla "Tri fluturat"** lidhet me natyrën në pranverë, me motin e paqëndrueshëm të stinës, por lidhet edhe me marrëdhëni e miqësisë ndërmjet fëmijëve. Edhe pse zuri shi 3 fluturat nuk u ndanë nga njëra-tjetër, por qëndruan së bashku. Ky veprim u mëson fëmijëve t'i duan shokët, të krijojnë shoqëri të bukur e të mirë më njëri-tjetrin, të kujdesen dhe të vlerësojnë bashkëpunimin me të tjerët. Përralla mund të dramatizohet dhe fëmijët të ndarë në grupe luajnë rolin e fluturave dhe të luleve. Nga dosja e fëmijëve, mësuesi/ja nxjerr fletën "Vlerësimi për interpretimin në shfaqje" dhe ua shpërndan të ftuarve në shfaqje.

E lidhur me këtë përralla është **kënga** "Flutur moj" dhe simetria. Një flutur fëmija mund ta modeloje duke përdorur vija, forma dhe ngjyra të ndryshme.

- **Përralla** “Të gjithë së bashku” është e lidhur me zgjimin e kafshëve nga gjumi dimëror dhe në mënyrë simbolike fillimi i punës së tyre për të siguruar ushqim, lidhet me përgatitjen e një torte, ku secili nga kafshët kontribuon në përgatitjen e saj. Nëpërmjet kësaj përralle mësuesi/ja zhvillon bisedë që lidhet me evidentimin e vlerave dhe të aftësive të veçanta që kanë fëmijët e klasës. Mbi bazën e këtyre aftësive, fëmijët grupohen në grupe dhe mendojnë të bëjnë një veprimitari të përbashkët, ku secili vendos emrin dhe ka kontributin e vet në grup.

Puna që fëmijët realizojnë finalizohet me **dhënen e certifikatës për pjesëmarrje dhe punë në grup**. Mundet që të realizohet edhe një panair me prodhime shtëpie, ku fëmijët me ndihmën e të rriturve realizojnë biskota,ëmbëlsira, byrek dhe prodhime të tjera të lehta. Secili fëmijë tregon kontributin që ka dhënë në përgatitjen e prodhimeve. Kjo veprimitari lidhet edhe me matematikën. Fëmijët bëjnë një listë të gjërave që u duhen për të blerë në dyqan dhe fillojnë bëjnë përllogaritjen e eurove për blerjen e tyre.

- **Loja në role** “Në dyqan” i ndihmon për ta realizuar këtë veprimitari. Në librin e fëmijës është dhënë një tortë. Fëmijët shikojnë kalendarin e ditëlindjeve dhe mësuesi/ja përllogarit që këtë veprimitari ta kryejë në ditëlindjen e një fëmije. Në rast se nuk ka mund të improvizohet sikur njëri nga personazhet e librit ka ditëlindjen. Kënga dhe urimet në gjuhë të huaj e shtojnë atmosferën festive në klasë. Përsëri është rasti që fëmijët të mësojnë si organizohet një ditëlindje, cilat janë gjërat që duhet të mbajnë parasysh, si të përgatisin ftesa për të thirrur njerëzit në ditëlindje, surprizat për të ftuarit etj. Çdo fëmijë mund të tregojë rreth ditëlindjes së fundit që është festuar në familjet e tyre.
- **Situatat problemore**. Duke përdorur elemente nga pranvera, si: lule të llojeve të ndryshme, insekte, shpendë, fruta, perime etj., në formën e lojës mund të zhvillohen problema të thejshta me një veprim për kryerjen e mbledhjeve dhe të zbritjeve deri në 9, apo me trajtimin e koncepteve matematike që lidhen me vendndodhjen, pozicionin dhe lëvizjen në drejtime të caktuara.

MJETET E TRANSPORTIT



Specifikat e punës në muajin maj

Njohja me mjetet që lëvizin në tokë, në ajër, në ujë. Bota e pasur nënujore.

Muaji maj është i lidhur me mjetet e transportit që lëvizin në tokë, në ajër dhe në ujë. Fëmijët do të njihen me mjetet, me rrugën ku lëvizin, me masat e sigurisë dhe kujdesin që duhet të tregojmë kur ecim në tokë apo shkojmë me pushime në plazh. Gjithashtu fëmiët do të emërtojnë saktë emrat e njerëzve që punojnë me këto mjete dhe do të tregojnë ngjarje që lidhen me temën. Në muajin maj është parashikuar njohja e fëmijëve me botën nënujore, një botë e pasur me gjallesa të ndryshme.

Temat javore që janë parashikuar në muajin maj janë:

- Mjetet që lëvizin në tokë;
- Mjetet që lëvizin në ajër;
- Mjetet që lëvizin në ujë;
- Në botën e pasur nënujore.

Në javën e parë, fëmijët do të njihen me **mjetet që lëvizin në tokë**, duke mësuar për mjetet që përdorin në familje, me mjetet e transportit publik, me mjetet e ndihmës së shpejtë, me mjetet e punës dhe me mjetet që mund të përdorin fëmijët siç është biçikleta. Siguria në rrugë është pjesë e bisedave në javën e parë.

Në javën e dytë, fëmijët do të njihen me **mjetet që lëvizin në ajër**, duke krijuar edhe udhëtime imagjinare në hapësirë. Pjesë e aktiviteteve të parashikuara për këtë temë do të jetë edhe loja në role.

Në javën e tretë, fëmijët do të njihen me **mjetet që lëvizin në ujë**, duke mësuar për mjetet dhe funksionet e ndryshme të përdorimit të tyre.

Në javën e katërt, fëmijët do të njihen me **botën e pasur nënujore** me gjallestat e ujit, me përralla e personazhe të njohur për ta.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan mjetet që lëvizin në rrugë, në ajër dhe në ujë.
- Improvizon situata në të cilat kërkon ndihmën e shpejtë.
- Tregon për të mirat që ka njeriu nga përdorimi i mjeteve të transportit.
- Njihet me gjallesat e ujit dhe bën pyetje për të mësuar më shumë për to.
- Parashikon fundin e historisë që dëgjon.
- Përshkruan një ngjarje që lidhet me udhëtimin me një nga mjetet e transportit.
- Merr pjesë në lojë në role.

- Jep këshilla për fëmijët që nuk respektojnë rregullat e sigurisë gjatë lëvizjes me mjete.
- Përshkruan një udhëtim imagjinar në hapësirë dhe nën det.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat U, V, X, Xh, Y.

Edukata figurative

Fëmija:

- Realizon aplikacion me mjetet e transportit.
- Shpreh me vizatim një udhëtim imagjinar.
- Modelon peshkun Nemo, sirenën e detit ose një personazh tjetër të njohur për fëmijë.
- Shpreh me vizatim botën nënujore.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Dallon gjinitë e ndryshme muzikore: muzikë vokale, instrumentale, vokale dhe instrumentale.
- Këndon këngët e thjeshta për fëmijë.
- Ndjeq ritmin duke trokitur duart, këmbët ose shkopinjtë.
- Shpreh me ilustrim moment nga përmbajtja e këngës.

Matematika

Fëmija:

- Përdor monedhat për blerje në situata jetësore.
- Krahason objekte sipas peshës duke përdorur njësi jo standarde.
- Lexon dhe radhit numrat prej 1-10.
- Grupon me dy mënyra që të formohet numri 10.
- Klasifikon objekteve/ sendeve sipas ngjyrës, formës, madhësisë.
- Mat gjatësinë e objekteve me njësi jostandardë (pëllëmbë, shputë, hap, laps, shkop)

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Dallon trupat në qetësi nga trupat në lëvizje.
- Dallon trupin që lëviz më shpejtë nga trupi që lëviz më ngadalë
- Realizon veprime duke përdorur shqisën e duhur.
- Dallon nëse një trup noton apo zhytet.
- Dallon trupat që treten në ujë.

Shoqëria dhe mjedisi

Fëmija:

- Diskuton për mënyrat e udhëtimit dhe ndikimin e tyre në mjedisin rrëthues (transporti publik dhe privat).
- Identifikon disa nga ndotësit e mjedisit dhe demonstron shkakhtësi të kujdesit ndaj mjedisit që e rrëthon (familje, shkollë / kopsht, lagje etj.)
- Diskuton për mënyrat e udhëtimit dhe ndikimin e tyre në mjedisin rrëthues (transporti publik dhe privat).
- Merr vendime të thjeshta për situata të ndryshme jetësore.
- Identifikon sjelljet që lidhen me mbrojtjen dhe dëmtimin e mjedisit.

Edukata fizike

Fëmija:

- Tregon shkakhtësi dhe vëmendje gjatë zhvillimit të lojës.
- Dallon mjediset e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike.
- Shpreh kreativitet me lëvizje, fjalë dhe kombinime të ndryshme
- Praktikon ushtrime të thjeshta ritmike me dhe pa mjet.
- Shfaq emocione përmes lojës.

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Krijon një bicikletë, n jë varkë dhe një balonë duke përdorur materiale ricikluese natyrale dhe artificiale.
- Identifikon rregulla përmbrojtje dhe siguri në mjedisin që e rrrethon.

Projekti i muajit

Në muajin maj fëmijët mund të bëjnë një projekt që lidhet me **mjetet e transportit**. Qëllimi i tij është sensibilizimi përmbrojtjen e mjedisit nga ndotjet, përdorimi më tepër i bicikletave, mbrojtja e ujërave me qëllim që të mos dëmtohet bota e gjallesave, një kryqëzim ku njerëzit dhe mjetet respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor etj.

Projekt i muajit mund të jetë edhe bota nënujore. Me mjete e material të riciklueshme, me informacionet që do të mbledhin me personazhet e përrallve do të realizojnë maketen e një akuariumi të madh brenda të cilit rriten bimë, peshq e gjallesa të tjera.

Në fund të projektit fëmijët marrin Certifikatë vlerësimi, duke i motivuar dhe vlerësuar përkontributin e veçantë që kanë dhënë në projekt.

Pas përfundimit të shkronjës U, fëmijët punojnë në formatin A3 “Luaj me shkronjat nga Rr-U”. Pjesë e veprimitarisë është edhe përsëritja e shkronjave dhe leximi i alfabetit.

Planifikimi i temave për muajin maj “Mjetet e transportit”

	Java 1 Mjetet që lëvizin në tokë	Java 2 Mjetet që lëvizin në ajër	Java 3 Mjetet që lëvizin në ujë	Java 4 Në botën e pasur nënujore
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> • Në zbulim të gjëegjëzave (<i>Fq. 41</i>) • Mjetet lëvizin në rrugën e duhur; Siguria në rrugë (<i>Fq. 44 - 45</i>) • Vjersha “Një çudi me tre sy”; Rregullat e qarkullimit rrugor (<i>Fq. 48 - 49</i>) • Vjersha “Na u prish makina” Alo, alo kam nevojë për ju! (<i>Fq. 52</i>) • Shkronja U (<i>Fq. 42 - 43</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet që lëvizin në ajër kanë rrugën e tyre; Aeroplani, helikopteri, raketa (<i>Fq. 56</i>) • Udhëtim imagjinar me anije kozmike (<i>Fq. 65</i>) • Lojë në role “Në aeroplan” • Përralla “Balona e ketrit Tyty”; Kujdesi për librat dhe lodrat (<i>Fq. 62 - 63</i>) • Shkronjat V (<i>Fq. 50 - 51</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet që lëvizin në ujë kanë rrugën e tyre: varka, trageti, nëndetësja; Siguria në det • Vjersha “Marinarët dhe pilotët” (<i>Fq. 57</i>) • Një udhëtim imagjinar me nëndetëse • Tregimi “Udhëtimi i yllit kurershtar” (<i>Fq. 68 - 69</i>) • Shkronja X (<i>Fq. 58 - 59</i>) • Shkronja XH (<i>Fq. 66 - 67</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë ka brenda në det/lumë/ liqen? • Gjallesat e ujit • Kuriozitetet • Tregimi “Ç’është ylberi?” (<i>Fq. 74 - 75</i>) • Tregimi “Pse deti është i kripur” (<i>Fq. 78 - 79</i>) • Shkronja Y (<i>Fq. 72 - 73</i>)
Edukatë figurative	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikacion “Makina” • Modelim “Bicikleta” 	<ul style="list-style-type: none"> • Vizatim dhe ngjyrosje “Astronauti dhe anija kozmike” 	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikacion “Varka me vela” 	<ul style="list-style-type: none"> • Modelim “Peshku Nemo” • Aplikacion “Brenda në det”

Edukatë muzikore	Kënga "Wheels on the bus" https://www.youtube.com/watch?v=nfeGMc4p9wM	Kënga "Yll i vogël lart në qiell" https://www.youtube.com/watch?v=P0jCPHILE2M	Gjinitë muzikore	Baby shark https://www.youtube.com/?v=WYct-tSs6lc 11 picirrukët peshkatarë https://www.youtube.com/watch?v=0GWUnhQaSNI
Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> Numri 10 (<i>Fq. 46 - 47</i>) Grupim me dy mënyra për të krijuar numrin 10. Situata problemore Më shumë/ më pak 	<ul style="list-style-type: none"> Dje kishte-Sot ka-Nesër mund të ketë Zbuloj rregullin dhe vazhdoj modelin Numri rreshtor deri në 10 Mbledhje deri në 10 (<i>Fq. 54</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Grupon të ngashmet Simetria Miks konceptesh: Mbi-nën; lart-poshtë; majtas-djathtas Renditje nga më i madhi te më i vogli; nga më i gjati te më i shkurtri 	<ul style="list-style-type: none"> Leximi i të dhënave në një tabelë dhe hedhja e të dhënave në tabelë Matje me njësi jo standarde Zbritje deri në 10 (<i>Fq. 55</i>) Numërimi nga 1-10 dhe nga 10-1 (<i>Fq. 64</i>)
Dituri natyre	Lëviz. Nuk lëviz (<i>Fq. 61</i>)	Më i shpejtë/ më i ngadaltë	Noton apo zhytet (<i>Fq. 70</i>)	<ul style="list-style-type: none"> Tretja e lëndëve te njëra-tjetra Shijet e reja që krijohen
Shoqëria dhe mijedisi	Mënyrat e udhëtimit	Shërbimet rekreative	Mundësítë që na krijon udhëtimi për të njohur njerëz dhe kultura anembanë botës	<ul style="list-style-type: none"> Si të zgjedhim çfarë të blejmë: Një peshk apo një breshkë uji?

Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> Garë me bicikleta; Lojë lëvizore “Unë jam lokomotiva dhe thërras vagonin e parë....” 	<ul style="list-style-type: none"> Loja “Fluturon, fluturon” 	<ul style="list-style-type: none"> Ushtrime ritmike me dhe pa mjet Lëvizje me shpejtësi dhe në drejtime të ndryshme 	<ul style="list-style-type: none"> Kujdesi në det. Mjetet mbrojtëse. Loja “Rrjeta dhe peshqit”
Shkakhtësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Libër me mjetet e transportit dhe stemat e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> Përgatisim balona për t'i ngritur në qiell; Palosje “Aeroplani” 	<ul style="list-style-type: none"> Siguria në det: jeleku i shpëtimit. Krahëzat, komardarja 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e mjedisit nga papastërtitë
Anglisht	<ul style="list-style-type: none"> Twinkle Twinkle Little Star https://www.youtube.com/watch?v=yCJlyiqpAuU 	<ul style="list-style-type: none"> Toys and games 	<ul style="list-style-type: none"> Number 10 Counts the given objects up to 10 	<ul style="list-style-type: none"> Free time activities
Pjesa zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimet që pëson plastelina, llastiku, teli i përkulshëm, susta kur luajmë me to. 	<ul style="list-style-type: none"> Pasaporta 	<ul style="list-style-type: none"> Palosja e letrës “Varka” 	<ul style="list-style-type: none"> Akuariumi me varka dhe peshq

Veprimtaritë mësimore për muajin maj

- **Në rrugë.** Në javën e parë të muajit që ka lidhje me mjetet që lëvizin në tokë, mësuesi/ja ka mundësi t'i çojë fëmijët në kryqëzim, në një kantier ndërtimi, në një servis makinash, në një parkim ku fëmijët të shohin nga afër mjetet për të cilat do të mësojnë më tepër. Nëse fëmijët janë në fshat me ta mund të flitet për mjetet e punës që përdoren aty si traktori, zetori, autokombajna etj.
- **Bisedë.** Në klasë mësuesi/ja zhvillon një bisedë me fëmijët për mjetet që përdorin në familje, nëse kanë makinë, bicikleta, motora apo ndonjë mjet tjeter. Siguria në rrugë, ecja në vijat e bardha dhe respektimi i semaforit mund të improvizohet edhe në lojë në role në klasë. Fëmijët mësojnë se nëse lëvizin me makinë duhet të vënë rripin e sigurimit dhe sipas moshës të përdorin e sediljen eduhur; nëse lëvizin me bicikletë duhet të vendosin në kokë mbrojtësen dhe po kështu edhe në bërryla dhe gjunj. Mësuesi/ja flet edhe për mjetet e transportit publik dhe rregullat që duhen zbatuar gjatë lëvizjes me to.
- **Bisedë.** Mësuesi/ja zhvillon edhe për mjetet që lëvizin në ajër. Me interes, është imagjinimi i një udhëtimi me anije kozmike ku çdo fëmijë përshkruan se çfarë shikon gjatë udhëtitimit në hapësirë. Bisedë zhvillohet edhe për mjetet që lëvizin në ujë. Pasi marrin informacionin për mjetet që lëvizin në tokë, ajër dhe uji, mësuesi/ja bisedon me fëmijët për mënyrën si lëvizin këto mjete dhe cili lëviz më shpejt. Po sipas fantazisë fëmijët mund të bëjnë një udhëtim me nëndetëse dhe të imagjinojnë se çfarë shohin gjatë lëvizjes nën ujë. Këtij qëllimi i shërben edhe përralla “Udhëtimi i yllit kureshtar”. Fëmijët mund të flasin për endrrat e tyre dhe për gjërat që do pëlqenin të bënin kur të rriteshin.
- **Vjersha** “Një çudi me tri sy” i njeh fëmijët me semaforin dhe domethënien e secilës ngjyrë që ai paraqet. Fëmijët dallojnë semaforin për kalimtarë dhe për makina. Në librin e punës së fëmijës janë vendosur edhe shenjat më kryesore të qarkullimit rrugor, të cialt ndeshen në rrugë.

- **Veprimtari praktike.** Nisur nga Vjersha “**Na u prish makina**” fëmijët mund të improvizojnë situata në klasë duke rregulluar mjetet dhe lodrat që u prishen. Fëmijët vlerësohen për durimin dhe këmbënguljen për ta përfunduar një punë dhe pér të kërkuar ndihmë kur kanë nevojë.
- **Vizitë në një kantier ndërtimi.** Fëmijët njihen me mjetet që shërbejnë pér të bërë ndërtime. Mjete të tilla fëmijët mund t'i kenë në shtëpi dhe në klasë mund të improvizojnë sikur do të krijojnë një bllok të ri ndërtesash pér lagjen ku jetojnë.
- **Eksperiment.** Në një enë të madhe fëmijët mund të bëjnë eksperimente pér notimin dhe zhytjen e trupave në ujë. Në fillim ata bëjnë parashikime dhe më tej bëjnë eksperimentet dhe nxjerrin përfundime. Gjatë eksperimentit fëmijët mund të krijojnë edhe situata problemore që zhvillojnë aftësitë e të menduarit. Eksperiment tjetër që mund të bëjnë fëmijët është provimi i shijeve të reja që krijohen nga tretja e lëndëve te njëra -tjetra.
- **Lojë në role.** Në jetën e përditshme fëmijët mund të ndodhen në situata të vështira ku kanë nevojë pér ndihmë pér një shërbim mjekësor, pér policinë, pér shërbim taksie ose pér një shërbim nga zjarrfikësja. Fëmijët që janë të apasionuar mund të sjellin në klasë makinat dhe t'ua tregojnë fëmijëve të tjerë. Gjithashtu me makinat lodër fëmijët, në varësi të sipërfaqes ku i vendosin makinat dallojnë edhe nëse një sipërfaqe është e lëmuar apo e ashpër dhe se si ajo ndikon në uljen e shpejtësisë së lëvizjes së mjetit.
- **Krijime artistike.** Fëmijët mund të bëjnë aplikacione, modelime, kolazhe, mozaik pér mejtet e transportit duke përdorur materiale nga më t ndryshmet.
- **Aktivitete praktike.** Gara me bicikletë, përgatitja e një balone, përgatitja e varkës dhe e raketës me letër, krijimi i eksperimentit pér formimin e ylberit në kushtet e klasës në një ditë me diell etj.

- **Përralla “Balona e ketyrit Tyty”** u mëson fëmijëve të ruajnë librat dhe t’i mbajnë ato me kujdes. Me ndihmën e të rriturve fëmijët ndërtojnë nga një balonë dhe zhvillojnë një garë se balona e kujt do të fluturojë më lart. 3 fituesit marrin edhe nga një dhuratë të veçantë.
- **Bisedë për botën e pasur nënujore.** Fëmijët mësojnë për gjallesat që jetojnë në ujë, për vlerat ushqimore që ka konsumimi i prodhimeve të detit etj. Në tëkuadër fëmijët luajnë lojen “**Rrjeta dhe peshqit**”. Fëmijët mund të diskutojnë se çfarë u pëlqen më shumë një peshk apo një breshkë uji. Fëmijët mësojnë se vendiemt merren kur njerëzit bien dakort. Në rast se jo, atëherë ata votojnë. Situata të tillë mund të përdoren kur fëmijët ndodhen në dilema apo kanë vështirësi për të zgjedhur.

VERA NA FTON NË PUSHIME



Specifikat e punës në muajin qershor

Njohja me karakteristikat e stinës së verës. Krenaria për arritjet, mirënjohja për mësuesin/en dhe gatishmëria për në klasën e parë

Muaji qershor nis me festën e fëmijëve. Së bashku me prindërit organizohet një festë ku fëmijët gjëzojnë dhe shprehin dëshirat e tyre. Qershori sjell përfundimin e viti shkollor dhe fillimin e pushimeve verore. Është koha që fëmijët të gjëzojnë për arritjet e tyre, të festojnë dhe të tregojnë për ditët më të bukura, ngjarjet më të rëndësishme që kanë kaluar në shkollë. Ata tregojnë për gjërat që u kanë pëlqyer më shumë, për ndryshimet që vënë re te vetja etj. Gjithashtu, në këtë muaj fëmijët njihen me karakteristikat e stinës së verës.

Temat javore për muajin qershor janë parashikuar të jenë:

- Karakteristikat e stinës së verës
- Krenohemi për arritjet tonë
- Gati për në klasën e parë

Java e parë do t'i kushtohet **karakteristikave të stinës së verës** dhe planeve për organizimin e pushimeve verore.

Java e dytë. do t'i shërbejë **rikujtimit dhe përsëritjes të veprimtarive** të zhvilluara gjatë gjithë vitit shkollor. Është koha që fëmijët të reflektojnë dhe të vlerësojnë arritjet e tyre.

Në javën e tretë fëmijët përgatiten për **kalimin nga klasa përgatitore në klasën e parë** dhe përgjegjësitë e reja që i presin fëmijët si nxënës shkolle.

Rezultatet e të nxënësit sipas lëndëve

Rezultatet e të nxënësit janë dhënë sipas lëndëve, ashtu si janë renditur ato në planin mësimor. Siç vihet re, rezultatet e të nxënësit edhe pse këtu jepen të specifikuara për lëndët, në aktivitetet e parashikuara ndërthurën më shumë se 1 rezultat lëndor.

Gjuhë shqipe

Fëmija:

- Përshkruan një ditë vere.
- Dallon karakteristikat e verës dhe përshkruan motin në këtë stinë.
- Flet për pushimet verore dhe shpreh dëshirën për vendet ku do t'i kalojë.
- Përshkruan ngjarjet që i kanë lënë mbresë.
- Flet për ndryshimet që vë re te vetja dhe tregon si ndihet tani që shkolla po mbaron.
- Përshkruan veprimtarinë që i ka pëlqyer më shumë.
- Dallon, drejtshqipton, lexon dhe shkruan shkronjat Z, Zh.

Edukata figurative

Fëmija:

- Realizon vizatimin e fundit ku shpreh si ndihet

- Përgatit një punim për t'ia dhuruar mësuesi/jat si kujtim.
- Përzgjedh puniemt më të bukura dhe tregon çfarë pëlqen te to.

Edukata muzikore

Fëmija:

- Gjen titullin e filmit të njojur për fëmijën duke u nisur nga muzika që dëgjon.
- Këndon këngën “4 stinët e vitit”.
- Shpreh me vizatim karakteristikat e secilës stinë që përmenden në këngë.

Matematika

Fëmija:

- Përsërit numrat deri në 10 dhe veprimet me mbledhje e zbritje deri në 10.
- Zgjidh situata të thjeshta problemore
- Rendit muajt dhe stinët e vitit

Natyra dhe njeriu

Fëmija:

- Dallon ndryshimet që ka pësuar trupi gjatë një viti shkollor.
- Tregon karakteristikat themelore të stinës së verës.

- Përshkruan ndryshimet e motit gjatë stinës së verës.

Shoqëria dhe mjedisi

Fëmija:

- Argumenton në mënyrën e vet vendimet e tij/saj gjatë lojës dhe aktiviteteve të tjera të përditshmërisë (luaj futboll sepse me pëlqen, luaj basketboll pasi po luajnë edhe shokët e mi etj).
- Përshkruan emocionet e veta për dhe në situata të ndryshme jetësore.

Edukata fizike

Fëmija:

- Tregon shkathësi dhe vëmendje gjatë zhvillimit të lojës.
- Dallon mjediset e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike.
- Shpreh kreativitet me lëvizje, fjalë dhe kombinime të ndryshme
- Praktikon ushtrime të thjeshta ritmike me dhe pa mjet.
- Shfaq emocione përmes lojës

Shkathësi për jetën

Fëmija:

- Krijon punime te ndryshme duke përdorur materiale ricikluese (materiale natyrale, artificiale).

Projekti i muajit

Projekti i fundit i vitit lidhet me **stinën e verës**. Fëmijët punojnë dhe realizojnë projektin me ndihmën e të rriturve. Pjesë e projektit është edhe kalimii nga klasa përgtitore në klasën e aprë.

Përsa i takon mësimit të shkronjave, aktiviteti i fundit është fleta A3 “Luaj me shkronja nga V-Zh” me kartelat e shkronjave.

Planifikimi i temave për muajin qershor “Vera na fton në pushime”

	Java 1 Karakteristikat e stinës së verës	Java 2 Krenohemi për arritjet tona	Java 3 Gati për në klasën e parë
Gjuhë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> Natyra dhe moti në verë Vjersha “Stinët e vtitit” (<i>Fq. 82</i>) Frutat dhe perimet e stinës Veshjet e stinës Tregimi “Fëmijët dhe delfini” (<i>Fq. 86 - 87</i>) Shkronja Z (<i>Fq. 80 - 81</i>) Shkronja Zh (<i>Fq. 84 - 85</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> Gjërat dhe ngjarjet që do të mbaj mend gjatë; Një ngjarje e paharruar Çfarë më ka bërë për të qeshur Loja dhe aktiviteti që më kanë pëlqyer më shumë Një kujtim për mësuesin/en time dhe për shokun/ shoqen tim/e 	<ul style="list-style-type: none"> Krenohem për arritjet e mia; Dosja ime e punës Vjersha “Kukulla ime” (<i>Fq. 88</i>) Vizitë në klasën e parë Vjersha “6 vjeç i mbusha” Shkronjat që mësova (<i>Fq. 90 - 91</i>) Faleminderit mësues/e! (<i>Fq. 94 - 95</i>)
Edukatë figurative	Punimi im më i bukur	Mjetet e plazhit. Çanta e plazhit, Pandoflat e plazhit dhe kostumi i plazhit	Vizatimi im i fundit për këtë vit
Edukatë muzikore	Dëgjoj muzikën dhe dalloj titullin e filmit	Kënga “4 stinët e vtitit”	Kënga “Tring zilja, zilja tringëllon”

Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> • Renditja e ditëve të javës • Renditje e muajve të vitit • Renditja e stinëve të vitit • Në fillim, pastaj, në fund (<i>Fq. 83</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përsëritje deri në 10 • Ndërtime me forma gjeometrike • Ndërtime me trupa gjeometrikë • Situata problemore (<i>Fq. 83</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> • Lëviz sipas drejtimit • Numrat dhe format që mësova (<i>Fq. 92 - 93</i>) • Matem me metër: Më i gjatë se/ më i shkurtër se/ po aq i gjatë; Peshohem me peshore: Më i rëndë se/ më i lehtë se/ po aq i rëndë • Dje, sot, nesër
Dituri natyre	<ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e stinës së verës 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet që vërejmë në trupin tonë nga shtatori deri në qershori 	<ul style="list-style-type: none"> • Itinerari shkollë-shtëpi
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> • Të bësh zgjedhjen e duhur. Të marrësh një vendim të drejtë 	<ul style="list-style-type: none"> • Ngjarjet më të bukura të këtij viti. 	<ul style="list-style-type: none"> • Emocionet e përjetuara në ditë dhe ngjarje të caktuara
Edukata fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Higjiena personale gjatë stinës së nxehëtë të verës; Notoj si peshk. Ngrihem si delfin. Notoj si bretkosë 	<ul style="list-style-type: none"> • Kërcime me litar • Lojëra me top 	<ul style="list-style-type: none"> • Lojë “Vigani shkurtabiqi” • Qëndrimi i trupit në bankë

Shkakhtësi për jetën	<ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet që mund të zhvilloj në plazh 	<ul style="list-style-type: none"> Krijime të ndryshme me materiale të riciklueshme: natyrale dhe artificiale 	<ul style="list-style-type: none"> Çanta dhe mjetet e shkollës
Anglisht	Likes and dislikes	Fruits	My teacher and peers
Pjesa zgjedhore	Të mirat e çdo stine	Abetarja është shtëpia e shkronjave	Mbresa nga ky vit

Veprimitari mësimore për muajin qershor

- **Shëtitje në natyrë.** Për t'u njohur me karakteristikat e stinës së verës fëmijët dalin dhe shëtitin në vendin ku kanë shkuar edhe për stinët e tjera të vitit. Ata dallojnë dhe përshkruajnë ndryshimet që vënë re në natyrë duke nisur me motin, me frutat që po piqen në pemë, me kohën e ngrohtë me pemët që janë embushur plot gjethë, me veshjet, me ditën e gjatë, me lojërat në antyrë etj. Me mbarimin e shkollës fëmijët nisin pushimet verore dhe secili mund të bëjë parashikime dhe të shprehë dëshira përvendet ku do të donte t'i kalonte ato. Me fëmijët diskutohet edhe siguria në ujë, sepse janë të vegjël dhe duhet të përdorin mjetet mbrojtëse. Për këtë çështje shërben tregimi "Fëmijët dhe delfini". Për se cilat nga vendet ku mund t'i kalojnë pushimet, fëmijët tregojnë për anët e tyre të mira, për lojërat dhe aktivitetet ditore që zhvillojnë me familjen dhe shokët e rindë zënë.
- Në ditët e mbeturat të qershorit fëmijët do të rikujojnë vjershat dhe përrallat e mësuara gjatë vitit, do të zgjedhin personazhet që u kanë pëlqyer më shumë, do të tregojnë për bisedat dhe temat e preferuara, lojërat dhe veprimtaritë më të dashura. Fëmijët shfletojnë dosjen e punimeve të tyre dhe kujtojnë situata që lidhen me realizimin e tyre. Një aktivitet i rëndësishëm që duhet zhvilluar me fëmijët është diskutimi me se cilin prej tyre përmendimin që kanë përvendet e tyre, çfarë vlerësojnë më shumë te përpjekjet që kanë bërë përvendet ta mbushur, të vlerësojnë punën e kujdeshme dhe rregullsinë e dosjes dhe kujdesin që do të tregojnë përvendet ruajtur atë. Momentë të bukura përfëmijët do të jetë rikuji i rasteve kur kanë marrë certifikata vlerësimi, duke përshkruar si janë ndierë atëherë dhe si ndihen tanë.
- **Vjershat** "Kukulla ime" dhe "6 vjeç i mbusha" kanë lidhje me kalimin e fmërijeve në klasën e parë. Fëmijët mund të shkojnë në klasat e para, të takohen me nxënësit dhe të bisedojnë së bashku. Ndoshta në ditët e fundit të shkollës fëmijët mund të zhvillojnë një veprimitari, lojë me fëmijët e klasës së parë. Kur fëmijët e zhvillojnë klasën

përgatitore në mjediset e shkollës, kalimi i tyre në klasën e parë është më i butë dhe fëmijët ambientohen më lehtë në shtator.

- Në përfundim të vitit shkollor organizohet një festë me fëmijët dhe prindërit për të falenderuar dhe shprehur mirënjohe për gjithçka që është bërë gjatë një viti.

KAPITULLI IV – NË NDIHMË TË MËSUESIT

Në këtë pjesë të Librit të mësuesit janë dhënë sqarime, modele fleta punësh, përrallat dhe tregimet e plota, alfabeti i gjuhës së shenjave etj.

Simbolet dhe kuptimi i tyre

Në fletët e punës të librave të fëmijëve janë përdorur simbole, të cilat lehtësojnë të kuptuarin e kërkesave dhe të veprimeve që do të kryejnë fëmijët.

Ky simbol është dhënë për t'u plotësuar nga vetë fëmija, nga një shok/shoqe ose nga mësuesi/ja.

- *A të pëlqeu përralla/tregimi?*
- *Si ndihesh?*



Herë-herë simboli përmban një pyetje së cilës duhet t'i përgjigjet fëmija, duke shprehur mendimin e vet:

Më pëlqen/ Shumë mirë	Nuk e di	Nuk më pëlqen/ Jo mirë



Ky simbol tregon që fëmija do të vizatojë.



Ky simbol tregon që fëmija do ta ngjyrosë vizatimin që ka bërë.



Ky simbol tregon që fëmijët të dëgjojnë këngën e dhënë në adresën e internetit dhe më pas të plotësojnë fletën e punës. Këngët dhe pjesët muzikore janë përzgjedhur me qëllim didaktik dhe në funksion të përmbajtjes së temave mësimore. prej tyre, mësuesi/ja mund të zhvillojë biseda të mëtejshme me fëmijët.



Ky simbol tregon që fëmijët do të përqendrohen në dëgjimin e pjesës që do të lexohet nga i rrituri.



Ky simbol tregon që fëmijët pas dëgjimit të kërkesave do të shkruajnë.



Ky simbol tregon që fëmijët duhet të shohin figurat dhe t'i komentojnë ato.



Ky simbol tregon që fëmija të qarkojë/rrethojë sipas kërkesës që dëgjon.



Ky simbol tregon që fëmijët dëgjojnë vjershën/kërkesën etj., dhe pastaj veprojnë.



Ky simbol tregon që fëmijët duhet të bëjnë lidhje të objekteve me njëra-tjetrën.



Ky simbol tregon që fëmijët mund të ngjisin fotografi nëse nuk munden të vizatojnë.

Alfabeti i gjuhës së shenjave

Secila shkronjë e alfabetit është shoqëruar me gjuhën e shenjave, që tregon se si i kuptojnë shkronjat fëmijët që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin.



A



B



C



Ç



D



DH



E



È



F



G



GJ



H



I



J



K



L



LL



M



N



NJ



O



P



Q



R



RR



S



SH



T



TH



U



V



X



XH



Y



Z



ZH

Përrallat, tregimet dhe fabulat

Arushi që dinte të thoshte vetëm "Mirëmbrëma"

Na ishte njëherë një arush, që e kishte emrin Dudush. Një mëngjes plot diell, arush Dudushi doli nga strofka e tij për të lozur në lëndinën e pyllit. Rrugës, përmbi degën e një pishe, pa dy ketrushë.

- Mirëmbrëma! - i përshëndeti arush Dudushi.
- Hi-hi-hi! - qeshën ketrushët. - Dudushi që në mëngjes po i thotë këmbës dorë. Hi-hi-hi!...

Dudushit nuk i erdhi mirë që ketrushit u tallën me të.

"Nuk do t'i përshëndes më!", - tha me vete. Ec e ec, takoi rrugës teze Sorkadhen.

- Mirëmbrëma! - i tha Dudushi teze Sorkadhes. Po ajo bëri sikur nuk e dëgjoi.

"Kjo teze Sorkadhja, qenka mendjemadhe", - tha me vete Dudushi.

Ec e ec, takoi rrugës zogun Fazan, që pastronte me sqep pendët, nën rrezet e ngrohta të diellit. Arush Dudushi, me buzën në gaz, i tha atij që nga larg:

- Mirëmbrëma, Fazan!

Fazanit iu duk se Dudushi u tall me të, prandaj mori inat dhe i tha:

- Natën e mirë, Dudush! - dhe hop i ktheu krahët.
- Ky Fazani qenka budalla! - murmuriti Dudushi. - Unë i them mirëmbrëma, e ai më thotë natën e mirë!"

Ec e ec, takon rrugës babagjysh Ariun, që kishte shkuar në pyll për të gjetur mjaltë.

- O babagjysh! - iu ankua arush Dudushi. - Unë u them të tjerëve "Mirëmbrëma!", por ata s'më kthejnë përgjigje.

Babagjysh Ariu buzëqeshi, i hodhi Dudushit dorën në qafë dhe tok me të u ul në një ledhë buzë pyllit. Filloi t'i shpjegonte arush Dudushit gabimin e tij... Si thoni ju, çfarë i tha pastaj Dudushi babagjyshit?

Që lepurushi të mos dëmtohet

Mësuesja ua dha fëmijëve të gjitha lodrat që ishin në rafte, por për çudi lodrën më të bukur e më të re, lepurushin e madh, të bardhë e me sy prej qelqi të kuq nuk iu dha kujt. Atëherë Agimi, një djali i shkathët që shpresonte të luante me atë lodër, iu afrua mësueses e i tha:

- Unë s'kam luajtur asnjëherë me lepurushin e madh.
- Me gjithë qejf do ta jepja lepurushin që të luanit bashkë, por sot ai është i sëmurë, - ia priti mësuesja.
- Si qenka i sëmurë? - pyeti i habitur djali! - Si, nuk është kafshë e gjallë?!

Duke thënë këto fjalë Agimi pa me vëmendje nga lepurushi. Vërtet ai i gjori ishte sëmurë?

- Sot lepurushi ishte me një vesh, kurse bishtin nuk e kishte fare.
- Kush do t'ia ketë këputur? - pyeti veten Agimi. Edhe fëmijët e tjerë që ishin larg e vunë re që lepurushi ishte me një vesh dhe pa bisht. Lodra e gjorë ishte hedhur përmbyss në një kënd të raftit dhe dukej sikur po qante dhe ulërinte nga dhimbja. Oh, i mjeri lepurush! Cili ishte ai që ia kishte punuar ashtu? - psherëtinë fëmijët. Por askush nuk u përgjigj.

Mësuesja që dukej më e mërzitur e mori lepurushin në duar dhe pyeti fëmijët:

- Cili prej jush e ka katandisur kështu këtë kafshë kaq të bukur?
- Unë jo, - tha Donika. - As unë, - foli Artani. Të tjerët ngritën supet si të thoshin: -Nuk e dimë!
- Fëmija i mirë duhet të thotë gjithmonë të vërtetën! - tha mësuesja. - Tani shkon e luani.

Zemërthyer fëmijët u përhapën nëpër sallën e madhe dhe nisën të lozin me lodrat e tyre. Herë pas here shikonin nga vendi ku ishte lepurushi dhe gëzimi që ndjenin duke luajtur u pakësohej. A ishte e mundur që fajtori të mos tregonte fajin e vet? Mësuesja shkon nga një fëmijë tek tjetri dhe u tregonte se si të luanin më mirë. Kur iu afrua Donikës dhe Artanit,

ajo vuri re se ata e mbanin kokën të ulur dhe qëndronin si të ngrirë. Mësuesja ndali përpara tyre dhe u përkëdheli flokët, por befas Donika zuri të qajë. S'vonoi shumë dhe Artani mbushi sytë me lot.

- Pse qani? - pyeti mësuesja duke u ulur në një karrige aty pranë.

Vuri Donikën mbi njërin gju dhe Artanin në tjetrin. Nxori një shami të vogël dhe u fshiu lotët dhe duke u dhënë zemër u tha:

- Mos keni frikë, tregoni si ngjau.

Dhe fëmijët duke mërmëritur i treguan se si kishte ngjarë.

Dje kur të gjithë dolën të luanin në oborr ata të dy ndjenjën brenda. Kishin dëshirë të luanin me atë lodrën e re që ishte shtuar në raftin e parë. Pa marrë leje te mësuesja ata u vërsulën te lepuri i madh. E hoqëm nga rafti u hodhëm mbi të dhe nisëm të kacafyteshin.

- Është lepuri im, - bërtiste Donika,

Jo, jo është i imi thoshte gjithë inat Artani. Më në fund Donika e zuri lepurin nga veshi dhe nisi ta tërhiqte me forcë. Ajo do t'ia kishte marrë lepurushin Artanit, por edhe Artani e kishte zënë kafshën e gjorë nga bishti.

- Lëshoje, - thërriste Donika. - Lëshoje ti, - ulërinte Artani. Tërhiq njëri e tërhiq tjetri, "trak" u këput veshi. Donika atëherë u hodh e kapi lepurushin nga veshi tjetër, por pasi e tërhoqi u dëgjua përsëri trak, e kësaj here ishte këputur bishti. Në atë çast dikush po vinte në dhomë. Donika dhe Artani ia kishin mbathur këmbëve, kurse lepurushin e kishin lënë përdhe.

- Unë çdo lodër do ta ruaj e s'do ta prish kurrë tha në fund Donika.

- Edhe unë s'do t'i prish lodrat, - tha Artani.

Mësuesja thirri të gjithë fëmijët dhe Donika me Artanin premtuan para tyre se do të kujdeseshin që lodrat e kopshtit t'i ruajnë jo vetëm për vete, por edhe për shokët që do të vinin pas tyre.

Fjalët e Donikës e të Artanit u pëlqyen shumë edhe nga fëmijët e tjerë. Të gjithë vendosën që nga sëmundja e lepurushit të nxirrnin mësimin.

Të luajmë me lodrat, por të mos i prishim.

Edhe ti Beni do të rritesh

Na ishte një djalë i vogël, i vogël, sa as derën e dhomës nuk e hapte dot. Ngrihej në majë të gishtave, e prekte pak dorezën, por i ladheshin këmbët, i lodhej edhe dora. Varte buzët dhe thërriste: "Hapeee, mamiii, hape!". Ky djalë e kishte emrin Beni. Benit i pëlqente të bëhej si babi. Një ditë, a e dini se ç'ndodhi me të? Hapi sirtarin e komosë, mori veglat e rrojës së babit dhe shkoi te lavamani. Lëvizi kapakun e pastës dhe e shtypi atë me dorë. Që atje doli një gjë e bardhë, që zgjatej e përdridhej. Ai e vuri atë në të dyja faqet. Kapi furçen dhe e lëvizi mbi faqe. Po ajo s'po bënte shkumë. Atëherë Beni u kujtua se duhej uji. Mori safën dhe çap-çup eci drejt çezmës. Por, më kot. Ai s'e arrinte dot rubinetin. E vështroi atë me dëshpërim. Pastaj rrotulloi sytë nëpër dhomë. Më në fund pikasi çajnikun. E zbrazi çajin në enën e vogël të rrojës, futi furçen brenda dhe zuri ta fërkonte atë sipër pastës. Pasta shkumëzoi, por Beni nuk e shihte. Atij i mungonte edhe pasqyra. Ajo ishte varur mbi mur. Beni as atë nuk e arrinte dot. Po. Punë e madhe. Ai mund të bënte edhe pa pasqyrë. Vazhdoi të lëvizte furçen. Papritmas, ndjeu diçka të hidhur në gojë. Ishte shkuma e bardhë. Beni e fshiu me mëngën e trikos. Por, shpejt furça i preku syrin. Ai për pak qau. Por, e mbajti veten. Shkoi makinën e rrojës në faqe, po në çast ia dha piskamës me të madhe: "Mami, o mami!". Një vijë e hollë gjaku rrëshqiti sakaq poshtë faqes. Beni qau me zë aq të lartë, saqë e dëgjoi e ëma që ishte në ballkon. Ajo rendi tek i biri dhe kur e pa vuri duart në kokë:

- Ua, ua! Ç'paske bërë, more!

- E përfshiu Benin nga mesi, ia lau fytyrën shpejt në çezmë dhe ia leu me jodio vendin e prerë. Kur erdhi babai në shtëpi, mami ia tregoi të gjitha. Beni uli kokën i zënë në faj. Babit i erdhi keq. Ai hapi një album dhe zuri t'i thoshte Benit:

- I shikon këto fotografi? Këtu ka dalë babi kur ishte bebe; këtu – kur ishte çun i vogël sa ti sot; këtu është burrë i madh. E shikon? Edhe ti, Beni. Do të rritesh e do të bëhesh i madh sa babi. Atëherë do të punosh si babi... Atëherë do të përdorësh veglat e rrojës, kurse tani je i vogël.

Beni e dëgjonte babin si me habi dhe heshtte.

- Merr tani bicikletën me tri rrota dhe eja të dalim shëtitje! – i tha pas pak babi.

Benit i ndritën sytë sakaq. Vuri buzën në gaz dhe u sul tek bicikleta. Ai nuk do ta bënte kurrë më atë gabim.

Vjeshta e artë

Na ishte njëherë një vajzë e vogël që jetonte në një qytet me pak pemë dhe nuk e kishte parë kurrë vjeshtën e artë. Kur dëgjoi të flisnin për të, pyeti të atin: – Është tamam e artë?

- E artë, e artë! – u përgjigj i ati. Dhe fëmija mendoi: "Ndonjëherë do të shkoj atje u ndodhet vjeshta e artë. Do të marr pak ar dhe do të blejë me të 7 kukulla.".

Babai i foli asaj edhe njëherë tjetër për vjeshtën e artë dhe vajza e pyeti:

- Je i sigurt që është e tëra e artë?

- E tëra e artë, e tëra e artë! – iu përgjigj i ati.

Dhe fëmija mendoi me vete: "Ndonjëherë do të shkoj atje ku gjendet vjeshta e artë, do të marr pak nga ky ar dhe do të blej 30 kukulla, një kukull për çdo ditë të muajit.".

Njëherë tjetër mendoi: "Ndoshta do të marr pak më tepër nga ky ar dhe do të blej 365 kukulla, një për çdo ditë të vitit.".

Më në fund një të diel, babai i tha:

- Eja, eja, do të shkojmë të shkojmë vjeshtën e artë! Babai e nxori jashtë qytetit nëpër pyje dhe nuk i tha asgjë. Vajza shikonte e mrekulluar pemët e praruara, të gjitha ato miliona, e miliona e miliona gjethe ngjyrë ari, të verdhë në të kuqe, të verdhë të celët, të verdhë të errët, të kuqe të celët, të kuqe të errët. Tërë ditën eci nëpër pyllin e artë, duke luajtur me gjethet, duke përkëdhelur ketrat që vinin të merrnin lajthitet nga dora e saj. Dhe ishte kaq e kënaqur, sa i harroi 7 kukullat, 30 kukullat dhe 365 kukullat, sepse çdo gjethe i dukej më e bukur se të gjitha kukullat e botës.

Iriqi dhe mollët

Një ditë iriqi gjembaç kishte dalë nga strofka e tij për të gjetur ushqim. Bëri një copë udhë dhe u ndal në një pemë. Vendi qe mbushur me mollë të vogla që kishin rënë nga era. Sa mirë tha me vete iriqi gjembaç. Tani do të mbush barkun, do t'u çoj edhe shokëve. Dhe ashtu bëri. Filloi të hante i uritur. Mollët ishin të shijshme. Hëngri sa hëngri, mendoi dhe për iriqët e tjerë. Po si t'i merrte mollët. Në gojë ai mund të mbante vetëm një kokërr. Atëherë u kthyte me kurriz nga toka. Trupi iu mbush me mollë. Kur arriti te strofka, njëri nga iriqët thirri: – Erdhi iriq gjembaçi plot me mollë. Të gjithë iu afroan. Morën nga një mollë dhe filluan të hanin. Iriq gjembaçi shikonte i kënaqur shokët e tij.

Gjethja e pemës që donte të rrinte vetëm në degë

Na ishte një gjethe peme. Kjo gjethja e pemës i tha një ditë erës:

- Erë, moj erë! Eja e këputi të gjitha gjethet! Më lër vetëm mua në degë! Këto më mërzisin. Shushurijnë shumë.
 - Mirë, i këpus, po se mos pendohesh?
 - Jo, jo, nuk pendohem!
 - Vuuu-vuuu! – fryu era dhe i këputi të gjitha gjethet: kërtap e kërtap e kërtap! Dhe pastaj iku prapa malit.
- Ra rrezja e diellit mbi gjethen.

- Obobo, më dogje! - i tha gjethja rrezes.
- Jo, nuk të dogja, po je vetëm, prandaj e ndjen kaq fort nxehësinë time. Qëparë ishte me shoqe plot. Ato shushurinin dhe të freskonin. Tani që unë bie drejt mbi ty, ti do të digjesh vërtet.

- Kështu qenka?!

- E, kështu!

U pendua gjethja dhe thirri erën:

- Erë, moj erë! Eja e më sill shoqet, se po digjem!

Po era nuk ia sillte dot prapë. E shkreta gjethe, që donte të rrinte vetëm në degë! U dogj e u përvëlua fare!

Të vishemi sipas stinës

Kur erdhi vjeshta, nëna lau hekuosi dhe vuri në dollap rrobat e verës.

- Tani, - i tha ajo, - do të vishemi me rroba të trasha se fillon të ftohtit.

- Po sandalet, a do t'i mbathim? - e pyeti Vjollca e vogël.

- Jo tha nëna, - tani nisin shirat e këmbët vishen me çorapë e me këpucë, që të rrinë ngrohtë, kurse sandalet do t'i mbajmë për verën tjetër. Mirëpo Vjollcës nuk i pëlqenin këpucët. Ato ishin pa vrima e lulka dhe të rënda, kurse sandalet ishin të lehta si pupël dhe oh sa të bukura. Ato ishin të kuqe dhe me rripa të bardhë.

- Këto do të mbath, - mendoi Vjollca, - dhe u nis për në kopsht me sandalet e kuqe. Kur po dilte nga kopshti filloj shiu. Rruga u mbush me pellgje të vogla me ujë. Sandalet njështeshin në baltë pllaq e lluq dhe mezi shqiteshin. Njërsës këmbë iu këput rripi. Vjollca filloj ta tërhiqte këmbën zvarrë se sandalja i dilte nga këmba. Ajo nuk mund të ecte shpejt. Këmbët iu bënë akull të ftohta. Ajo kur arriti në shtëpi ishte lagur e tëra që nga majë e kokës.

- Ua-ua si ke dalë kështu në mot të keq moj çupë, - e qortoi eëma.

- Si s'të vura re kur dole nga dera. Ajo e ndërroi Vjollcën, por megjithatë asaj i filluan t'i digjnin grykët. Në mbrëmje i hipi temperatura...

Ja pse duhet të vishemi sipas stinës!

3 derrkucët

Na ishin njëherë tre derrkucë. Kur u rritën, secili donte të jetonte në shtëpinë e vet. Mama dosa u dha një këshillë:

- Derrkucët e mi të dashur, erdhi koha që ju të jetoni më vete. Por kujdes, ndërtoni shtëpi të forta që të mbroheni nga ujku i rrezikshëm.

Të tre derrkucët u nisën për të ndërtuar shtëpinë e vet.

Derrkuci i parë e ndërtoi shtëpinë shumë shpejt. Ai mori fije kashte nga fusha dhe ndërtoi një shtëpi prej kashte. Nuk kaloi shumë dhe ujku iu afrua shtëpisë së derrkucit dhe i kërkoi të hynte brenda. Derrkucit iu kujtuan fjalët e dosës dhe nuk ia hapi derën. Ujku i madh mori frymë thellë, shfryu fort dhe ia prishi shtëpinë derrkucit të vogël. Derrkuci i vogël vrapi me një frymë në shtëpinë e vëllait të dytë, i cili e kishte ndërtuar shtëpinë me dru pylli.

Nuk vonoi shumë dhe ujku mbërriti pranë shtëpisë prej druri. Ai u kërkoi të dy derrkucëve të hapnin derën që ai të hynte brenda. Derrkucët nuk pranuan. Ujku i madh mori frymë thellë, shfryu fort dhe e prishi shtëpinë prej druri. Të dy derrkucët të trembur shumë vrapanuan për në shtëpinë e vëllait të tretë.

Ai e kishte ndërtuar shtëpinë me tulla. Derrkucët i treguan vëllait për frikën që kishin nga ujku. Nuk kaloi shumë dhe zëri i ujkut ua ndërpree bisedën tre vëllezërve. Ai u kërkonte derrkucëve të hapnin derën që të hynte brenda, por ata nuk pranuan. Atëherë, ujku i madh mori frymë thellë, shfryu fort, por për çudi shtëpia prej tulle nuk u prish. Mori frymë thellë dhe shfryu fort, por përsëri nuk ia doli mbanë. Ujku i madh ishte shumë i uritur. Ai mendoi të futej nga oxhaku i

shtëpisë. Kur derrkucët panë ujkun të hipte mbi çati, ndezën një zjarr të madh, vunë një tenxhere shumë të madhe me ujë dhe pritën që ujku të binte brenda. Derrkucët ia arritën qëllimit.

Që nga ajo ditë, ata jetuan të lumtur së bashku në shtëpinë me tulla.

Kotelja e zezë që donte të ishte e gjitha e bardhë

Në një shtëpi të madhe jetonte e gjithë familja e Macebardhave. Gjyshërit, prindërit e fëmijët ishin të gjithë të bardhë si dëbora. Pas disa kohësh, familja e Macebardhave u shtua me pesë kotele të reja. mes tyre lindi edhe një kotele e zezë. Të gjithë u habitën edhe pse e donin shumë kotelen e zezë. Macja nënë e lëpinte dhe e lëpinte kotelen e zezë pa pushim, por ngjyra e saj nuk ndryshonte.

Kotelet luanin dhe kënaqeshin me njëra-tjetrën, kapeshin nga veshi, nga bishti e nga këmbët dhe kalonin shumë orë duke luajtur dhe duke qeshur. Ditët kalonin dhe kotelet rriteshin. Kotelja e zezë filloi të kuptonte se ishte ndryshe nga vëllezërit, motrat dhe kushérinjtë e saj. Herë-herë sytë e saj mbusheshin me lot. Kur luanin lojën “Hapa-dollapa”, ajo gjithmonë zbulohet e para.

Një ditë kotelja e zezë u ul pranë një peme dhe filloi të vriste mendjen. Ajo donte ta ndryshonte ngjyrën e trupit. Po si t’ia bënte? Mendja i shkoi të lyhej me miellin e bardhë dhe ashtu bëri. Priti sa erdhi nata, vajti te dollapi ku mami mbante miellin dhe filloi të lyhej nga koka tek këmbët. Nga ana tjetër, pjesëtarët e familjes mërziteshin që kotelja e zezë vuante nga ngjyra e trupit të saj. Ata e donin shumë, silleshin njëlloj si me kotelet që ishin të gjitha të bardha, por kjo nuk i mjaftonte koteles së zezë. Po atë natë, ata u mblodhën së bashku dhe vendosën të lyheshin me qymyr e të bëheshin të gjithë të zinj si kotelja e zezë. Pra, në një cep të shtëpisë kotelja e zezë po lyhej me miell për t’u bërë e gjitha e bardhë, në cepin tjetër të gjitha macet e bardha po lyheshin me qymyr për t’u bërë të gjithë të zeza. Macet e bardha, që u bënë të gjitha të zeza, shkuan në kuzhinë për t’i bërë një surprizë maces së zezë, por nuk e gjetën. Aty panë një mace të gjithën të

bardhë, nga mustaqet deri te bishti. Macet ndaluan dhe po shihnin me habi njëra-tjetrën. Kotelja e zezë, që ishte e gjitha e bardhë, mjaulliti dhe macja nënë e njohu të voglën e saj.

Të gjithë sa ishin të pranishëm filluan të qeshnin, të luanin e të kërcenin mbi njëri-tjetrin. Pluhuri i miellit u bashkua me pluhurin e qymyrit dhe tashmë nuk kishte më mace të gjitha të bardha apo të gjitha të zeza. Vetëm mace ngjyrë gri.

Bredhi i vogël

Na ishte një herë një bredh i vogël që nuk ishte kurrë i kënaqur. Të gjitha pemët rreth tij kishin gjethë të bukura të gjelbra. Ai i kishte gjethet e holla si gjilpërë.

Bredhi pshérëtin:

- Sa do të dëshiroja t'i kisha të gjitha gjethet prej xhami, që të shkëlqenin.

Të nesërmen në mëngjes, kur u zgjua ai nuk njihej më.

- Sa i kënaqur jam, - thoshte bredhi, - më kanë dhënë gjethet prej xhami që unë dëshiroja, - dhe të gjitha pemët këndonin me krahët e tyre.

Por kur ra nata, era fryu me tërbim dhe të gjitha gjethet prej xhami ranë dhe u bënë copë e çikë.

Dhe bredhi i vogël, gjithë i zhveshur qante: - Oh, m'u thyen të gjitha gjethet e bukura prej xhami! Sa do të dëshiroja të kisha gjethë të bukura, të gjelbra dhe të përkulshme si gjithë pemët e tjera, ato nuk do të thyheshin më!

Të nesërmen në mëngjes kur zgjohet, ai nuk njihet më.

- Sa i kënaqur jam, - thoshte ai, - më kanë dhënë gjethë të përkulshme që unë dëshiroja!

Dhe të gjitha pemët këndonin me krahët e tyre. Por një ditë, dhia ndaloi me kecat e saj: - Shikoni të veglit e mi, hani këto gjethet e reja, i hani të gjitha.

Kërcyen dhe bënë kollotumba, kecat e vegjël i këputën të gjitha gjethet dhe nuk lanë asnë.

Dhe bredhi i vogël, gjithë i zhveshur qante:

- Oh m'i hëngrën të gjitha gjethet e mia të përkulshme. M'i thyen të gjitha gjethet e mia prej xhami. Sa fatkeq që jam! Sa do të dëshiroja të gjeja gjethet e mia të holla si gjilpëra dhe të forta!

Cili hyri brenda në dorëz?

Ishte dimër. **Një djalë i vogël**, duke luajtur me shokët, humbi njérën prej dorashkave të tij.

Një ketër, duke kërcyer hop e hop nëpër pyll, pa dorashkën. "Sa mirë", - mendoi me vete ketri dhe kërceu brenda saj. "Dorashka do të jetë vendi i duhur për strofën time". Ketri u kënaq se brenda ishte shumë ngrohtë.

Një lepurush i vogël kishte humbur rrugën. Sapo e pa dorashkën ai kërceu me hov brenda saj. "Oh, sa ngrohtë qenka këtu!", - mendoi me vete lepurushi.

Dhelpra dinake po ndiqte lepurushin. Ajo u bë kureshtare të mësonte se ku u fut lepurushi. Me kërcim të shpejtë e dinak, u fut brenda në dorashkë. Me pak të shtyra e të shtrënguara dhelpra zuri vend. "Oh, sa ngrohtë qenka këtu!", - mendoi me vete dhe nisi të rehatohej në dorashkë.

Një ari kishte ftohtë. Duke ecur nëpër pyll, ai vuri re dorashkën, që tundej sa andej-këtej. Me pak të shtyra e të shtrënguara, ariu zuri vend brenda në dorashkë. "Oh, sa ngrohtë qenka këtu!", - mendoi me vete ariu dhe nisi të merrej me shokët e rinj.

Një iriq po endej në pyll për të gjetur një vend të ngrohtë. Me të parë dorashkën, ai nxitoi shpejt e shpejt për të hyrë brenda saj. Duke u shtrënguar për të hyrë brenda dorashkës, duke shpuar me gjemba e tij njëra pas tjetrës kafshët, papritur u dëgjua një "Buuum!".

Dorashka u nda në dhjetëra pjesë të vogla, duke i nxjerrë të gjitha kafshët mbi dëborë. "C'ndodhi me djalin e vogël?", - do të pyesë dikush nga ju fëmijë. Kur ai vuri re se i mungonte një dorashkë u kthyte për ta gjetur andej nga kishte kaluar.

Rrugës gjeti copëza prej dorashkës së tij. I habitur u kthye në shtëpi. Ai nuk e mori vesh kurrë se çfarë kishte ngjarë. Vetëm ne e dimë të vërtetën.

Gjyshja e mirë i bëri djalit një palë dorashka të reja me duart e saj të arta.

Miri, njeriu prej bore dhe Viti i Ri

Miri kishte shumë shokët e luante me ta çdo ditë. Mirëpo erdhi Viti i Ri, ra dëborë. U veshën me të bardha çatitë, pemët, rrugët dhe kopshtet. Miri u gjëzua shumë dhe bëri një njeri prej bore. I vuri në kokë një tenxhere të vjetër, në vend të syve dy copa qymyri. Në vend të hundës një karotë, kurse nën sqetull një fshesë të prishur. Me njeriun prej bore Miri u përhumb e u miqësua shumë. Shokët e kërkonin, por ai i harroi fare. Kaluan kështu dy javë. Por koha u ngroh dhe njeriu prej bore u shkri. Miri u dëshpërua dhe filloi të qante, përpara pellgut me ujë që kishte mbetur nga njeriu prej bore. U afrua Viti i Ri i vuri dorën në sup dhe i tha: – O Miri unë e di pse po qan ti, prandaj erdha të të këshilloj. Shokë të rinj zër, por të vjetrit mos i harro. Unë të prura njeriun prej bore, por jo që të braktisësh shokët. Tani merr këtë top llastiku ngjyrangjyra. E kam dhuratë për ty, shko e u thirr shokëve dhe nisni një lojë të bukur së bashku.

Kapelat e Vitit të Ri

Pasdite kur u kthye nga kopshti në shtëpi Dritani gjeti një kapelë prej letre me zbukurime. E vuri në kokë dhe vrapi te pasqyra: – O sa bukur thirri. – Iu sul mamit dhe e përqafoi fort. Të nesërmen u nis gjithë gjëzim në kopsht që t'u tregonte shokëve çfarë i kishte blerë mami. Ata iu mblodhën rreth dhe e vështruan të habitur kapelën e Vitit të Ri të shokut të tyre. – Sa bukur! Po këta numra këtu të Vitit të Ri, – ia thanë fëmijët dhe e provonin kapelën me radhë. Por papritur Dritani kur pa sa u gjëzuan shokët vari kokën. Pse u mërzit vallë? Me t'u kthyer në shtëpi e hodhi kapelën dhe u ngashërye. – Pse vetëm unë të kem kapelë. Unë dua që të kenë dhe shokët e mi, – i tha mamit me lot në sy. Ajo e mbështeti kapelën në

gjoks, mori një tabak letre dhe preu kapela për të gjithë shokët e Dritanit. "Sa mam të mirë që kam", – thoshte Dritani me vete, duke parë kur ajo ngjiste yjet në katroret nëpër kapelat.

– M'i shkruaj pak emrat e shokëve që të di e të mos i ngatërroj kur t'ua jap, – iu lut mamit. Por ti s'di të lexosh. M'i shkruaj, m'i shkruaj nguli këmbë ai. Mami nuk ja prishi qejfin. I shkroi me shkronja të mëdha shtypi. Dhe ai që të mos i ngatërronte i ndau sipas shenjës së zarfit. Sa u gëzuan shokët kur panë Dritanin me gjithë ato kapela. – I kam bërë për ju, – iu përgjigj ai. Fëmijët u grumbulluan rrëth tij dhe duke zgjatur doçkat i thoshin Dritanit: – Më jep një mua, dhe mua... Sytë e vogëlushëve ndrinin dhe zemra e Dritanit rrihte nga gëzimi. Kjo është kapela (emrat e fëmijëve të grupit). Vogëlushët merrnin kapelat duke i soditur prapë e mbarë e buzëqeshnin të lumtur.

Kukulla me makinë të kuqe

Kristina është një nga vajzat e pallatit tim, që dalin çdo ditë për të luajtur. Ajo është vajzë e vetme, por ka shumë dëshirë që mami t'i bëjë edhe një motër.

- Kur do të kem një motër, mami? – pyeste ajo mamin me padurim.
- Po të jetë vëlla? – e pyeste mami.
- Jo nuk dua vëlla, dua vetëm motër!
- Po përse? Vëllai është shumë i mirë.
- Vëllai është çun. Çunat janë shkatarraqë, të prishin lodrat, dinë të luajnë vetëm me makina, – përgjigjet Kristina duke qarë.
- Po kush të ka thënë se çunat janë kështu?!
- E ke parë Besin që nuk di të luajë fare me mua? E ke parë, o mami si bën ai? Vetëm të bërtasë dhe të luajë me makina di. Unë dua një motër që ta kem shoqe edhe në shtëpi.

Kaq thoshte Kristina dhe shkonte të luante me kukullat e saj.

Besi është kushëriri i Kristinës. Sa herë që ai vjen në shtëpinë e saj, merr me vete edhe disa makina të mëdha, që asaj nuk i pëlqejnë fare. Ndonjëherë ata grinden dhe prindërit e tyre lodhen shumë për t'i pajtuar.

Ditët kaluan dhe erdhi koha që Kristina të shkonte për herë të parë në kopsht. Ajo ishte shumë e kënaqur që do të takonte fëmijë të tjera.

- Sa mirë mami, do të njoh shumë shoqe, - tha ajo e gëzuar.
- Edhe shokë do të njohësh, - u përgjigj mami.

Kristina rrudhi buzët. Nuk donte të luante me asnje djalë të kopshtit. E dinte se do të fillonin të ziheshin, të bërtisin, të shtynin e të luanin prapë me makina.

Duke menduar këto gjëra, ajo pa se kishin mbërritur në derën e kopshtit. E përqafoi mamin dhe i dha dorën edukatores. Klasa e saj ishte shumë e bukur. Në mure ishin vizatuar shumë personazhe përrallash, një lëndinë me lule dhe me zogj. Në murin përballë ajo pa të vizatuar edhe një makinë të kuqe, edhe pse makina i kujtoi Besin. I pëlqeu shumë, madje iu duk edhe më e bukur kur pa një vajzë të ulur në timonin e makinës.

Orën e parë të mësimit fëmijët u njohën me njëri-tjetrin. Ata thanë emrat e tyre dhe sa vjeç ishin. Në mes të të gjithëve Kristina vuri re një vajzë që nuk rrinte asnje çast në vend. Ajo fliste vazhdimisht dhe bënte zhurmë.

Pas bisedës, edukatorja hapi lodrat dhe i ftoi të gjithë fëmijët që të merrnin nga një lodër e të luanin bashkë.

Kristinës i pëlqeu shumë një kukull me flokë të verdhë dhe e mori menjëherë. Një dorë e shtyu dhe po të mos ishte mbajtur te një djalë që e kishte emrin Drini, do të ishte rrëzuar.

- Unë jam Teuta, kapitene e anijes dhe urdhëroj që të më bindeni. Që sot të gjithë bashkë do të luftojmë kundër piratëve.

Si tha këto fjalë, vajza me emrin Teuta rrëmbeu një anije me vela dhe filloi të thërriste në të gjithë klasën.

- Lëvizni ushtarë, bindjuni kapitenes suaj! Piratët po vijnë!

Disa vajza dhe djem me sa duket e pëlqyen këtë lojë dhe u përgjigjen:

- Jemi gati. Ku janë?!

Kaq u desh dhe loja filloj. Të gjithë kërkonin të gjenin piratët dhe t'i mundnin ata.

Kristina rrudhi buzët dhe kërkoi një cep të qetë ku të luante me kukullën e saj. Teksa po i krihte flokët dëgjoi një djalë që i tha:

- Unë jam Drini. A luajmë bashkë?

- Po ti je çun dhe luan me makina, - u përgjigj Kristina.

- Pse kukulla jote nuk i jep makinës? - ia ktheu përgjigjen menjëherë Drini. Kristina mendoi se Drini kishte të drejtë. Ata filluan të luanin të dy. Njëherë i jepte ai makinës, njëherë ajo. Kukulla e bukur qëndronte gjatë gjithë kohës e ulur në makinë, ndërsa ata të dy i bënin shëtitje. Makina kishte një bor, muzikë, ndërsa dritat e saj ndizeshin dhe shuheshin, sa herë që ndalonate.

Papritur u dëgjua zëri i Teutës:

- Një anije piratësh! - bërtiti ajo me sa fuqi që kishte dhe drejtoi gishtin nga makina e kuqe me kukullën e ulur. - Ta shkatërrojmë!

Si tha këto fjalë, u afrua te makina dhe e goditi me një kub lodër. Fëmijët që po luanin me të filluan të gjuanin gjithashtu. Drini dhe Kristina përpinqeshin më kot t'i ndalonin. Brenda pak minutash, makina dhe kukulla ishin bërë copacopa.

Kjo nuk ishte një ditë e bukur për Kristinën.

Kur u kthye në shtëpi u tha prindërve se do të ishte e lumtur nëse do të kishte një vëlla.

- Përse?! - pyeti mami e çuditur që vajza e saj kishte ndërruar mendim.

Kristina i tregoi gjithçka që kishte ndodhur; sesi kishte parë një makinë të bukur me një kukull në mur, sesi kishte gjetur kukullën mes lodrave, sesi kishte filluar të luante me një shok që quhej Drini, që ishte sjellë shumë mirë me të. Ndërsa Teuta, ajo vajza që e quante veten kapitene kishte prishur lojën e tyre. Në fillim ajo ishte çuditur kur e kishte parë të bërtiste e të sillej si djalë.

– Çdo fëmijë mund të bërtasë ose të mos sillet mirë, qoftë vajzë ose djalë. Teutës i pëlqen ajo lojë, por kjo nuk do të thotë që ajo është si një djalë dhe as që është një vajzë e keqe, – i tha babi.

– Ndoshta mund të ishte sjellë pak më mirë dhe të mos e prishte lojën tuaj, – shtoi mami.

Kristina mendoi se prindërit e saj kishin të drejtë. Të nesërmen ajo shkoi sërisht në kopsht. Luajti përsëri me Drinin, ndërsa Teuta, që e kishte kuptuar gabimin, u kërkoi të falur. Jo vetëm kaq. Ajo kishte sjellë një makinë të re me një kukull si ato që kishte prishur. Të tre luajtën bashkë dhe u bënë shokë. A vazhdonte të luante më Teuta me piratë? Po, ajo ishte loja e saj e preferuar, por tanj ajo nuk bërtiste, ndërsa mes ushtarëve të saj ishin shtuar edhe Kristina me Drinin.

Lepuri dhe breshka

Lepuri dhe breshka i kishin shtëpitë pranë dhe pranë. Të gjithë në pyll e quanin lepurin më të shpejtin e kafshëve, kurse breshkën më të ngadaltën.

Një mëngjes, breshka trokiti në shtëpinë e lepurit dhe i tha se donte të bënte garë vrapi. Lepuri, me të dëgjuar ato fjalë, filloi të queshte me të madhe.

Lajmi se breshka dhe lepuri do të bënin një garë, u përhap te të gjitha kafshët e pyllit. Ditën që u caktua gara, të gjitha kafshët ishin mbledhur për të bërë tifozllëk. Dikush bërtiste për lepurin dhe dikush për breshkën.

Gara filloi. Lepuri vrapoi me të katra dhe u bë erë, kurse breshka lëvizte me hapa të ngadaltë. Lepuri, herë pas here, duke vrapuar kthente kokën pas. Ai shihte që breshka zvogëlohej dhe zvogëlohej, derisa erdhi një çast që nuk e pa më. Breshka kishte mbetur shumë prapa.

Ishte vapë dhe lepuri vendosi të pushonte nën hijen e ca pemëve. Ai mendoi të merrte një sy gjumë sa t'i afrohej breshka. Por nën pemë frynte një erë e freskët dhe lepurin e zuri një gjumë i thellë. Ngadalë-ngadalë, breshka arriti tek hija e drurëve dhe dëgjoi gërhimën e lepurit. Breshka vazhdoi në udhën e saj me të njëtin hap. Ec dhe ec, breshka po i afrohej fundit të garës.

Ndërkaq lepuri u zgjua dhe hodhi sytë prapa për të parë breshkën, por ajo nuk dukej. Lepuri filloi të vraponte i sigurt se breshka kishte mbetur prapa ose e kishte lënë garën. Por, kur ngriti kokën, pa breshkën që kishte arritur e para dhe kishte fituar garën.

Që nga ajo ditë lepuri nuk e ngacmoi më breshkën. Kishte frikë se po të bënte prapë garë, do ta rrëmbente sërisht gjumi i rëndë.

Shkarravitésit

Pallati ku banojmë është një nga më të mirët në qytet. Ai është i madh, i bukur, në formë "U"-je dhe i lyer me bojë të kaltër. Kur i sheh nga larg, qielli dhe pallati duken sikur janë një. Para pallatit ka një shesh të madh me asfalt. Sa i pastër është ky shesh, megjithëse ne luajmë aty çdo ditë! Sa të pastra janë shkallët, muret, oborri. Asgjë nga ne nuk hedh letra ose sende të tjera. Asnjë nga ne nuk shkarravit.

Mirëpo një ditë, në murin e pallatit të gjithë vumë re disa shkarravina. U afruam. Dikush kishte vizatuar një kokë të shtypur me gojë të madhe, shumë të madhe. Poshtë kishte shkruar: "Landi plas për petulla". U grumbulluam rrëth këtij

vizatimi që turpëronte se cilin prej nesh. Shikonim dhe heshtnim. Kush mund ta kishte bërë? Dhe ku mu në mes të oborrit, atje ku kalonin të gjithë.

- Të jem unë si Landi dhe ta di kush e ka bërë, nuk e di se ç' do të bëja, - tha Artani.

- E pse? - pyeti Anila.

- Si, moj pse? Nuk e sheh ç'ka bërë? Shihni gojën, - dhe Artani u mundua ta shtrembëronte gojën si ajo që ishte vizatuar. Të gjithë ia plasën gazit.

- Ç'më qeshni, - thirri Genti, - kjo është për të qarë. Tani të gjithë do të tallen me ne e do të na quajnë shkarravitës.

- Le të tallen me atë që e ka bërë. Ne nuk dimë gjë, - u hodh Vjollca.

- Po kush e ka bërë se? - pyeti i menduar Genti.

- Unë e di, - thirri Pirroja, - Beni.

Beni ishte aty dhe sa dëgjoi emrin e vet, u hodh përpjetë. Filloi rrëmuja. Disa thoshin se e kishte bërë Beni, disa të tjera jo.

- Unë vërtet shkarravis, por shkarravis në fletë të bardha. Këtë e dinë të gjithë, - bërtiti më në fund Beni.

- Atëherë vetë Landi mund ta gjejë kush e ka bërë, - tha Genti.

Pasdite Genti, Vjollca, Beni shkuan në shtëpinë e Landit. Ai u ngrit nga shtrati dhe doli në ballkon për të parë vizatimin.

- Astriti e ka bërë, - tha dhe mori zjarr. Ai të më bëjë mua gojën të madhe? Po unë i bëj jo vetëm gojën, por edhe hundën, veshët, kokën. Sa pallati do t'ia bëj, që ta shohë i gjithë qyteti. Genti e zuri Landin prej krahu dhe zuri ta qetësonte.

- Po qe se të gjithë marrin nga një shkumës e shkarravitin rrugët, oborrin, pallatin atëherë ç' do të bëhet? - e pyeti ai.

- Astriti ka bërë një gabim. Mos vallë duhet që edhe ti Landi të bësh po këtë gabim. Puna ishte që t'ia mbushim mendjen Astritit të pranojë gabimin dhe të mos e përsëritë më. Këtë duhet të bëjmë. Ne biseduam gjatë dhe ja ç'vendosëm:

- Në cep të oborrit do të ngremë një stendë të vogël, ku do vëmë një poster ku ne të katërt do marrim një iniciativë për të mbajtur sa më pastër pallatin, – tha ai.
- Në fund do të bëjmë thirrje të gjithë fëmijëve të pallatit që të bashkohen me ne. Atëherë besojmë se Astriti do ta kuptojë gabimin.

Dhe kështu ngjau. Të gjithë u bashkuan me ne, edhe Astriti. Në lyerjen e pemëve me gëlqere, në mbjelljen e luleve para pallatit, kudo ai qe i pari. Genti vazhdimisht e lavdëronte. Astriti e kuptonte që ne e dinim fajin e tij dhe pikërisht për këtë punonte më shumë.

Qyteti më i ri në botë

Shumë e shumë kohë më parë, qytetet ishin të ndërtuara ndryshe nga sot. Në një qytet jetonin katroret. Pallatet, shtëpitë, pemët, njerëzit e kafshët kishin formë katrore. Në një qytet tjetër jetonin rrëthorët. Në këtë qytet, gjithçka kishte formë rrëthore. Në një qytet më të madh jetonin trekëndëshat. Gjithçka në qytetin e tyre kishte formë trekëndore. Në një qytet tjetër jetonin drejtkëndëshat. Qyteti ishte shumë i madh, sepse pallatet, shtëpitë, pemët, njerëzit e kafshët ishin më të mëdhenj. Të gjitha format mendonin se qyteti ku jetonin ishte më i bukuri në botë. Rrëthorët nuk i pëlqenin katroret. Katrorët nuk pëlqenin trekëndëshat. Trekëndëshat nuk pëlqenin drejtkëndëshat dhe këta të fundit nuk pëlqenin rrëthorët. Katrorët thoshin: "Që të jesh i bukur, i mençur dhe i mirë duhet të kesh katër brinjë të barabarta. Nëse nuk është kështu, atëherë të gjithë janë të shëmtuar.". Rrëthorët thoshin: "Që të jesh i bukur, i mençur dhe i mirë duhet të jesh rrumbullak. Nëse nuk është kështu, atëherë të gjithë janë të shëmtuar.".

Trekëndëshat thoshin: "Që të jesh i bukur, i mençur dhe i mirë duhet të kesh tri brinjë. Nëse nuk është kështu, atëherë të gjithë janë të shëmtuar.". Drejtkëndëshat thoshin: "Që të jesh i bukur, i mençur dhe i mirë duhet të kesh dy brinjë të shkurtra të barabarta dhe dy brinjë të gjata po të barabarta. Nëse nuk është kështu, atëherë të gjithë janë të shëmtuar.".

Pra, çdo formë luante në qytetin e vet, pa u bashkuar me format e tjera.

Një ditë të bukur pranvere, disa rrëthorëve u rrëshqiti këmba dhe ranë në vendin ku po luanin drejtkëndëshat. Drejtkëndëshat u mërziten dhe filluan të ziheshin me rrëthorët. Trekëndëshat dhe katorët u bënë kureshtarë dhe vrapuan të mësonin se nga vinte gjithë ajo potere.

Një drejtkëndësh u nxeh aq shumë, sa hipi mbi një drejtkëndësh tjetër dhe të dy bashkë ranë mbi dy rrëthorë. Të gjitha format mbeten gojëhapur. Para tyre qëndronte një lokomotivë që lëvizte dhe bënte çaf e çuf. Paskëtaj, të gjitha format filluan të lëviznin për të bërë diçka. Katorët dhe rrëthorët krijuan vagonë, u bashkuan me lokomotivën dhe krijuan një tren të mrekullueshëm. Trekëndëshat dhe drejtkëndëshat krijuan disa pemë. Të gjitha format punuan dhe ndërtuan së bashku një shtëpi dhe plot gjëra të mrekullueshme. Por, erdhi mbrëmja dhe format do të kthehen në shtëpitë e tyre. Që nga ajo ditë të gjitha format luanin çdo ditë me njëra-tjetrën dhe bënin gjëra shumë të bukura së bashku.

Mami, të lutem, mos më lavdëro!

Mami im më do shumë. Por, sa herë që vjen tek ne ndonjë për vizitë, ajo i thotë për mua se këndoj bukur dhe di tërë ato vjersha përmendsh.

Një pasdite erdhën tek ne dy teta. Mami më veshi fustanin e ri dhe u tha atyre:

- Tani do të dëgjoni artisten time të vogël! Doo t'ju recitojë e do t'ju lërë pa mend.

Unë e dija vjershën shumë mirë, por kur dëgjova lavdërimet u hutova dhe i harrova të gjitha. Ç’ të bëja? U kolla një herë, pastaj u përkula lehtë. Shoqet e mamit qeshën dhe më duartrokitën. U përkula prapë dhe prita se mos më kujtoheshin fjalët. Mirëpo, hiç se hiç! Mbeta e heshtur në mes të dhomës.

- Hë, de, mos na turpëro! – më nxiti mami. – Pse nuk fillon?

Vështrova tavanin, dritaren, por më kot. Mami u zverdh. Ato tetat buzëqeshën. Kurse unë i thash mamit:

- Të lutem, mos më lavdëro, se i harroj edhe ato që di!

Pse Hëna s’ka fustan?

Një ditë, Hëna vrapi te nëna e saj dhe i kërkoi të qepte një fustan të bukur. Ajo kishte parë shumë vajza të veshura bukur dhe donte të vishej si ato.

Hëna vajti te rrobaqepësi dhe zgjodhi copën. Rrobaqepësi i mori masën e trupit dhe i tha të vinte për provë pas pesë ditësh.

Ditët kaluan dhe Hëna shkoi të bënte provën e fustanit. Për çudi, fustani i rrinte i ngushtë dhe i shkurtër. Jo Hëna nuk mund ta vishte atë fustan.

Rrobaqepësi mendoi se kishte gabuar masat. Mori frymë thellë dhe ia mori masat përsëri. Hëna do të shkonte për provë pas pesë ditësh të tjera.

Kur e provoi fustanin, Hëna dhe rrobaqepësi u habitën të dy. Jo, Hëna nuk mund ta vishte atë fustan. Brenda tij i futej vetëm koka.

Rrobaqepësi nuk po kuptonte se çfarë po ndodhë. Ai ia mori masat përsëri dhe iu lut Hënës të vinte pas pesë ditësh të tjera.

Rrobaqepësi e bëri fustanin nga e para. Një mbrëmje doli në dritare dhe po vështronte Hënën. Ajo ishte bërë shumë e madhe dhe rrumbullake. Jo, as fustani i ri që po priste, nuk do t'i bënte Hënës. Rrobaqepësi kryqëzoi duart dhe me keqardhje mendoi se Hëna nuk do të mund të vishte kurrë fustan. Ajo njëherë shfaqte çerekun e trupit, më pas gjysmën e trupit dhe herë-herë të gjithë trupin.

Ja pse Hëna mbeti pa fustan.

Miu i qytetit dhe miu i fshatit

Njëherë e një kohë miu i fshatit ftoi në shtëpinë e tij miun e qytetit. Miu i qytetit e pranoi ftesën dhe mbërriti vonë në darkë.

Miu i fshatit përgatiti misra dhe patate për darkë. Të dy minjtë u ulën në tryezë dhe filluan të hanin qetë-qetë.

Secili tregonte për jetën që bënte. Miu i fshatit u bë kureshtar për jetën në qytet.

Ai vendosi të shkonte të jetonte në qytet. Të nesërmen të dy minjtë u nisën për në qytet. Miu i fshatit u habit kur pa se në ç'vrimë jetonte miu i qytetit. Por kur hynë brenda, ai u habit nga ushqimet që hante miu i qytetit: salçiçet, djathi kaçkavall, keku, frutat dhe biskotat që gjendeshin në tokë.

Miu i fshatit brejti (cimbisi) pak djathë kaçkavall.

– Sa i shijshëm! Kurrë më parë unë nuk kisha provuar një gjë të tillë,- tha me zë të lartë miu i fshatit dhe vazhdoi të cimbiste grimca të tjera.

Papritur, u dëgjuan ca gërvishtje thonjsh. Minjtë panë kokën e madhe të një maceje dhe dhëmbët e saj të mprehtë.

– Vrapo, shpejt të fshihemi ku të mundemi, – i tha miu i qytetit shokut të tij.

– Si është puna? Kush është ajo? – pyeti duke u dridhur nga frika miu i fshatit.

– Ajo është macja. Po të zuri, të kollofiti menjëherë në gojë, – i shpjegoi miu i qytetit.

- Kjo është e tmerrshme,-ia ktheu miu i fshatit, – unë do të kthehem në fshatin tim.

Atje jam i qetë. Më mirë të ha i qetë misra dhe patare në fshatin tim, sesa të më ngecin në grykë salçiçet dhe djathi i qytetit.

Miu i fshatit u përshëndet me miun e qytetit dhe u kthye në shtëpinë e tij të qetë në fshat.

Zogu dhe farëza

Na ishte njëherë një zog. Ky zogu ishte fare i vogël. Ai nuk fluturonte dot. Një ditë nëna e zogut doli, si përherë, të gjente ushqimin për të voglin. Zogu u mërzit së prituri dhe tha:

– Po dal të shoh a po vjen mami! – dhe fluturoi mbi një degëz pranë çerdhes. U gëzua shumë, se krahët po e mbanin në ajër.

– Po sikur të hidhem nga dega e të fluturoj më tutje? – pëshpëriti me vete. Dhe ashtu bëri. Krahët prapë e mbanin lart dhe ai po fluturonte pa u rrëzuar. U gëzua prapë dhe u ul mbi tokë. Atje pa një farëz të vogël, të vogël, sa një kokërr meli. Paf, ia bëri zemra.

– E gjeta një çikë ushqim! – mërmëriti edhe e kapi farëzën me sqep. Por, sa çudi! Farëza filloi të fliste:

– Mos, o zog! Mos më ha, se edhe unë jam e vogël si ti!

– Po pastaj se je e vogël? Unë dua ushqim! – ia ktheu zogu. – Mua më ka marrë uria.

– Gjej diçka tjetër, të lutem!

Zogu nuk e zgjati. Atij i erdhi keq, ndaj e lëshoi farëzën nga sqepi. Pup këtu e pup atje, shkoi të kërkonte ushqim më tutje. Atë kohë dëgjoi zërin e mamasë, që ishte kthyer. U ngrit fluturim dhe shkoi në fole. Çuk e çuk, nisi të hante ushqimin që i kishte sjellë mamaja.

Kaluan javë e muaj. Zogu u rrit e u bë dy herë më i madh. Një ditë nisi një shi i rrëmbyer. Zogu s'kishte dalë nga foleja. Dega e folesë tundej dhe ia bënte "vu-vu". Pastaj ajo u tund shumë, zogut iu morën mend dhe ra poshtë. U lag dhe u bë ujë. Filloi të mërdhinte e të dridhej nga frika e nga të ftohtit.

- Zog, o zog! - se kush e thirri. - Eja fute kokën nën fletët e mia!

Ajo që i fliste ishte një lule fletëshumë. Zogu u çapit ngadalë, hyri nën fletët e saj e nuk po lagej më. Dhe a e dini cila ishte lulja? Farëza e vogël që kishte mbirë, që kishte nxjerrë kërcellin dhe gjethet. Rritu e rritu, qe bërë e madhe. Kur pushoi shiu dhe doli dielli, zogu tha:

- Të faleminderit, o lule e mirë! Më shpëtovë jetën!
- Ta kisha borxh, o zog! - ia priti ajo. - Ti më bëre një të mirë në dimër, kur nuk më hëngre, dhe unë, ja, ku ta shpërbleva!

Tri fluturat

Na qenë njëherë tri flutura, një e bardhë, një e verdhë e një e kuqe. Ato lozni në rreze të diellit dhe fluturonin lule më lule pa u lodhur fare. Sa të lumtura që ishin.

Pas pak zuri shiu e i lagu. Deshën të kthehen në shtëpinë e tyre, por shtëpia ishte larg.

- Që të mos lageshin më shumë, shkuan te zambaku dhe i thanë:
- I dashur zambak, na le të qëndrojmë pak në lulen tënde sa të pushojë shiu.

Zambaku u përgjigj:

- Të bardhën e le, por dy të tjerat jo.
- Flutura e bardhë foli:
- Meqenëse ti nuk pranon shoqet e mia, atëherë edhe unë nuk vij tek ti. Më mirë të lagemi të tria.

Shiu binte gjithnjë. Fluturat shkuan te një trëndafil i kuq dhe iu lutën:

Na le të futemi nën fletët e tua; sa të pushojë shiu.

- Të kuqen dhe të verdhën i lë, - tha trëndafili, - po të bardhën jo.

Ato iu përgjigjën:

- Meqenëse s'pranon të bardhën, atëherë edhe ne të dyja s'po vijmë tek ti. - Që të tria u larguan dhe fluturuan nëpër shi.

Dielli i dëgjoi atje ku ishte prapa reve. Atij i pëlqeu shumë që fluturat nuk e lanë njëra tjetrën vetëm. Prandaj përhapi retë, lëshoi rrezet në kopsht dhe ua teri krahët fluturave të dashura.

Të gjithë së bashku

Pranvera erdhi. Lepurushat, ketrushat, arushat gjumashe dhe zogjtë dimërakë ishin shumë të gëzuar që u zgjuan dhe u takuan me njëri-tjetrin. Pylli u gjallërua nga zërat gazmorë të banorëve të tij. Bletët zukatnin, zogjtë ciceronin dhe dallëndyshet u ktheyen pranë foleve të tyre. Kafshët u mblodhën në mes të pyllit dhe menduan të festonin së bashku ardhjen e pranverës. Por çfarë mund të bënin?

Shqiponja dha mendimin se ata mund të përgatisnin një tortë të madhe, të shijshme dhe të bukur. Tortën do ta hanin banorët e pyllit. Të gjitha sa ishin aty e mirëpritën idenë e shqiponjës, me përjashtim të nepërkës helmuese. Ajo mendonte se asnëra kafshë nuk dinte si bëhej torta dhe ëmbëlsira që ata do të bënin nuk do të dilte fare e shijshme.

Nepërka i pyeti me radhë: ketrin, lepurushin, arushën, bletët dhe dhinë, nëse dinin të bënin tortë dhe të gjithë tundën kokat në formë mohimi. Por, ama, ketrushat do të çanin arrat, bajamet dhe lajthitet; arushat do të përgatisnin brumin; bletët do të bënin shurupin prej mjalti, dhia do të jepte qumështin e saj e kështu me radhë.

Secila kafshë u shpërnda nëpër pyll për të kryer punët që dinte të bënte më mirë. Ketrushi solli një shportë me arra e lajthi dhe filloi t'i çante me dhëmbët e tij të mprehtë; lepurushi solli një shportë me vezë, arusha solli vajin; zogjtë sollën miellin dhe sheqerin, kurse kafshët e tjera mblohdhën frutat e pyllit. Dhia solli qumështin, kurse bletët mjaltin e shijshtëm.

Si tryezë për të përgatitur tortën zgjodhën një trung të prerë lisi. Arusha, ketrushi dhe lepurushi përgatitën brumin e tortës, kurse kafshët e tjera shtuan përbërësit e tjerë. Tortën e poqën në furrën që hapi urithi. Pasi u poq, torta u zbukurua me lule, fruta dhe shurup mjalti. Torta doli shumë e bukur sa nepërka u çudit fare me zotësinë e banorëve të pyllit. Ata u vendosën rreth e qark tortës, kënduan dhe kërcyen gjithë gëzim. Më pas ata e prenë tortën në pjesë dhe e hëngrën me qejf të madh.

Që nga ajo ditë, kafshët e pyllit i përgatisnin së bashku tortat dhe ëmbëlsirat e tjera.

Balona e Ketrit Tyty

Shumë e shumë kohë më parë, jetonte në pyll një ketër i vogël. Atij i pëlqente shumë të bënte si boritë e makinave tytytyyyy. Për këtë, të gjithë shokët e thërrisnin Ketri Tyty.

Një mëngjes, Ketri Tyty doli nga pylli dhe u nis për te bregu i detit. Peshku pendëkuq e ftoi të lahesin bashkë në det, por Tytyja e kishte lënë të takohej me lepurushët. Ec e ec, kur papritur pa dy balona, që fluturonin në qiellin e kaltër. Tytyja u mërzit që shokët nuk e kishin pritur për të luajtur së bashku. Ai vendosi të bënte një balonë që të fluturonte më lart se balonat e lepurushëve.

Tytyja u ul te trungu i një pishe dhe filloi të mendohej. Nga shtëpia nuk kishte marrë asnje fije letre. Në xhep, kishte vetëm librin me figura që ia kishte dhënë edukatorja. Si t'ia bënte? Mendoi e mendoi dhe më në fund vendosi. Mori në duar librin, grisi fletën e fundit dhe me të bëri një balonë.

– Shikoni, shikoni edhe një balonë tjetër – thirrën trumcakët. – Sa bukur! Ua kaloi dy balonave të tjera. Të lumtë ketër!

Tytyja dëgjonte dhe queshte i kënaqur. Atë çast dy trumcakët shkuan pranë balonës.

- Ej, mos i shponi me sqep, se rrëzohet! Mos po ju them.
- Uaaaaa! – cicëruan të habitur trumcakët. – Tytyja paska grisur librin! Oh, sa turp!

Pas këtyre fjalëve, Ketri vazhdoi të luante, por ndihej i mërzitur. Papritur, zuri të frynte një erë e fortë. Ketri bëri ta mblidhët balonën e tij, por ajo ra në det dhe humbi nëpër shkumën e bardhë të valëve. Tytyja priti gjatë se mos dallgët e nxirrnin balonën në breg, por më kot. I mërzitur u kthyte në shtëpi.

Në kopsht, Ketri Tyty rrinte si mbi gjemba. Po ta pyeste edukatorja për librin, çfarë do t'i thoshte?

Edukatorja e vuri re që Tytyja ishte i mërzitur dhe iu afrua pranë. Ketri Tyty tregoi për fletën e librit që kishte grisur dhe i kërkoi falje edukatores.

Në atë kohë në dritare trokitën dy trumcakë. Ketri i njuhu. Edukatorja hapi dritaren dhe trumcakët hynë brenda. Në sqep mbanin fletën që i mungonte librit të Ketrit Tyty.

Trumcakët e kishin gjetur në breg të detit. E sollën në kopsht, sepse Ketri Tyty tregoi të vërtetën dhe u pendua për gabimin që kishte bërë.

Ketri i gëzuar puthi trumcakët dhe mori fletën. Së bashku me edukatoren e ngjitën fletën në libër.

Që nga ajo ditë, Ketri Tyty kujdesej shumë për librat.

Udhëtimi i yllit kureshtar

Diku në qiellin e paanë jetonte një Yll. Prej andej ia ngulte sytë Tokës dhe sodiste me orë të tëra atë pjesë të saj që quhet Det. Sa do të kënaqej po të zbriste qoftë edhe një herë mbi ujin e kaltër. Kushedi ç'kishte brenda Deti! Dëshira për ta parë i rritej dita-ditës. Veçse, Ylli kureshtar, se kështu e quanin, s'ia thoshte askujt të fshehtën e vet. Më mirë të mos e dinte asnjë Yll tjetër. Po sikur të gjithë Yjeve t'u shkrepte të zbrisnin në Det, kush do ta zbukuronte Qiellin? Këto mendonte

kureshtari në heshtje. Mirëpo, dëshira për të parë Detin i ziente në shpirt, ndaj vendosi të bënte udhëtimin që ëndërronte. Priti sa ta mbulonin Qiellin karvanët e Reve dhe zbriti të shtëpiza e njërës prej tyre.

– Më merr me vete, – iu lut Kureshtari, Resë. Ajo u çudit pak, por megjithatë e mori me vete e nisën të fluturonin. Ylli kureshtar ndihej i lumtur! Më në fund arritën mbi Det. Atëherë Ylli rrëshqiti nëpër litarët e shiut që hodhi Reja dhe ra në ujë

– Të faleminderit, – thirri ai i ngazëllyer dhe u zhyt thellë.

– Oh, sa bukur ishte aty! Leshterikët, peshqit, koralet e mrekullueshme banorin e Qiellit të largët. Kjo botë e re e panjohur e beri për vete kureshtarin. Befas para tij u shfaq e Bukura e Detit. Sa flokë të bukur kishte! Të artë e të gjatë si të sirenave, për të cilat kishte dëgjuar aq shumë ndodhi.

– Mirëserdhe o mik i qiejve! – i tha jo.

Tani e tutje ai do të jetonte në Det dhe le ta quanin Ylli i Detit. Kur ta merrte malli për Qiellin do të dilte në breg. Pastaj do të bisedonte me të afërmit e tij. Do ta dëgjonin vallë? Me siguri. Qielli e Toka kanë qenë pérherë miq. A s'tregonë dhe ardhja e tij në Tokë, dashurinë e banorëve të Qiellit për ata të Tokës? Pastaj, është me të vërtetë diçka e bukur të jesh Ylli i kaltër deti. Se fundja, a nuk ngjan Deti me një Qiell prej uji? Tek mendonte këto, Yllin e Detit e zuri gjumi.

C'është ylberi?

Gjyshi po lexonte një libër ulur në divan. Diana po shihte revistën *Yllkat*. Atje, tek një vjershë, ajo pa një ylber.

– Gjysh, si formohet ylberi? – pyeti në çast.

– Ai, moj xhan i gjyshit... formohet në qiell, kur bie shi, po kur ka edhe diell. Dhe kjo ndodh, sepse drita e diellit zbërthehet në rrezet me ngjyra të ndryshme nga pikat e shiut, që janë në ajër.

– Gjysh, a mund ta kapim ylberin?

- Jooo! Po të shkosh atje ku sheh ylberin, të duket sikur ai nuk është më aty. Pra, dallohet vetëm nga larg.

Gjyshi u mendua pak pastaj shtoi:

- Diana, sot ka diell. Megjithatë, ne të dy do ta krijojmë ylberin në dhomën tënde.

- Vërtet, gjysh?!

- Po, edhe madje shumë thjesht.

Ai mori një gotë të mbushur plot me ujë dhe e vuri mbi kapakun e dritares, ku binte diell i fortë. Mbi dysheme shtrihu një letër të bardhë, të pastër. E rrotulloi gotën disa herë në drejtim të rrezeve të diellit. Diana u habit kur pa mbi letër harkun e një ylberi të bukur tërë ato ngjyra: të kuqe, portokalli, të verdhë, të gjelbër, bojë qielli, të kaltër dhe vjollcë.

- Tani përpiku, - i tha Dianës, - ta vizatosh ylberin në letër! Dhe Diana përqafoi gjyshin, mori lapsat me ngjyra dhe filloi të vizatonte e gëzuar.

Pse deti është i kripur?

Na ishte njëherë një peshkatar. Ai shkonte çdo ditë për të zënë peshq. Një ditë, rrjeta e tij zuri një gjë të rëndë. Brenda saj peshkatari pa diçka të rrumbullakët, me trup të mbuluar me luspa dhe me sy të mëdhenj e të gjelbër.

- Kush je ti? - e pyeti peshkatari.

- Unë jam Mbreti i Detit. Në qoftë se më lëshon do të dhuroj çfarë të duash: guaska, yje deti, thesare dhe gurë të çmuar që gjenden në detin tim.

Peshkatari nuk bindej.

Atëherë, Mbreti i Detit i dha një mulli që bënte çudira. Ai i plotësonte të gjitha dëshirat peshkatarit.

Një ditë, në shtëpinë e peshkatarit erdhi një tregtar. Ai udhëtonte shumë për të blerë kripë. Peshkatari mori mullirin dhe i tha:

- Mulli, mbushe tavolinën plot me gjëra të shijshme. Mulliri e zbatoi urdhrin menjëherë. Tregtari u habit se si mulliri i vogël nxirrte kaq shumë gjëra. Pasi u ngopën mirë e mirë, peshkatari i tha: "Mulli mjaft" dhe i mbylli sustën e vogël që ishte në anën e prapme të tij.

Natën, tregtari u zgjua, mori mullirin dhe iku fshehurazi. Shkoi në anije dhe u tha shokëve të niseshin menjëherë. Ai u tregoi se mulliri do t'u jepte sa kripë të donin. Tregtari e vendoi mullirin mbi një dërrasë dhe e urdhëroi: "Mulli kripë!". - Mulliri filloi të nxirrte kripë pa pushim dhe të mbushte anjen. Marinarët u çuditën dhe u gëzuan se tani do të bëheshin të pasur.

Mulliri prodhonte kripë dhe nuk ndalonte. Tregtari nuk e kishte parë peshkatarin kur mbylli sustën, prandaj nuk dinte si ta ndalonte. Ai i thirri "Mulli mjaft!", por mulliri vazhdonte punën. Anija u mbush aq shumë sa filloi të zhytej. Anija, tregtari dhe marinarët u mbytën dhe ranë në fund të detit. Mulliri vetëm punonte dhe vazhdonte të nxirrte kripë. Prandaj thonë se që atëherë deti u bë i kripur.

Fëmijët dhe delfini

Fëmijët po luanin me një top të kuq në breg të detit. Topi u shpëtoi nga duart e ra në ujë dhe kërceu nga një valë në një valë tjetër. Genti u hodh me not në det, por nuk e kapi dot. Një delfin i madh doli mbi ujë. Ai filloi të luante me topin sikur ta kishte të vetin.

Delfini i erdhi pranë dhe e shtyu topin me turinj drejt djalit. Genti u tremb aq shumë sa harroi të luante duart e këmbët dhe po e mbulonte uji. Delfini e pa që djali po mbytej, u përkul dhe e mori në shpinë dhe e çoi vogëlushin në breg. Duke luajtur me topin e kuq delfini ua solli fëmijëve dhe ato u bënë miq, pastaj i përshëndeti me kokë dhe u fut në det. Kalonin ditët, delfini vinte çdo ditë në mëngjes dhe luante me fëmijët. Një ditë kur po notonte drejt tyre delfini mori aq vrull sa doli në breg dhe ngeci në rërë. Genti u afrua me vrapi. Delfini hapte gojën, nxirrte një zë si të qarë dhe rrotullonte sytë e

përlotur. Ai përpinqej të futej në ujë, por nuk mundej. Genti e kapi dhe deshi ta fuste në det. Por delfini ishte dy metra i gjatë dhe nuk lëvizte nga vendi. Erdhi aty një burrë dhe tha: – “Ta marrim këtë delfin dhe t’ia çojmë peshkimit, ai ka mish të shijshëm, i marrim dhjamin, vajin e peshkut dhe lëkurën”.

– Jo, - bërtiti Genti dhe iu hodh delfinit përsëri për ta mbrojtur.

– Po ky do të ngordhë këtu në rërë, - tha burri. Fëmijë e të rritur u grumbulluan rrëth e përqark. – Ky është miku ynë, - tha Genti. Ju lutem, na ndihmoni ta kthejmë në det. Fëmijë e të rritur e ngritën delfinin dhe e futën në det. Ai notoi tutje bëri kollotumba dhe tundi bishtin për të thënë: *“Faleminderit miqtë e mi!”*.

Të nesërmen ai erdhi përsëri, erdhi çdo ditë dhe luajti me fëmijët derisa mbaroi vera.

A

B



C

Punimi i shkronjave me materiale të riciklueshme

C
S

D





G



G J

H

I

J







N

N
U

O

P





S

H U





T H

T

U U

V V





1

2

3

4

5

Punimi i numrave me materiale të riciklueshme



6

7

8






9

10





Punimi i formave me materiale të riciklueshme



Etiketa me fjalë për çdo shkronjë të alfabetit

A	AKULLORJA	ARIU	ARRA	AEROPLANI
B	BALONA	BORIA	BRESHKA	BUKA
C	CJAPI	CIRKU	COPA	
Ç	ÇELËSI	ÇADRA	ÇEKIÇI	ÇIFTELIA
D	DIELLI	DARDHA	DRERI	DORA
DH	DHURATA	DHJETA	DHËMBI	
E	ELEFANTI	ELEKTRIKU	ERA	EKRANI
Ë	ËMBËLSIRA	ËNDRRA		
F	FLUTURA	FIKU	FLAMURI	FOLEJA
G	GAFORRJA	GLOBI	GOTA	
GJ	GJIRAFË	GJELI		
H	HËNA	HELIKOPTERI	HUTI	
I	ISHULLI	IRIQI	IBRIKU	
J	JELEKU	JAKA	JASTËKU	



K	KËRMILLI	KALI	KANGURI	KOVA
L	LAPSI	LIBRI	LIMONI	LUMI
LL	LLAMBA			
M	MALI	MOLLA	MAKINA	MIU
N	NATA	NUMËRATORJA	NËNDETËSJA	NOTA
NJ	NJËSHI	NJË EURO	NJOLLA	
O	OXHAKU	ORA	OKTAPODI	
P	PICA	PEMA	PATA	PIRUNI
Q	QERSHIA	QENI	QEPA	QUKAPIKU
R	ROBOTI	ROSA	RAKETA	REJA
RR	RRUSHI	RRIPI	RROTA	
S	SEMAFORI	SYZET	SANDALET	SAPUNI



SH	SHTËPIA	SHQIPONJA	SHISHJA	
T	TOPI	TELEVIZORI	TRENI	TIGRI
TH	THESARI	THESI	THIKA	
U	UJKU	URA	ULLIRI	
V	VARKA	VIOLINA	VİNÇİ	
X	XIXËLLONJA			
XH	XHUXHI	XHEPI	XHUPI	
Y	YLBERI	YLLI		
Z	ZOGU	ZJARRI	ZEBRA	ZEMRA
ZH	ZHYTËSI	ZHAPIKU	ZHONGLERI	



LIBRI
7

Mësoj si nxënës
**LUAJ si
FËMIJË**
KLASA PËRGATITORE



Muaji shtator: Shkolla po më pret

Temat	Faqe	Temat	Faqe
Miqtë e mi të parë	5	<i>Eko-armata</i> (Agim Deva)	25
Përshëndetje	6	I gjatë – i shkurtër	26–27
<i>Këtu jam unë</i> (Parashkollorët, IKS, 2007)	7	Vijat e drejta	28–29
Tregoj për veten time	8–9	Lodrat dhe llojet e tyre	30–31
Shkronjat që njoh	10–11	Shumë – pak	32–33
Vizatimi im i parë	12	Që lepurushi të mos dëmtohet	34
Në botën e personazheve	13	Kujdesi për lodrat dhe mjetet	35
<i>Unë tani u rrita</i> (Krenar Progonati)	14	Vijat e thyera	36
Çanta ime	15	Vijat e lakuara	37
<i>Arushi që dinte të thoshte vetëm "Mirëmbërëma"</i> (Bekim Harxhi)	16	<i>Veprimitari praktike</i> – Si lahen dhëmbët?	38
Fjalët përshëndetëse	17	Porsa ngrihem në mëngjes	39
Dita dhe nata	18	Para – prapa	40–41
Kur i bëjmë këto veprime?	19	<i>Edhe ti Beni do të rritesh</i> (Remzi Zeqja)	42
<i>Flutura fjalëbukura</i> (Tasim Gjokutaj)	20	"Gabimet" e fëmijëve	43
Fjalët magjike	21	Unë, shokët dhe shoqet	44–45
Numrat që njoh	22	Sendet vetjake	46
Format që njoh	23	<i>Veprimitari praktike</i> – Balona fluturuese	47
<i>Veprimitari praktike</i> – Si lahen duart?	24		

Muaji teter: Mirë se erdhe vjeshtë e artë!

Temat	Faqe	Temat	Faqe
Sa gëzim, sa bukuri!	49	Shkronja B b	68–69
Simbolet e motit	50	<i>Gjethja e pemës që donte të rrinte vetëm</i> (Ramadan Pasmaçiu)	70
Kalendari i motit	51	Ndihemë mirë mes shokësh	71
Numri 1	52–53	<i>Veprimitari praktike – Si të lexojmë një tabelë</i>	72
<i>Vjeshta e artë</i> (Xhani Rodari)	54	<i>Veprimitari praktike – Numrat nga 1–5</i>	73
Paraja dhe përdorimi i saj	55	<i>Sikur të dija...</i> (Agim Deva)	74
Shkronja A a	56–57	<i>Veprimitari praktike – Mirupafshim dallëndyshe!</i>	75
Iriqi dhe mollët	58	Numri 2	76–77
Mendojmë për shokët edhe shoqet	59	Shkronja C c	78–79
I madh – i vogël	60–61	Të vishemi sipas stinës	80
Molla	62	Dëgjojmë prindërit	81
Frutat dhe shijet e tyre	63	Katrori	82–83
Gjysma dhe e tëra	64	<i>Shiu dhe sandale – humoristike</i> (Jani Daci)	84
<i>Veprimitari praktike</i> – Kush e gjen i pari mollën	65	Një ditë me shi	85
Rrethi	66–67	Shkronja Ç ç	86–87

Muaji nëntor: Shtëpi, e ëmbla shtëpi

Temat	Faqe	Temat	Faqe
Familja	89	Obobo! Çfarë ka ndodhur këtu?	110
Familje e vogël, familje e madhe	90–91	Në dyqanin e kafshëve	111
Numri 3	92–93	Shkronja Ë ë	112–113
Duke u rritur, duke ndryshuar	94–95	Si linda unë?	114
Familja ime	96	<i>Si u rrita unë</i> (Parashkollorët, IKS, 2007)	115
<i>Që të kenë vec gjëzim (Skënder Gera)</i>	97	Numri 4	116–117
Shkronja D d	98–99	Kotelja e zezë që donte të ishte e gjitha e bardhë	118
<i>Z derrkucët</i>	100	Unë ndryshoj nga ti dhe ti nga unë	119
Shtëpia ku jetoj	101	Shkronja F f	120–121
Trekëndëshi	102–103	Drejtkëndëshi	122–123
Shkronja Dh dh	104–105	<i>Sa të dua, Shqipëri!</i>	124
Kam një mace, kam një qen	106	<i>Shqiponja</i> (Xhevahir Spahiu)	124
Kujdesi për kafshët shtëpiake	107	Flamuri kuqezi	125
Shkronja E e	108–109	Shkronja G g	126–127

Muaji dhjetor: Dimër dhe të dua dhe s'të dua

Temat	Faqe		Temat	Faqe
Bie borë	129		Shkronja H h	144–145
<i>Bredhi i vogël</i> (përshtatje Mimoza Lami)	130		Miri, njeriu prej bore dhe Viti i Ri	146–147
Më pëlqen kështu si jam	131		Burimet e drithës	148
<i>Veprimtari praktike</i> – Figura me forma	132		Pajisjet e ngrohjes	149
<i>Veprimtari praktike</i> – Krijime me forma	133		Shkronja I i	150–151
<i>Kush e qethi pyllin?</i> (Odhise Grillo)	134		Kapelat e Vitit të Ri	152
<i>Veprimtari praktike</i> – Gjej 4 ndryshimet	135		Ndihem mirë kur të tjerët janë të gëzuar	153
Shkronja Gj gj	136–137		Kapela ime e Vitit të Ri	154
<i>Kënga e trenistit</i> (Bedri Dedja)	138		<i>Veprimtari praktike</i> – Fytyra më tregon si ndihem	155
<i>Cili hyri brenda në dorëz?</i> (Përshtatje)	139		Shkronja J j	156–157
Numri 5	140–141		<i>Ja na erdhi Viti i Ri</i>	158
Veshjet e dimrit	142		Dhurata që dëshiroj ta marr	159
Si bëhet një triko?	143			

LIBRI
2

Mësoj si nxënës

LUAJ si FËMIJË

KLASA PËRGATITORE



Muaji janar: Për një trup të shëndetshëm

Temat	Faqe	Temat	Faqe
<i>Ç'më pëlqen të bëj</i> (Parashkollorët, IKS, 2007)	5	<i>Çdonjëri prej neshi është i bukur</i> (Parashkollorët, IKS, 2007)	28
Kalendari i datëlindjeve	6	Kam nevojë për ndihmën tënde	29
Pjetje dhe përgjigje	7	Numri 6	30–31
Trupi ynë	8–9	Shkronja L1	32–33
Dora dhe këmba ime	10	<i>Si u bë Pati sportiste</i> (Altin Haxhinasto)	34
Unë kam aftësi të vecanta	11	Si një sportist/e i/e vërtetë	35
Numri rreshtor deri në 5	12	<i>Lepuri dhe breshka</i>	36
Grupimi me dy mënyra	13	Me këmbëngulje arrihet gjithçka	37
Njomëza dhe Joni me veshje të reja	14	<i>Veprimitari praktike – Kupa për fituesin</i>	38–39
<i>Kopsa e Gimit</i>	15	Perimet më bëjnë më të fortë (https://www.dailymotion.com/video/x3eypi3)	40
Shkronja K k	16–17	Perimet dhe vlerat ushqyese	41
Kush i thotë këto fjalë?	18	Cili lëviz më shpejt?	42–43
Lodrat nuk janë të ndara	19	<i>Majmuni që hante vetëm banane</i> (Përshtatje)	44
<i>Veprimitari praktike – Një motër për mua</i>	20	Ushqehemi shëndetshëm	45
<i>Veprimitari praktike – Te dyqani i lodrave</i>	21	<i>Genci mëson të hajë vetë</i> (Xhevdet Shehu)	46
<i>Kukulla me makinë të kuqe</i> (Rovena Rrozhani)	22	<i>Veprimitari praktike – Shtrimi i tryezës</i>	47

Luajmë së bashku	23	Shkronja L l	48–49
Mbledhje deri në 5	24	Mbledhje dhe zbritje deri në 6	50
Zbritje deri në 5	25	Të kundërtat	51
Shqisat tonë	26	<i>Veprimtari praktike – Figura me forma gjeometrike</i>	52
Kujdesi për to	27	<i>Veprimtari praktike – Zbavitje me figura</i>	53

Muaji shkurt: Sa të dua Kosova ime!

Temat	Faqe	Temat	Faqe
<i>Festa e Pavarësisë</i> (Agim Byci)	55	Mësoj më shumë përvendin tim	75
Shoku / shoqja	56	<i>Në Teatrin e Kukullave</i> (Petrit Bjedi)	76
Bëhemë të mirë kur:	57	Luajmë me pupeta	77
Numri 7	58–59	Numrat rreshtorë deri në 7	78
Shkronja M m	60–61	Mbledhje dhe zbritje deri në 7	79
Sa është ora?	62	Shkronja O o	80–81
Tinguj që dëgjoj përreth	63	<i>Shkaravitetësit</i>	82
<i>Kosova – Atdheu im</i>	64	Kujdesi përmes mjeshtësive e përbashkët	83
Flamuri i Kosovës	65	<i>Të drejtat e fëmijëve</i> (Parashkollorët, IKS, 2007)	84
Shkronja N n	66–67	Dëshirat dhe nevojat	85
<i>Si ruhet Atdheu</i> (Agim Deva)	68	Njerëzit që shërbejnë në komunitet	86
<i>Veprimtari praktike – Edhe ne ndihmojmë</i>	69	Ndihmojmë në komunitet	87

Majtas – djathas	70	Shkronja P p	88–89
Më i rëndë – më i lehtë	71	<i>Qyteti më i ri në botë</i> (Përshtatje)	90–91
Shkronja Nj nj	72–73	<i>Tomi dhe Xherri</i>	92
<i>Miku Oksigen</i> (Agim Deva)	74	<i>Veprimitari praktike – Ngjyros sipas kodit</i>	93

Muaji mars: Në qytet apo në fshat?

Temat	Faqe	Temat	Faqe
Në qytet apo në fshat?	95	Zbritjet deri në 8	111
7 Marsi – Festa e mësuesit	96	<i>Pse Hëna s'ka fustan?</i>	112–113
<i>Rend te mami, rend te gjyshja</i> (Adelina Mamaqi)	97	<i>Veprimitari praktike – Një veshje për Hënën</i>	114
Shkronja Q q	98–99	Tri shkronjat e Hënës	115
<i>Mami mos më lavdëro</i> (humor, Dionis Bubani)	100	Shkronja Rr rr	116–117
Edhe të rriturit bëjnë “gabime”	101	Të mirat që marrim nga fshati	118
Numri 8	102–103	Cili nuk i përket grupit?	119
Profesionet	104–105	<i>Miu i qytetit dhe miu i fshatit</i>	120
Shkronja R r	106–107	Në qytet apo në fshat? Ku është më mirë?	121
Në qytet ka shumë dyqane	108	Shkronja S s	122–123
Si bëhet buka?	109	<i>Veprimitari praktike – Ku është hija ime?</i>	124
Mbledhjet deri në 8	110	<i>Veprimitari praktike – Ku është i vogli im?</i>	125

Mësoj si nxënës

**LUAJ si
FËMIJË**

KLASA PËRGATITORE

LIBRI
3



Muaji prill: Mirë se erdhe moj pranverë!

Temat	Faqe	Temat	Faqe
<i>Manushaqe</i>	5	<i>Kush këndon më bukur? (Lajde Staku)</i>	23
<i>Foleja e re e dallëndyshes (Pali Xharo)</i>	6	<i>Shkronja T t</i>	24–25
<i>Veprimitari praktike – Mirë se erdhe, dallëndyshe!</i>	7	<i>Insektet</i>	26
<i>Numri 9</i>	8–9	<i>Marshi i bibrrecit (Rifat Kukaj)</i>	27
<i>Zogu dhe farëza (Dilaver Baxhaku)</i>	10	<i>Veprimitari praktike – Numëro dhe gjej sa janë</i>	28
<i>Mendojmë para se të veprojmë</i>	11	<i>Veprimitari praktike – Më shumë, më pak, aq sa</i>	29
<i>Shkronja Sh sh</i>	12–13	<i>Të gjithë së bashku</i>	30
<i>Iu lut lulja Yllkës (Moisi Zaloshnja)</i>	14	<i>Bashkimi bën fuqinë</i>	31
<i>Mes luleve shumëngjyrëshe</i>	15	<i>Ëmbëlsira (Edmond Daliu)</i>	32
<i>Mbledhje deri në 9</i>	16	<i>Trupat gjeometrikë</i>	33
<i>Zbritje deri në 9</i>	17	<i>Shkronja Th th</i>	34–35
<i>Tri fluturat</i>	18–19	<i>Veprimitari praktike – Në kërkim të thesarit</i>	36
<i>Ja si rritem unë</i>	20	<i>Veprimitari praktike – Nxito të arrish i/e pari/a</i>	37
<i>Pjesët e bimës</i>	21	<i>Cili numër është?</i>	38
<i>Instrumentet muzikore</i>	22	<i>Pjesa dhe e tëra</i>	39

Muaji maj: Mjetet e transportit

Temat	Faqe	Temat	Faqe
Gjëegjëzat	41	Shkronja X x	58–59
Shkronja U u	42–43	Situata problemore	60
Mjete që lëvizin në rrugë	44	Lëviz apo nuk lëviz?	61
Mjetet e sigurisë	45	<i>Balona e Ketrit Tyty</i> (Gaqo Bushaka)	62
Numri 10	46–47	Kujdesemi për librat dhe mjetet shkollore	63
<i>Një çudi me tre sy</i> (Fejzi Bojku)	48	<i>Veprimtari praktike</i> – Ngjyros sipas kodit	64
Shiko majtas–djathtas! Sigurohu dhe kalo!	49	<i>Veprimtari praktike</i> – Një udhëtim në hapësirë	65
Shkronja V v	50–51	Shkronja Xh xh	66–67
<i>Na u prish makina</i> (Muharrem Xhaxho)	52	<i>Udhëtimi i yllit kureshtar</i> (Skënder Hasko)	68–69
Makinat e punës	53	Noton apo zhytet?	70
Mbledhje deri në 10	54	<i>Punë praktike</i>	71
Zbritje deri në 10	55	Shkronja Y y	72–73
Mjete që lëvizin në ajër	56	Ç'është ylberi?	74
<i>Marinarët dhe pilotët</i> (Petrit Bjedi)	57	<i>Ylberi</i> (Xhevhat Syla)	75

Muaji qershor: Vera na fton në pushime

Temat	Faqe	Temat	Faqe
<i>Si marinari</i>	77	<i>Kukull moj</i> (Marta Naraçi)	88
<i>Pse deti është i kripur?</i>	78–79	Së shpejti me pushime	89
Shkronja Z z	80–81	Shkronjat që mësova	90–91
Stinët e vitit	82	Numrat që mësova	92
Në fillim, pastaj, në fund	83	Format që mësova	93
Shkronja Zh zh	84–85	<i>Mirupafshim në shtator!</i>	94
<i>Fëmijët dhe delfini</i> (Bardhyl Xhamë)	86	<i>Faleminderit të gjithëve!</i>	95
Mbrojmë kafshët nga rreziqet	87		

